



ISSN 2309 3455

Social Studies


Studime Sociale

Vol. 19, No. 1 (70), 2025



- Anila PLAKU (BRATJA) • Ledian RUSTA • Ardita PRENDI
- Flutura SHABANI • Xhulia MUSTA • Rudina RAMA
 - Enkeleida SHYLE PETANAJ • Klaudia REKA
 - Fejzi LILA • Liri JOLLJA • Nevila FURXHI
 - Asunta TOROMËNI • Tsvetelina HADZHIEVA
 - Blagovesta DAFKOVA • Silvana SHEHU
 - Kittisak WONGMAHESAK • Sabri KIÇMARI

www.sociology.al



“Social Studies” Journal is classified ‘Scientific’ by ANVUR

The journal “Social Studies” is classified as Scientific Journal by ANVUR, the National Agency for the Evaluation of the University System and Scientific Research of Italy - Ministry of Education, Universities and Scientific Research of Italy (MIUR), by decision no. 298, dated 21 December 2021.

The application was made in 2020 by Romina GURASHI (PhD) - from “Sapienza” University of Rome, Deputy Editor of the journal “Social Studies”.

Since 2020, ANVUR has monitored the journal “Social Studies” with international experts, and the official response has been returned by Dott. Marco Malgarini, director of ANVUR, on 19 January 2022.

La rivista “Studi Sociali” è classificata ‘Scientifica’ dall’ANVUR

La rivista “Social Studies” è classificata ‘scientifica’ dall’ANVUR, Agenzia Nazionale per la Valutazione del Sistema Universitario e della Ricerca Scientifica d’Italia - Ministero dell’Istruzione, dell’Università e della Ricerca Scientifica d’Italia (MIUR), con decisione n. 298, del 21 dicembre 2021.

La richiesta è stata presentata nel anno 2020 da Romina GURASHI (PhD), dell’Università La Sapienza, Vicedirettore della rivista “Studi Sociali”.

Dal 2020 ANVUR segue con esperti internazionali la rivista “Social Studies” e la risposta ufficiale è stata data dal Dott. Marco Malgarini, il Dirigente Area Ricerca ANVUR, il 19 gennaio 2022.

Revista “Studime Sociale” klasifikohet si revistë shkencore nga ANVUR

Revista “Studime Sociale” është klasifikuar si revistë shkencore nga ANVUR, Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Sistemit Universitar dhe Kërkimit Shkencor të Italisë - Ministria e Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit Shkencor (MIUR), me vendim no. 298, datë 21 dhjetor 2021.

Aplikimi është bërë në vitin 2022 nga Romina GURASHI (PhD), Universiteti La Sapienza Romë, njëherësh Deputy Editor e revistës “Studime Sociale”.

Nga viti 2020, ANVUR ka monitoruar me ekspertë ndërkombëtarë revistën “Studime Sociale” dhe përgjigja zyrtare është kthyer nga Dott. Marco Malgarini, drejtor i ANVUR, më 19 janar 2022.

SOCIAL STUDIES [STUDIME SOCIALE]

Vol. 19, No. 1 (70), 2025

Editorial Team

Editor:

Leke SOKOLI – Tirana, ALBANIA

Deputy Editors:

Sejdin CEKANI – Tirana, ALBANIA

Besim GOLLOPANI – Pristine, KOSOVO

Ali PAJAZITI – Skopje, North MACEDONIA

Romina GURASHI – Roma, ITALY

Deputy Editor for Management, Membership and Finance:

Elda SOKOLI KUTROLI

International Editorial Board

Servet PËLLUMBI – Chair, Albanian Institute of Sociology, ALBANIA

Aida GOGA – University of Tirana, ALBANIA

Agri SOKOLI – St. Louis International School Milan, ITALY

Apostolos G. PAPAĐOPOULOS – Harokopio University, GREECE

Bavjola SHATRO - University of Mississippi, UNITED STATES OF AMERICA

Blerina XHAKOLLI REÇI – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

Borut RONČEVIĆ – University of Ljubljana, SLOVENIA

Brunilda ZENELAGA – University of Tirana, ALBANIA

Doreta KUÇI – University Aleksander Moisiu Durres, ALBANIA

Enis SULSTAROVA – University of Tirana, ALBANIA

Erenestina GJERGJI HALILI – University of Tirana, ALBANIA

Ferdi KAMBERI – University Fehmi Agani of Gjakova, KOSOVO

Goran BASIC – Department of Sociology, Lund University, SWEDEN

Irena NIKAJ – Universiteti Fan Noli of Korca, ALBANIA

Jasminka LAŽNJAK – University of Zagreb, CROATIA

Jola KEPI – Center for School Leadership, CSL-AADE, ALBANIA

Jonida LAMAJ – Albanian-American Development Foundation, ALBANIA

Klea FANIKO – University of Geneva, SWITZERLAND

Klejda MULAJ – University of Exeter, ENGLAND
Konstantin MINOSKI – Ss. Cyril and Methodius University in Skopje, North MACEDONIA
Kseanela SOTIROFSKI – University Aleksander Moisiu Durrës, ALBANIA
Ledia KASHAHU – University Aleksander Moisiu of Durrës, ALBANIA
Monika HASANI - University Ismail QEMALI of Vlora, ALBANIA
Pjereta AGALLIU - University of Tirana, ALBANIA
Rando DEVOLE – Researcher AIS Roma, ITALY
Sergiu BALTATESCU – University of Oradea, ROMANIA
Shaban SINANI – Albanian Academy of Science, ALBANIA
Shkëlzen HASANAJ – University of Siena, ITALY
Svetla KOLEVEA – Institute for the Study of Societies and Knowledge, BULGARIA
Tonin GJURAJ – European University of Tirana, ALBANIA
Venera LLUNJI – AAB College, KOSOVO

© Albanian Institute of Sociology / Instituti Shqiptar i Sociologjisë

Design: **Orest Muça**

“Social Studies”, Scientific Journal, certified by the Highest Scientific Committee, Ministry of Education and Science of Albania

Decision no. 170, date 20th of December 2010

Contacts:

Mobile: ++355692044722; ++355694067682

E-Mail: albsa@sociology.al; studime.sociale@gmail.com

www.sociology.al

Contents:

Anila PLAKU (BRATJA)	<i>Lideri paternalist dhe mirëfunksionimi i punës në ekip</i>	3
Ledian RUSTA	<i>Lumturia dhe mirëqenia në etikën stoike të antikitetit.....</i>	15
Ardita PRENDI Flutura SHABANI	<i>Adoleshentët, ngacmimi kibernetik dhe ligji. Një përmbledhje e sfidave psikologjike dhe ligjore.....</i>	23
Xhulia MUSTA Rudina RAMA	<i>Një vështrim kritik i legjislacionit shqiptar në fushën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar</i>	33
Enkeleida SHYLE PETANAJ Klaudia REKA	<i>Objektivat socialë të sanksionuara në Kushtetutën Shqiptare, në kuadër të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.....</i>	45
Fejzi LILA	<i>Autoritarizmi dhe demokracia. Rasti Fujinori.....</i>	55
Liri JOLLJA	<i>Sfidat e lidërsipit në shkollat rurale</i>	67
Nevila FURXHI Asunta TOROMËNI	<i>Përvojat e programeve akademike të shkëmbimeve</i>	75
Tsvetelina HADZHIEVA Blagovesta DAFKOVA	<i>A Study of the Emotional Experiences of preschool Children</i>	89
Silvana SHEHU	<i>Lifelong learning: opportunities and challenges (Case study Albania).....</i>	95
	<i>Libra & Autorë.....</i>	103

LIDERI PATERNALIST DHE MIRËFUNKSIONIMI I PUNËS NË EKIP

Anila PLAKU (BRATJA)
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës
Fakulteti i Edukimit
Departamentin e Pedagogjisë
E-mail: uamd.anil79@yahoo.com

PËRMBLEDHJA

Udhëheqja paternaliste është një fushë me interes studimi, veçanërisht në vendet postkomuniste. Ky studim ka për qëllim të shqyrtojë lidhjen ndërmjet triadës paternaliste të udhëheqjes shkollore (dashamirëse, morale, autoritare) dhe punës në ekip. Studimi mbështetet në kërkimin sasior, dhe përfshin 393 mësues nga shkollat AMU të rrethit të Durrësit. Instrumenti i përdorur është një pyetësor i standardizuar, që përmban dy shkallë: shkalla e udhëheqjes paternaliste, adaptuar nga “Shkallët e Udhëheqjes Paternaliste” të Cheng et al. (2004), dhe shkalla e punës në ekip, sipas “Pyetësorit të Vlerësimit të Ekipit” (Lencioni, 2007). Gjetjet e studimit tregojnë një lidhje të fortë ndërmjet udhëheqjes paternaliste dhe punës në ekip ($r = 0.631$, $p = 0.001$), si dhe një mundësi parashikimi të variancës prej 39.8% të punës në ekip nga stili i udhëheqjes paternaliste. Duke u bazuar në triadën e udhëheqjes paternaliste, vihet re se dimensionin autoritar ka ndikim më të madh, ndjekur nga ai dashamirës. Rekomandohet që udhëheqësit e shkollave të kombinojnë stilin autoritar të udhëheqjes, me stil dashamirës dhe etik, për të stimuluar punën në ekip dhe bashkëpunimin efektiv.

Fjalë kyçe: *Udhëheqja autoritare, udhëheqja dashamirëse, udhëheqja morale, puna në ekip.*

Dr. **Anila PLAKU (BRATJA)** është pedagoge në Departamentin e Pedagogjisë të Fakultetit të Edukimit, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës. Ajo është autore e një libri në fushën e lidershipit dhe ka kontribuar me artikuj shkencorë dhe pjesëmarrje në konferenca të ndryshme. Fushat e saj të interesit përfshijnë lidershipin arsimor, modele dhe praktika në këtë fushë (ORCID numbers: 0000-0003-0149-1983).

Një lider paternalist është ai që merr përgjegjësinë për mirëqenien e individëve dhe i udhëheq ata me mençuri dhe kujdes, shpesh duke marrë vendime që janë për të mirën e tyre, edhe kur këto vendime mund të jenë të vështira ose të padëshiruara për ata. Në traditën konfucianiste, lideri është i detyruar të jetë një model moral për popullin e tij, duke vepruar me mençuri dhe dhembshuri, ndërsa në filozofinë e Platonit, koncepti “mbreti filozof” përshkruan udhëheqës të cilët, përmes dijes dhe mençurisë së tyre, i drejtojnë shoqëritë drejt mirëqenies dhe drejtësisë. Modeli udhëheqës paternaliste ka ndikim të fortë në perceptimin e marrëdhënies midis udhëheqësve dhe ndjekësve, të cilët e shohin veten si kujdestarë dhe mbrojtës, duke vendosur shpesh interesin e përgjithshëm mbi dëshirat dhe liritë individuale. Edhe pse kjo lloj udhëheqjeje mund të jetë efektive për krijimin e një mjedisi atëror/mëmësor, gjithashtu sjell sfida dhe pyetje për lirinë dhe autonominë e individëve.

Qëllimi këtij studimi është të shqyrtojë triadën e liderit paternalist në institucionet arsimore të AMU-s në rrethin e Durrësit. Përmes këtij studimi hetohet marrëdhënia midis liderit paternalist (autoritar, dashamirës, etik) dhe mirëfeksionit të punës në ekip në institucionet shkollore, si dhe të parashikohet cila prej variablave (autoritarë, dashamirës dhe etik) ka ndikimin më të madh në shkollë referuar punës në ekip? Kësisoj ky studim paraqet rëndësi referuar këtij profili lidërshepi dhe mirëfeksionimit të punës në shkollë.

Korniza teorike

Lidërshepi Paternalist: karakteristikat dhe efektet

Lidërshepi paternalist karakterizohet nga një marrëdhënie e ngushtë dhe personale midis liderit dhe ndjekësve, që shpesh përfshin dy aspekte kryesore: autoritarizmin dhe dashamirësinë (Chan et al., 2012).

Ky stil lidërshepi është i njohur në kultura kolektiviste dhe hierarkike, ku liderët konsiderohen si figura autoritare që mbrojnë dhe kujdesen për anëtarët e grupit, shpesh duke ndërhyrë në jetën e tyre personale (Arun et al., 2020). Në këtë kontekst, lidërshepi paternalist ka efekte të rëndësishme mbi angazhimin organizativ, sjelljen qytetare dhe performancën e punonjësve, me ndihmën e faktorëve të tillë si klimën etike dhe besimin reciprok (Erben & Güneşer, 2007; Shi et al., 2020). Në analizat e mëtejshme, lidërshepi paternalist është parë si një faktor që mund të ndihmojë në përmirësimin e performances (Pellgrini, 2019) inkurajimin e besimit dhe bashkëpunimin. Megjithatë, ky stil ka disa kufizime, veçanërisht në aspektet e kontrollit autoritar, që mund të sjellin efekte negative në performancën dhe kënaqësinë e punës (Chan et al., 2012; Ekmen & Okçu, 2021). Studimet tregojnë se një balancë midis dashamirësisë dhe autoritarizmit është thelbësore për arritjen e rezultateve pozitive (Chen et al., 2018).

Lidërshepi Paternalist dhe Sättvika Leadership

Në një dimension të ndryshëm të lidërshepit, Alok (2015) paraqet modelin Sättvika Leadership (SL), një stil udhëheqjeje që integron konsiderata morale dhe shpirtërore në thelbin e saj. Ky model, i mbështetur në traditat filozofike indiane dhe spiritualitetin hindu, përkufizohet si një grup veprimesh që drejtohen nga njohuria dhe bashkëpunimi, dhe që synojnë të nxisin zhvillimin moral dhe psikologjik të ndjekësve (Alok, 2015). Elementet kyçe të SL përfshijnë rritjen e kapitalit psikologjik të ndjekësve, forcimin e besimit dhe kultivimin e një klime etike organizative. Ky model bën thirrje për integrimin e vlerave pozitive si përgjegjësia morale dhe zhvillimi shpirtëror në udhëheqjen organizative, duke theksuar rëndësinë e përmbushjes së qëllimeve organizative përmes veprimeve etike dhe

shpirtërore (Alok, 2015). SL kërkon krijimin e një atmosfere ku liderët veprojnë si modele të moralitetit dhe drejtësisë, duke promovuar zhvillimin e ndjekësve (Alok, 2015). Ky model është një qasje e veçantë që lidhet ngushtë me filozofitë lindore dhe thekson balancimin e etikës dhe spiritualitetit në praktikën udhëheqëse. Teoria e lidershit paternalist dhe *Sättvika Leadership* ndajnë disa përputhje, veçanërisht në lidhje me vlerat morale dhe përkushtimin ndaj ndjekësve. Të dy modelet synojnë të krijojnë një ambient të besueshëm dhe moral, ku liderët investojnë në zhvillimin e individëve dhe në mbështetje të mirëqenies së tyre (Erben & Güneşer, 2007; Alok, 2015). Megjithatë, ndryshe nga liderishi paternalist, i cili mund të përfshijë një ndikim autoritar, SL thekson shumë më tepër bashkëpunimin dhe dijen shpirtërore (Alok, 2015). Për më tepër, Sättvika Leadership ofron një perspektivë që lidh elementët e spiritualitetit me praktikën e menaxhimit, duke sugjeruar se udhëheqësit duhet të ndihmojnë ndjekësit të arrijnë një shkallë të lartë të moralit dhe zhvillimit shpirtëror, ndërsa liderishi paternalist, përkundrazi, fokusohet më shumë në ndihmën dhe mbështetjen praktike që lidhet me kujdesin e ndjekësve (Chen et al., 2018; Alok, 2015).

Kultura kolektiviste dhe perceptimi lidershit paternalist

Në shumë kultura, veçanërisht ato kolektiviste si Kina dhe Turqia, liderishi paternalist është më i pranuar dhe i efektshëm, pasi ndjekësit kanë tendencë të kërkojnë mbështetje dhe udhëzim nga liderët e tyre (Arun et al., 2020; Cheng et al., 2013). Për shembull, në shoqëritë kineze, liderishi paternalist është i lidhur ngushtë me vlerat konfuciane të hierarkisë dhe respektit për autoritetin, ndërsa udhëheqësit shërbejnë si modele të vlerave morale dhe drejtësisë (Shi et al., 2020). Për më

tepër, ky stil liderishi mund të ndihmojë në promovimin e bashkëpunimit dhe angazhimit të punonjësve, veçanërisht kur janë të pranishme vlerat morale dhe etike të një mjedisi të mbështetur nga liderët (Lee, 2001; Davidson & Hughes, 2020).

Ndikimi i Lidershit Paternalist në punën në ekip

Në kontekstin e punës në ekip, liderishi paternalist mund të ndikojë në mënyra të ndryshme, duke krijuar një atmosferë mbështetjeje (Arun et al., 2020) dhe sigurie psikologjike, por gjithashtu mund të kufizojë autonominë dhe mundësitë për zhvillimin e aftësive individuale. Lee (2001) pohon se MBNJ paternaliste mbështetet në lidhje joformale, personale dhe jo në sisteme formale, objektive, duke çuar në sfida në vlerësimin e performancës individuale ose në minimizimin e rreziqeve morale kur punonjësit neglizhojnë përgjegjësitë. Ndërsa ky sistem promovon produktivitetin e grupit, ai është më i dobët në adresimin e çështjeve të llogaridhënies individuale. Për Pellegrini (2019) ky model lideri mund të krijojë një mjedis ku besimi dhe angazhimi i anëtarëve të ekipit janë të shtuar, duke promovuar një kulturë që mbështet bashkëpunimin dhe zhvillimin e përbashkët. Kjo është e ngjashme me teoritë që lidhin liderishin me përmirësimin e performancës në ekip, duke krijuar mundësi për ndarjen e njohurive dhe rritjen e besimit ndërmjet anëtarëve (Van den Bossche et al., 2010). Megjithatë, ekziston një tension midis shfaqjes autoritare dhe dashamirëse të lidershit paternalist. Nëse lideri është shumë autoritar, ai mund të kufizojë mundësitë e anëtarëve të ekipit për të shprehur idetë dhe mendimet e tyre, duke reduktuar transparencën, dhe penguar zhvillimin e një modeli të përbashkët mendimi brenda grupit (Chan et al., 2012; Blunt et al., 2001). Ky problem mund të zbutet përmes një liderishi më të balancuar, ku autoritarizmi zëvendësohet me një qasje

më shumë bashkëpunuese dhe pjesëmarrëse (Cheng et al., 2004), që inkurajon mësimin e përbashkët dhe ndihmon në ndërtimin e besimit në ekip (Edmondson, 1999; Lencioni, 2007).

Siguria psikologjike dhe bashkëpunimi në ekip

Lideri paternalist mund të shërbejë si një mbështetje e fortë për ndjekësit, duke ofruar një nivel të lartë të sigurisë psikologjike që është esenciale për zhvillimin dhe performancën e ekipeve (Edmondson, 1999). Kjo është e lidhur ngushtë me idenë e “sigurisë psikologjike”, e cila është një element kyç që mundëson një komunikim të hapur dhe shkëmbimin e njohurive brenda ekipeve (Brockmann & Anthony, 2002; Mortensen & Neeley, 2012). Ndërsa kjo siguri mund të ndihmojë në ndërtimin e një mjedisi ku ideja dhe inovacioni janë të inkurajuar, një kontroll i tepruar autoritar mund të ndalojë këtë proces, duke penguar një bashkëpunim të vërtetë dhe të hapur. Përkundrazi, një lidhësi që ka më shumë fokus në bashkëpunim dhe ndihmesë të ndërsjellë, siç është modeli i lidhësit S ttvika (Alok, 2015), mund të promovojë më tej zhvillimin e moralit dhe etikës brenda grupit, duke krijuar mundësi për rritjen shpirtërore dhe psikologjike të anëtarëve të ekipit. Kjo qasje ka tendencën të jetë më pak autoritare dhe më shumë të përqendrohet në një ndërveprim të balancuar dhe të ndershëm, ku lideri vepron si një model i vlerave morale dhe drejtësisë. Kjo e bën atë një stil të përshtatshëm për ekipe që kërkojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe të përbashkët, duke rritur angazhimin dhe besimin brenda grupit (Alok, 2015; Chen et al., 2018).

Metodologjia e kërkimit

Ky studim përdori metoda sasiore për të ekzaminuar lidhjen midis liderit paternalist (autoritar, dashamirës dhe etik)

dhe punës në ekip. Për të testuar këtë marrëdhënie u kryen analiza korrelacionale dhe regresioni. Popullata e studimit përbëhej nga mësues të shkollave 9-vjeçare të qytetit të Durrësit (N=393). Instrumenti i kërkimit përbëhej nga një pyetësor i standardizuar që përfshin dy shkallë: “shkallën e lidhësit paternalist”, përshtatur nga Cheng et al. (2004) dhe shkallën e punës në ekip, sipas “pyetësorit të vlerësimit të ekipit” nga Lencioni (2007). Konsistenca e brendshme u vlerësua duke përdorur Cronbach’s alfa, me vlerat 0.735 për liderin autoritar; 0,857 për liderin dashamirës; 0,835 për liderin etik dhe 0.95 për punën në ekip, gjë që tregon një nivel të lartë besueshmërie. Para shpërndarjes, pyetësori iu nënshtrua një testi pilot për të siguruar qartësi dhe efektivitet.

Pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit në studim janë mësues të shkollave 9-vjeçare të rrethit të Durrësit (N = 393), nga ku 71.5% ishin femra dhe 28.5% meshkuj. Përsa i përket shpërndarjes së moshës, 43.8% i përkasin grupmoshës deri në 39 vjeç, 28.5% grupmoshës 40-49 vjeç, 20.5% grupmoshës 50-59 vjeç dhe 7.2% grupmoshës mbi 60 vjeç. Gjithashtu, 58.7% e të anketuarve ishin nga shkollat qendrore dhe periferike, ndërsa 41.3% ishin nga shkollat rurale.

Instrumenti i kërkimit dhe përpunimi të dhënave

Instrumenti i përdorur në këtë studim është një pyetësori i standartizuar, i përbërë nga dy shkallë; shkalla e lidhësit paternalist, përshtatur nga “paternalistic leadership scales” nga Cheng et al. (2004), me variablat e pavarur lidhësi autoritar, lidhësi dashamirës dhe lidhësi etik. Ndërsa shkalla e punës në ekip është marrë nga “Pyetësori i Vlerësimit të Ekipit” me 38 deklarime (Lencioni, 2007). Fillimisht pyetësori u pilotua, dhe më pas u shpërnda në terrenin

studimor. Për përpunimin e të dhënave dhe realizimin e analizave statistikore, u përdor programi statistikor SPSS 27. Ky program mundësoi analizën e korrelacionit, regresionit linear dhe analizën e variancës (ANOVA) për të vlerësuar lidhjen midis lidershipit paternalist (autoritar, dashamirës, etik) dhe performancës së punës në ekip.

Rezultatet e studimit

Ndikimi liderit autoritar në punën në ekip

H1. Ekziston një lidhje pozitive midis perceptimit të lidershipit autoritar dhe punës në ekip.

Rezultatet e regresionit linear dhe ANOVA (Tabela 1) tregojnë një lidhje të fortë pozitive dhe statistikiisht të rëndësishme midis liderit autoritar dhe punës në ekip ($r = 0.605$, $p = 0.0001$). Rreth 36.6% e variancës e punës në ekip ($R^2 = 0.366$) mund të shpjegohet nga ndikimi i liderit autoritar, duke sugjeruar se ky faktor ka një ndikim të rëndësishëm në bashkëpunimin dhe performancën e ekipit. Vlera $F = 211.989$ tregon se modeli është i rëndësishëm dhe kontribuon në

parashikimin e punës në ekip. Megjithatë, kjo përqindje e variancës tregon gjithashtu se faktorë të tjerë, përveç lidershipit autoritar, ndikojnë në punën në ekip.

H2. Ekziston një lidhje pozitive midis perceptimit të lidershipit dashamirës dhe punës në ekip.

Nga tabela 2, rezultojnë se ekziston një lidhje pozitive dhe statistikiisht e rëndësishme midis liderit dashamirës dhe punës në ekip ($r = 0.600$, $p = 0.000$). 36% e variancës e punës në ekip ($R^2 = 0.360$) mund të shpjegohet nga ndikimi i liderit dashamirës. Ky rezultat tregon se lidershipi dashamirës ka një ndikim të konsiderueshëm në bashkëpunimin dhe performancën e ekipit. Vlera $F = 206.256$ tregon se modeli është statistikiisht i rëndësishëm, duke mbështetur faktin se lidershipi dashamirës kontribuon në mënyrë të dukshme në punën në ekip. Megjithatë, gjithashtu është e dukshme se ka faktorë të tjerë që kontribuojnë në variancën e punës në ekip, duke sugjeruar se lidershipi dashamirës është një faktor i rëndësishëm, por jo i vetmi.

Tabela 1: Regresioni linear: lideri autoritar dhe puna në ekip

Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics				
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change
1	.605a	.366	.364	19.02074	.366	211.989	1	368	.000
a. Predictors: (Constant), LideriAutoritar									
b. Dependent Variable: PunaEkip									

ANOVAa						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	76695.094	1	76695.094	211.989	.000b
	Residual	133138.204	368	361.789		
	Total	209833.297	369			
a. Dependent Variable: PunaEkip						
b. Predictors: (Constant), LideriAutoritar						

Tabela 2: Regresioni linear: lideri dashamirës dhe puna në ekip

Model Summary										
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics					
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change	
1	.600a	.360	.358	19.10729	.360	206.256	1	367	.000	

Predictors: (Constant), LiderDashamires						
ANOVAa						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	75301.627	1	75301.627	206.256	.000b
	Residual	133987.436	367	365.088		
	Total	209289.062	368			
a. Dependent Variable: PunaEkip						
b. Predictors: (Constant), LiderDashamires						

H3. Ekziston një lidhje pozitive midis perceptimit të lidhshpimit etik dhe punës në ekip.

Nga tabela 3, rezulton një lidhje pozitive dhe moderuar midis liderit etik dhe punës në ekip ($r = 0.579$, $p = 0.000$). 33.5% e variancës në punën në ekip ($R^2 = 0.335$) mund të shpjegohet nga ndikimi i liderit etik. $F = 185.416$ tregon se modeli është statistikisht i rëndësishëm dhe tregon ndikimin e liderit etik në punën në ekip. Megjithatë, kjo tregon gjithashtu se ka faktorë të tjerë që kontribuojnë gjithashtu në punën në ekip.

Diskutime

Hipoteza 1.

Lideri autoritar dhe puna në ekip

Hipoteza 1 pranohet: Në këtë hipotezë, studimi shqyrton ndikimin e lidhshpimit autoritar në punën në ekip. Rezultatet e analizave të regresionit sugjerojnë se lideri autoritar ka një ndikim të konsiderueshëm dhe statistikisht të rëndësishëm mbi punën

në ekip, me një koeficient pozitiv që tregon se rritja e nivelit të autoritarizmit të liderit lidhet me përmirësimin e punës së stafit mësimor. Ky rezultat është në përputhje me kërkimet e mëparshme të bëra nga Chan et al. (2012), të cilët sugjerojnë se liderët autoritarë, ndonëse mund të shprehin një kontroll të lartë, shpesh krijojnë një strukturë të fortë që mund të përmirësojë orientimin e ekipeve drejt objektivave të përbashkëta. Gjithashtu, Pellegrini (2019) gjeti një lidhje të rëndësishme pozitive të drejtpërdrejtë midis udhëheqjes paternaliste dhe performancës së detyrës.

Megjithatë, ky rezultat nuk është pa kufizime. Gjetjet e studimeve nga Erben & Güneşer (2007); Chan et al. (2012); Chen et al. (2018) pohojnë se lidhshpimi autoritar mund të ofrojë drejtim të qartë dhe qëndrueshmëri, por gjithashtu sjell efekte negative si mungesa e autonomisë dhe pengimi i inovacionit, duke çuar në një atmosferë të kufizuar mësimi dhe zhvillimi. Ky aspekt është përmendur gjithashtu në teorinë e “sigurisë psikologjike”

Tabela 3: *Regresioni linear: lideri etik dhe puna në ekip*

Model Summary									
Model	R	R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate	Change Statistics				
					R Square Change	F Change	df1	df2	Sig. F Change
1	.579a	.335	.333	19.47203	.335	185.416	1	368	.000
Predictors: (Constant), LiderEtik									

ANOVAa						
Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	70302.447	1	70302.447	185.416	.000b
	Residual	139530.851	368	379.160		
	Total	209833.297	369			
a. Dependent Variable: PunaEkip						
b. Predictors: (Constant), LiderEtik						

të Edmondson (1999), se për të promovuar mësimin dhe rritjen në një ekip, duhet të krijohet një mjedis ku anëtarët të ndihen të sigurt, të kenë mundësinë të bëjnë gabime dhe të mësojnë prej tyre. Lencioni (2002) gjithashtu thekson se liderët duhet të krijojnë një kulturë besimi dhe transparence, ku punonjësit të inkurajohen të ndajnë ide dhe diskutojnë hapur.

Hipoteza 2.

Lideri dashamirës dhe puna në ekip

Hipoteza 2 pranohet: Rezultatet e regresionit tregojnë se një lider dashamirës ka gjithashtu një ndikim të fortë dhe pozitiv në performancën e ekipit, duke rritur angazhimin dhe bashkëpunimin. Udhëheqja dashamirëse paternaliste fokusohet në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive ndërpersonale midis udhëheqësve dhe vartësve, në vend të qëllimeve afatshkurtra të ekipit. Ky rezultat mbështet gjetjet nga Erben dhe Güneşer (2007), Lu et al. (2017) dhe Shi et al. (2020), të cilët theksojnë se lidërshtipi dashamirës, përmes përkujdesjes dhe mbështetjes për anëtarët e ekipit, mund

të krijojë një atmosferë sigurie që është e rëndësishme për bashkëpunimin dhe zhvillimin kolektiv, duke rritur krijimtarinë organizative (Ağalday & Dağlı, 2021). Gjithashtu, dimensionet dashamirëse dhe morale të udhëheqjes paternaliste nxitin identifikimin e ekipit përmes rritjes së dashamirësisë dhe klimës parimore (Newman, et al., 2017). Punonjësit me tipare pozitive të personalitetit, kur udhëhiqen nga udhëheqës paternalistë dashamirës, kanë më shumë gjasa të kontribuojnë në një mjedis pozitiv organizativ, duke përmirësuar komunikimin dhe kënaqësinë në punë (Shahzad et al., 2022).

Nga ana tjetër, nëse lideri është shumë i dashur dhe mbështetës, mund të ndodhin kufizime në aspektin e kontrollit dhe orientimit të qartë. Një lider që nuk vë kufij të qartë mund të krijojë ndjesinë e mungesës së drejtimit, që mund të ndikojë në mënyrën se si anëtarët e ekipit kontribuojnë dhe bashkëpunojnë Pellegrini (2019) dhe Lee (2001). Ky aspekt është gjithashtu në përputhje me atë që Lencioni (2002) thekson se lidërshtipi duhet të balancojë nevojën

për mbështetje, me nevojën për të dhënë udhëzime të qarta dhe për të mbajtur një nivel të lartë angazhimi. Lencioni argumenton se një lider duhet të jetë i kujdesshëm të mos bëhet i tepruar në rolin e “shokur” të ekipit, duke inkurajuar qëndrueshmëri dhe qëllime të qarta për t’u arritur.

Hipoteza 3.

Lideri etik dhe puna në ekip

Hipoteza 3 pranohet: Për hipotezën e tretë, lidhja ndërmjet lidershit etik dhe performancës së punës në ekip është gjithashtu e rëndësishme. Rezultatet e analizave tregojnë një lidhje të moderuar mes lidershit etik dhe punës në ekip, ku lidershi etik ka një ndikim pozitiv në përmirësimin e punës në ekip. Ky rezultat mbështet teorinë e Alok (2015), i cili sugjeron se lidershi që promovon vlera morale dhe shpirtërore është në gjendje të krijojë një atmosferë ku ndjekësit ndihen të sigurt dhe të angazhuar, duke stimuluar bashkëpunimin dhe zhvillimin e tyre të përbashkët. Një drejtues etik ka aftësinë të krijojë besim dhe ndershmëri brenda ekipit, për rrjedhojë dhe angazhim më të madh të mësuesve (Shi et al., 2020).

Megjithatë, lidershi etik mund të hasë sfida, veçanërisht kur ai balancohet me elemente të autoritarizmit ose kur nuk është e mundur të krijohet një mjedis i plotë bashkëpunimi. Modeli i S ttvika Leadership (SL) i Alok (2015) sugjeron se integrimi i etikës dhe moralitetit në udhëheqje mund të jetë një mënyrë për të balancuar këto sfida. Ky model përfshin bashkëpunimin dhe zhvillimin shpirtëror të individëve, duke krijuar një atmosferë ku liderët është

modeli moralit dhe drejtësisë. Në të njëjtën kohë, morali është enigmatik dhe paraqet sfida unike për liderët (Fehr et al., 2014). Për Lencioni (2002), lidershi etik duhet të jetë i ndërlidhur me mundësinë për të krijuar një kulturë të besimit dhe bashkëpunimit brenda ekipeve.

Përfundim dhe rekomandime

Të tre hipotezat në këtë studim tregojnë se triada e lidershit paternalist – autoritar, dashamirës dhe etik – ka ndikim të rëndësishëm në performancën e punës në ekip, por secili aspekt ka karakteristikat dhe kufizimet e tij. Liderët autoritarë mund të ofrojnë strukturë dhe drejtim të qartë, por kjo mund të shkojë në dëm të autonomisë dhe inovacionit. Udhëheqësit dashamirës tregojnë kujdes si për jetën personale ashtu edhe për atë profesionale të ndjekësve të tyre, duke nxitur një klimë ekipe të ngjashme me familjen (Lee, 2001), gjë e cila mund të bashkëshoqërohet me problematika të kontrollit dhe drejtimit të qartë. Nga ana tjetër, lidershi etik ka aftësinë për të ndihmuar në krijimin e besimit dhe një mjedisi të hapur dhe bashkëpunues, por gjithashtu ka nevojë për balancim me aspekte të tjera të lidershit për të shmangur mungesën e drejtimeve të qarta.

Rekomandohet që, për të rritur dhe përmirësuar punën në ekip, të aplikohet një qasje e balancuar, që përfshin tre aspektet e triadës paternaliste – autoritare, dashamirëse dhe etike – duke kontribuar në krijimin e një atmosfere shkollore, ku anëtarët e ekipit të ndihen të sigurt, të mbështetur dhe të udhëzuar.

REFERENCAT

Ağalday, B., & Dağlı, A. (2021). “The Investigation of the Relations Between Paternalistic Leadership, Organizational Creativity and Organizational Dissent”, *Research in*

Educational Administration and Leadership, 6(4), 748–794. <https://doi.org/10.30828/real/2021.4.1>

Alok, K. (2015). “S ttvika Leadership: An Indian

- Model of Positive Leadership”, *Journal of Business Ethics*, 142(1), 117–138. <https://doi.org/10.1007/s10551-015-2790-2>
- Arun, K., Şen, C., & Okun, O. (2020). “How does Leadership Effectiveness related to the Context? Paternalistic Leadership on non-financial Performance within a cultural Tightness- Looseness Model?”, *Journal of East European Management Studies*, 25(3), 503–529. <https://doi.org/10.5771/0949-6181-2020-3-503>
- Blunt, R., Perlman, B., & Sayed, Y. (2001). “What’s Wrong and What Should Be Done? Public Performance & Amp”, *Management Review*, 25(1), 129–139. <https://doi.org/10.1080/15309576.2001.11643650>
- Brockmann, E. N., & Anthony, W. P. (2002). Tacit Knowledge and Strategic Decision Making. Group & Organization Management, 27(4), 436–455. <https://doi.org/10.1177/1059601102238356>
- Chan, S. C. H., Huang, X., Snape, E., & Lam, C. K. (2012). “The Janus face of paternalistic leaders: Authoritarianism, benevolence, subordinates’ organization-based self-esteem, and performance”, *Journal of Organizational Behavior*, 34(1), 108–128. Portico. <https://doi.org/10.1002/job.1797>
- Chen, Y., Zhou, X., & Klyver, K. (2018). “Collective Efficacy: Linking Paternalistic Leadership to Organizational Commitment”, *Journal of Business Ethics*, 159(2), 587–603. <https://doi.org/10.1007/s10551-018-3847-9>
- Cheng, B., Chou, L., Wu, T., Huang, M., & Farh, J. (2004). “Paternalistic leadership and subordinate responses: Establishing a leadership model in Chinese organizations”, *Asian Journal of Social Psychology*, 7(1), 89–117. Portico. <https://doi.org/10.1111/j.1467-839x.2004.00137.x>
- Cheng, B.-S., Boer, D., Chou, L.-F., Huang, M.-P., Yoneyama, S., Shim, D., Sun, J.-M., Lin, T.-T., Chou, W.-J., & Tsai, C.-Y. (2013). “Paternalistic Leadership in Four East Asian Societies”, *Journal of Cross-Cultural Psychology*, 45(1), 82–90. <https://doi.org/10.1177/0022022113490070>
- Davidson, F. D., & Hughes, T. R. (2020). “Moral dimensions of leadership”, *FD Davidson & TR Hughes, Oxford Research Encyclopedia of Education: Oxford University Press*. <https://doi.org/10.1093/acrefore/9780190264093.013.785>.
- Edmondson, Amy. (1999). “Psychological safety and learning behavior in work teams”, *Administrative science quarterly*, 44.2: 350-383.
- Ekmen, F., & Okçu, V. (2021). “The relation between paternalistic leadership and pre-school teachers”, *European Journal of Education Studies*, 8(6). <https://doi.org/10.46827/ejes.v8i6.3776>
- Erben, G. S., & Güneşer, A. B. (2007). “The Relationship Between Paternalistic Leadership and Organizational Commitment: Investigating the Role of Climate Regarding Ethics”, *Journal of Business Ethics*, 82(4), 955–968. <https://doi.org/10.1007/s10551-007-9605-z>
- Fehr, R., Yam, K. C., & Dang, C. (2014). “Moralized Leadership: The Construction and Consequences of Ethical Leader Perceptions”, *Academy of Management Proceedings*, 2014(1), 16911. <https://doi.org/10.5465/ambpp.2014.16911abstract>
- Lee, H.S. (2001). Paternalistic Human Resource Practices: Their Emergence and Characteristics. *Journal of Economic Issues*, 35(4), 841–869. <https://doi.org/10.1080/00213624.2001.11506417>
- Lencioni, P. (2002). *The Five Dysfunctions of a Team: A Leadership Fable*, Jossey-Bass.
- Lencioni, P. M. (2007). *The five dysfunctions of a team: Participant Workbook* (Vol. 8). John Wiley & Sons.
- Lu, L., Li, F., Leung, K., Savani, K., & Morris, M. W. (2017). “When can culturally diverse teams be more creative? The role of leaders’ benevolent paternalism”, *Journal of Organizational Behavior*; 39(4), 402–415. Portico. <https://doi.org/10.1002/job.2238>
- Mortensen, M., & Neeley, T. B. (2012). “Reflected Knowledge and Trust in Global

- Collaboration”, *Management Science*, 58(12), 2207–2224. <https://doi.org/10.1287/mnsc.1120.1546>
- Newman, A., Round, H., Bhattacharya, S., & Roy, A. (2017). “Ethical Climates in Organizations: A Review and Research Agenda”, *Business Ethics Quarterly*, 27(4), 475–512. <https://doi.org/10.1017/beq.2017.23>
- Pellegrini, E. K. (2019). “Paternalistic Leadership”, *Management*, <https://doi.org/10.1093/obo/9780199846740-0162>
- Shahzad, F., Shahzad, M. F., Dilanchiev, A., & Irfan, M. (2022). “Modeling the Influence of Paternalistic Leadership and Personality Characteristics on Alienation and Organizational Culture in the Aviation Industry of Pakistan: The Mediating Role of Cohesiveness”, *Sustainability*, 14(22), 15473. <https://doi.org/10.3390/su142215473>
- Shi, X., Yu, Z., & Zheng, X. (2020). “Exploring the Relationship Between Paternalistic Leadership, Teacher Commitment, and Job Satisfaction in Chinese Schools”, *Frontiers in Psychology*, 11. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2020.01481>
- Van den Bossche, P., Gijsselaers, W., Segers, M., Woltjer, G., & Kirschner, P. (2010). Team learning: building shared mental models. *Instructional Science*, 39(3), 283–301. <https://doi.org/10.1007/s11251-010-9128-3>

ABSTRACT

Paternalistic leadership is an area of interest for research, especially in post-communist countries. This study aims to examine the relationship between the paternalistic leadership model (benevolent, moral, authoritarian) and teamwork. The study is based on quantitative research and includes 393 teachers from AMU schools in the Durrës district. The instrument used is a standardized questionnaire containing two scales: the paternalistic leadership scale, adapted from “Paternalistic Leadership Scales” by Cheng et al. (2004), and the teamwork scale, according to the “Team Assessment Questionnaire” (Lencioni, 2007). The study’s findings show a strong relationship between paternalistic leadership and teamwork ($r = 0.631$, $p = 0.001$), as well as a prediction of 39.8% of the variance in teamwork by the paternalistic leadership style. Based on the paternalistic leadership model, it is observed that the authoritarian dimension has the greatest impact, followed by the benevolent dimension. It is recommended that school leaders combine the authoritarian leadership style with benevolent and ethical styles to stimulate teamwork and effective collaboration.

Keywords: *Authoritarian leadership, benevolent leadership, moral leadership, teamwork.*

LUMTURIA DHE MIRËQENIA NË ETIKËN STOIKE TË ANTIKITETIT

Ledian RUSTA
Universiteti i Tiranës
E-mail: ledianrusta@gmail.com

ABSTRACT

Në lidhje me konceptin e lumturisë dhe mirëqenies njerëzore, esesa analizon disa momente të rëndësishme të etikës stoike si dhe ato të Epitektus, përfaqësuesit më të njohur të kësaj shkolle filozofike. Edhe pse konceptet e kësaj shkolle - të cilat na vijnë gjithashtu në formën e postulateve dhe këshillave - mund të duken si idealiste ose naive, ato janë ende të rëndësishme në kohën tonë. Disa koncepte kyçe shqyrtohen dhe ilustrohen nga shembuj të etikës stoike që fokusohen në qëllimin përfundimtar të njeriut: lumturinë dhe mirëqenien e tij. Metodologjikisht shpalosen probleme të ndryshme lidhur me çështjen e lumturisë, dilemat dhe gjendjen aporike që ato duket se gjenerojnë dhe më pas analizohen zgjidhjet përkatëse të stoikëve. Në këtë drejtim, çështja e lumturisë dhe mirëqenies lidhet me probleme të tilla si roli i të mirave materiale, prania e të tjerëve, ngjarjet dhe faktorët që kushtëzojnë realizimin e lumturisë, kushtet e gjendjeve trupore dhe vullneti i njeriut. Për rrjedhojë, etika stoike mbetet edhe më e rëndësishme në kohët e sotme dhe shfaqet si një mënyrë e mundshme për të zgjedhur një jetë të lumtur dhe të suksesshme shpirtërisht, pasi elementët e sipërpërmendur shfaqin një prani më të fortë dhe më dominuese në kohën tonë.

Fjalët çelës: *Lumturi, mirëqenie, qetësi shpirtërore, zgjedhje, gjërat materiale, vullneti.*

Dr. Ledian RUSTA është lektor në Departamentin e Filozofisë në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Ai ka marrë pjesë në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe ka botuar artikuj në revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti. Fushat e tij të interesit janë logjika, epistemologjia, filozofia bashkëkohore dhe komunikimi. Është autor i monografisë "Kështu foli Nietzsche".

Lumturia dhe raporti me botën e jashtme

Në të vërtetë, në antikitet shpalosen dy tipologji etikash që mund t'i cilësojmë si subjektive dhe objektive, por në një kuptim krejt të veçantë nga sa konceptohen në literaturë. Pyetja që drejton përgjigjet e ndara është: lumturia është një gjendje që mund të arrihet e papenguar nga rrethanat dhe kushte e jashtme (materiale) apo ato janë të nevojshme si optimum për ta mundësuar atë? Dhe në një kuptim më të drejtpërdrejtë: Virtyti, a përbën një kusht të mjaftueshëm për të arritur lumturinë apo jo? Etika aristoteliane e kishte cilësuar si të pamjaftueshëm zotërimin dhe shpalosjen e veprimeve të virtytshme për të realizuar lumturinë pasi duhej mbështetur edhe nga rrethana të jashtme të favorshme. Ndërkohë stoicizmi mendon se virtyti dhe një gjendje e veçantë shpirtërore që jo vetëm është e mjaftueshme por përbën edhe kushtin e vetëm. “Stoikët ruajnë në një formë të fortë, eksplicite dhe të përpunuar tezën se lumturia bazohet vetëm në virtyt dhe nuk varet nga gjëra të tjera që konsiderohen gjerësisht si të mira” (Gill, 2022: 21). Për këtë arsye, etikën e stoicizmit mund ta cilësojmë si subjektive përse qëllimësia e saj përftohet vetëm nga një gatishmëri dhe gjendje e veçantë shpirtërore e individit, e pavarur dhe të pandikueshme nga rrethanat e jashtme materiale. Në këtë kuptim, stoikët “ndajnë një interes të përgjithshëm për të përvetësuar plotësisht lumturinë; projekti i tyre ishte që ta bënin lumturinë të varej në thelb nga karakteri moral dhe besimet e vepruesit, dhe në këtë mënyrë të minimizonin ose të zvogëlonin varësinë e tij nga rrethanat e jashtme” (Stephens, 2017: 1).

Për stoicizmin në përgjithësi, të mirat e jashtme (shëndeti, mungesa e varfërisë etj) edhe pse janë të dëshirueshme për individin, nuk mund ta nënshtrojnë atë të arrijë lumturinë pasi janë të denja vetëm nga aspekti natyror. Pra rrethanat dhe të mira e

jashtme (objektive) janë moralisht asnjëse ose zotërojnë një vlerë jo-morale. Për shembull, shëndeti nuk përbën një të mirë në vetvete por është i çmueshëm vetëm mënyra sesi ai përdoret për të arritur qëllimin final: lumturinë. “Dhe kështu duhet të jetë në jetë. ‘Të jesh i shëndetshëm është mirë, të jesh i sëmurë është keq.’ Jo, miku im: të shijosh shëndetin në mënyrën e duhur është mirë; përdorimi i keq i shëndetit tënd është gjë e keqe” (Epictetus & Dobbin, 2008: 153).

Nga ana tjetër, stoikët i mbeten besnikë një tradite të konceptimit të etikës e quajtur si intelektualizëm, shpalosur fillimisht nga Sokrati. Kjo lloj etike pranonte se të jetuarit mirë dhe lumturia arrihen kur jeton në përputhje me arsyen. Në rastin e stoicizmit, të jetuarit në përputhje me arsyen është e drejtuar nga gjykimi dhe të kuptuarit e pozicionit dhe aftësive të njeriut. Pra arsyeja ushtrohet për të kuptuar se çfarë është në zotërimin njerëzor dhe çfarë veprimi duhet të ndërmerret në përputhje me rrethanat që paraqiten. Megjithatë pavarësisht se etika stoike cilësohet shpesh si subjektive ajo ushtrohet në prani të të tjerëve dhe komunitetit njerëzor. Pra pavarësisht se në vetvete individ kryen një lloj ‘asketizmi’ për të mos u ndikuar nga rrethanat e jashtme në arrijtjen e lumturisë, kjo rrugë ndërpritet nga marrëdhënia me të njerëzit e tjerë. Këta të fundit, nuk janë një pengesë nëse shfaqen si burim gëzimi dhe dashurie.

Më tej, etika stoike ishte e vetëdijshme se njeriu, krahas të tjerave, është edhe një qenie natyrore: pra në veprimin e tij ai duhet të kuptojë gjërat që janë ose jo në vullnetin dhe zotërimin e tij. Sipas Epiktetosit, edhe gjendjet si *phantasia* janë në zotërimin e njeriut pasi nuk rrjedhin në vetvete nga objektet fizike por janë ndërtime konceptuale të mendjes. Ndërkohë ndër gjërat e tjera dhe të shumta që nuk janë në zotërimin dhe vullnetin tonë mund të rendisim “trupin, pjesët e trupit, zotërimet, prindërit, vëllezërit, fëmijët, atdheu...” (White, 1983: 11). Sigurisht gjërat që përmendëm janë të

rëndësishme por ato nuk janë si gjërat që për nga natyra janë të lira dhe të papenguara. Prandaj rrethanat e jashtme nuk kanë një vlerë morale në dy këndvështrime kryesore: 1) e mira dhe e keqja nuk dallojnë nga njëra tjetra në aspektin e intensitetit apo gradës por janë elementë të denjë për tu zgjedhur (e mira) ose jo (e keqja); 2) synimi i zotërimit të objekteve të jashtme si pasja e një shtëpie të bukur, na shtyn të veprojmë (veprimi për ta zotëruar shtëpinë) sepse ajo cilësohet si një e mirë nga dikush.

Më tej, interesi i stoikëve për të mos u përqendruar tek gjërat e jashtme, veçanërisht ato materiale, lidhet me faktin se ato janë të shumta dhe e turbullojnë shpirtin. Dhe “duke qenë të lidhur me shumë gjëra, ne shqetësohemi shumë dhe tërhiqemi zvarrë së bashku me to” (Epictetus & Dobbin, 2008: 29). Ndërkohë, një arsye për tu mos fokusuar tek gjërat e jashtme rrjedh nga fakti se dhimbja dhe dëshpërimi vjen pikërisht nga to: kur i dëshirojmë dhe nuk i zotërojmë dot. Në këtë kuptim, mos zotërimi i tyre jo vetëm sjell dhimbje por edhe një varësi. Për stoikët, varësia nga gjërat e jashtme shihet si një nga shkaqet themelore për mos përmbushjen e një jete të mirë. Ato ngjallin një oreks që përshkon një spirale pambarim. Kështu pas përftimit të kënaqësisë pas konsumimit të një gjëje materiale, vijon një dhimbje kur kjo gjë nuk është më. Por në mënyrë që të përmbushet kënaqësia e mëparshme duhet kaluar në një varg konsumimi përherë e më të madh, pa mbarim. Megjithatë realiteti material jo vetëm është i kufizuar por edhe mundësitë e njeriut për ta zotëruar, gjithashtu. Prandaj në këtë lojë zotërimi ku dështimi i njeriut është i sigurt, duke lënë pas vetëm një dhembje e madhe, stoikët paraqesin një recetë më modeste e logjike për të përmbushur e realizuar një jetë të mirë e të qetë. Stoikët si Epiktetusi nuk e cilësojnë të mirën si element apo gjendje që gjendet tek gjërat e jashtme. Nëse do të ishte e kundërta atëherë njerëzit do të synonin gjërat e jashtme. Por

duke qenë të kufizuara do të shkaktonin konflikte ndër njerëz në përpjekje për t'i zotëruar ato. Pikërisht sipas Epiktetusit këtu qëndron edhe rrënja e një jete jo të lumtur dhe shkak kryesor i konflikteve sociale dhe politike. Megjithatë stoikët besojnë se kjo shtysë natyrore njeriut (për vetëruajtje) nuk është iracionale dhe jashtë kontrollit të tij por mund të kontrollohet, moderohet dhe drejtohet racionalisht.

Nga ana tjetër, në raport me gjërat e jashtme, Epiktetusi kryen një arsyetim logjik që shërben për përmbushjen dhe realizimin e një jete të mirë. Ai këshillon që njerëzit të jenë të matur dhe t'i përmbahen një numri të kufizuar gjërash të jashtme pasi në këtë mënyrë njeriu ka më shumë mundësi t'i përfitojë ato. Këshilla e Epiktetusit është: “Mos dëshiro shumë gjëra dhe ti do t'i përfitosh ato” (Epictetus & Dobbin, 2008: 158). Prandaj, nëse e fokusojmë të mirën tek gjërat e jashtme, e në veçanti në ato materiale, shpirti jonë do të varet tërësisht nga to dhe mos përfitimi i tyre do të sjell një shqetësim e dhimbje tek ne.

Prohairesis, gjërat e jashtme dhe gjykimi si çështje etike

Dhe në këtë dinamikë, Epiktetusi vlerëson si shumë të rëndësishme konceptin e *prohairesis* që nënkupton aftësinë për të ushtruar vullnetin tonë, pra elementi që mundëson zgjedhjen e diçkaje. Sipas tij, është *prohairesis*, fuqia racionale e vullnetit të njeriut, ai që kontrollon dhe drejton veprimet e njeriut në botë. Për këtë arsye, “Epictetus mendon se të vendosësh, zgjedhësh, do të thotë të jesh i lirë” (Stephens, 2017,18). Kjo nënkupton se edhe mirëqenia e njeriut është në fuqinë dhe në kontrollin e tij pasi nuk varet nga gjërat e jashtme. Prandaj për Epiktetusin nuk ekziston diçka si fati moral. Për të, “aftësia e zgjedhjes, ky vendimmarrës, ky vend i zgjedhjes morale dhe vetëpërcaktuesi [është] vetë thelbi i personit” (Stephens, 2017: 23).

Nga ana tjetër, Epiktetusi shquan edhe një lidhje tjetër të rëndësishme mes vetes (unit) dhe gjykimeve që ajo shpreh apo shpalos. Janë gjykimet ato që zbulojnë unin e njeriut prandaj njeriu i kultivuar dhe i ditur zotëron përherë gjykime të mira e të drejta. Shtysa e vetme gjendet në vullnetin dhe fuqinë së brendshme të njeriut për të marrë vendime të drejta. “Është gjykimi (dogma) i bërë ose i kryer nga vepruesi që e shtyn atë të veprojë ashtu siç bën” (Stephens, 2017: 26). Pra karakteri moral i një personi shfaqet tërësisht dhe vetëm nga gjykimet që ai kryen në botë. Është gjykimi ai që e përcakton etikisht veprimin. Rrjedhimisht pasojat e veprimit, qoftë i mirë apo i keq, janë të parëndësishme për Epiktetusin pasi ato nuk janë më në zotërimin dhe vullnetin e njeriut. Kjo është arsyeja përse pasojat e veprimit qëndrojnë jashtë sferës së vlerësimit moral. Vetëm gjykimet që e shtyjnë njeriun të veprojë është i vetmi element që meriton një vlerësim moral pasi veprimi i ndarë nga gjykimet që e motivojnë është asnjans nga ana morale.

Nga ana tjetër, theksi që stoikët vendosin mbi vullnetin e njeriut dhe gjykimet e tij nënkupton se vetëm individi mund të ndihmojë ose dëmtojë vetveten: pra gjykimet e tij. Në këtë kuptim, “Epiktetusi thjesht pohon se është gjykimi i vetë individit për situatën që dëmton ose ndihmon veten e tij të vërtetë, as rrethanat e jashtme, as veprimet ose mosveprimet e një tjetri, nuk mund të ndikojnë në të” (Stephens, 2017: 30). Për pasojë, e keqja dhe dhimbja është fryt i gjykimeve tona kur këto të fundit e shquajnë vlerën tek gjërat e jashtme e në veçanti në ato materiale. Dhimbja dhe vuajtja lind kur eventualiteti i saj, përmes gjykimit, vlerësohet se buron dhe qëndron tek gjërat e jashtme, jashtë shpirtit dhe mendjes.

Nga ana tjetër, duke qenë se e mira dhe e keqja janë frut i gjykimit atëherë është në dorën e vullnetit njerëzor për t’i krijuar apo

shmangur ato. E gjithë çështja qëndron sesi shpirti vendos të përdor përshtypjet e jashtme apo gjërat materiale përmes gjykimeve që ai kryen për to. Prandaj Epiktetusi e cilëson si tepër themelor procesin e edukimit. Ky i fundit ka detyrën e vetme t’i mësojë njeriut se ‘çfarë janë’ gjërat në dorën e njeriut dhe cilat jo. Sipas tij, gjërat që nuk janë në dorën e njeriut nuk duhet të përbëjnë një shqetësim real për të. Prandaj për stoikët lumturia nuk përbën një ideal utopik të parealizueshëm. Duke qenë se lumturia është tërësisht në dorën e njeriut pasi përbën një çështje vet-përcaktimi, vet-gjykimi dhe vetëvendosje në varësi të vullnetit të njeriut atëherë ajo shfaqet si e mundur në këtë botë. Në këtë premisë, shqetësimet që vijnë nga gjërat e jashtme nuk ndodhin sepse ato në vetvete kanë një vlerë negative por është raporti ynë me to, pra gjykimi ynë për to që shkaktojnë këtë gjendje të turbullt shpirtërore. Kështu dhimbja nuk vjen si pasojë e “një ngjarje dhe një reagimi, por e një ngjarje, e më pas një gjykim apo mendim për të, dhe më pas një reagim (ndaj gjykimit apo mendimit” (Farnsworth, 2018: 32).

Më tej, edhe pse Epiktetusi i konsideron gjërat e jashtme se nuk zotërojnë vlerë të brendshme morale, megjithatë ato shfaqin një dobi për mirëqenien tonë. p.sh trupi nëse përdoret mirë mundëson zgjedhjet e drejta. Pra gjërat e jashtme kanë një vlerë instrumentale që mundësojnë më mirë mirëqenien tonë. Në këtë perspektivë, lumturia nënkupton përdorimin me kujdes dhe maturi të gjërave të jashtme, për të mos shkaktuar dhimbje dhe vuajtje.

Racionaliteti i fatit dhe kozmosi

Edhe pse pasojat e veprimit nuk janë nën zotërimin tonë, stoikët nuk shkurajojnë njeriun që të humb qetësinë shpirtërore nëse veprimi tij nuk arrin qëllimin e dëshiruar. Sipas Epiktetustit, dëshira për të pasur pushtet mbi atë që është jashtë

kontrollit tonë, përbën diçka iracionale. Sipas tij, të gjitha ngjarjet e jashtme janë jashtë kontrollit tonë e për pasojë nuk duhet të shqetësohemi pasi ato janë asnjëherë në aspektin aksiologjik. Përderisa ngjarjet nuk lidhen me një përgjegjësi morale atëherë ato nuk duhet ta shqetësojnë njeriun. Sipas stoikëve, kjo është rruga kryesore për të arritur paqen dhe qetësinë shpirtërore. Kjo nënkupton se “asnjë rrjedhë e ngjarjeve nuk na pengon për të prodhuar dogmatën e duhur e cila na mundëson të jetojmë në përputhje me natyrën (virtutshëm), e kjo është ajo që filozofi bën, sipas Epitektusit” (Stephens, 2017: 55). Kështu njeriu i mençur dëshiron që gjërat të ndodhin ashtu siç ndodhin, pra siç janë në përputhje me natyrën. Ontologjikisht, stoikët besojnë se kozmosi është i udhëhequr nga një Logos kozmik dhe gjërat që ndodhin kanë një arsye. Prandaj, ata besojnë se fati është diçka racionale pasi ngjarjet udhëhiqen dhe mundësohen eventualisht nga ky Logos kozmik. Pikërisht, pranimi dhe njohja e këtij postulati sjell lumturi dhe gëzim në jetën e njeriut. Në thelb, “eudaimonizmi i stoikëve bazohet kryesisht në atë se si qeniet njerëzore i qëndrojnë një bote të përcaktuar dhe të qeverisur në mënyrë providenciale” (Long, 1996: 189). Në etikën stoike, koncepti i fatit si eventualitet shkakësor dhe determinist nënkupton se “... kur diçka ndodh sipas fatit dhe përmes shkaqeve të mëparshme, atëherë nuk ndodh për shkakun tonë. Pra nuk është në dorën tonë, nuk varet nga ne, por varet nga fati” (Bobzien, 1997: 74). Në këtë konceptim, stoikët janë tepër të qartë se ‘çfarë është’ apo jo në vullnetin dhe zotërimi e njeriut. Për “Epiktetusin modaliteti i shprehjes ‘është në dorën tonë’[nënkupton] ato që janë në dorën tonë në të gjitha rrethanat e mundshme dhe me një siguri absolute” (Bobzien, 1997: 80).

Nga ana tjetër, në raport me fatin, etika stoike për arritjen e lumturisë nuk duket diçka utopike por tepër e arritshme nga

njeriu. Në hapësirën e veprimit njerëzor, njohja e fatit është e domosdoshme për realizimin e lumturisë në dy aspekte themelore. Së pari, lidhet me një pragmatikë të veprimit për të minimizuar dhimbjen dhe ndjesitë e tjera që shqetësojnë qetësinë shpirtërore. Pra, nëse do të njihim mirë fatin (të ardhmen) dhe kufijtë tanë atëherë planet e ardhme do të jenë më realiste e për pasojë zhgënjimet do të minizohen ose shmangen. Së dyti, për Epitektusin, arritja e mirëqenies dhe lumturisë përbën një qëllim të arritshëm përderisa gjërat që janë në dorën tonë janë më të pakta sa ato që janë përcaktuar nga fati.

E mira e të tjerëve si shqetësim i imi

Sipas pikëpamjes së stoikëve, çdo njeri vepron për hir të të mirës së tij. Megjithatë si qëndron raporti me tjetrin në aspektin etik? A mund të themi se stoicizimi themelon një etike egoistike që e pamundëson themelimin e një të mire të përbashkët? Fillimisht duhet të përmendim se koncepti i lumturisë së Epiktetusit lidhet me natyrën e njeriut në përgjithësi. Sipas tij, të gjithë njerëzit individualisht kërkojnë të ndjekin të mirën dhe lumturinë prandaj lumturia e gjithsecilit kontribuon në lumturinë e përgjithshme të komunitetit. Por “për të lënë vend, pra, për të mirën e të tjerëve, Epikteti duhet të tregojë se mesazhi i tij për lirinë mendore nuk është një përfitim solipsist, por i favorshëm nga pikëpamja shoqërore dhe në përputhje me të jetuarit në harmoni me natyrën njerëzore si i ndërtuar gjerësisht” (Long, 2018: 19).

Nga ana tjetër, njeriu pashmangshmërisht përbën një qenie që zotëron shumë role dhe marrëdhënie: si prind, si qytetar, si bashkëshort etj. Për rrjedhojë, ai duhet t’i përmbush në mënyrë sa më virtuozë dhe në përputhje me natyrën rolin e tij, që të jetë i lumtur. Por në dorën dhe vullneti tonë është mënyra sesi ne

veprojmë ndaj të tjerëve dhe jo mënyra sesi të tjerët veprojnë ndaj nesh. Megjithatë edhe nëse të tjerët do vepronin në mënyrë të dëmshme ndaj nesh, kjo nuk duhet të na shqetësojë dhe turbullojë paqen shpirtërore pasi këto veprime nuk janë në dorën dhe vullnetin tonë.

Më tej, veprimi në mënyrë të denjë dhe të virtytshme me të tjerët, “ rrjedh vetëm në mënyrë indirekte nga vendimi ynë për të vlerësuar virtytet e nevojshme që të mbaj vullnetin tonë në gjendjen e duhur dhe të shëndetshme në përputhje me natyrën” (Stephens, 2017: 86). Kështu veprimet dhe virtytet si ndershmëria, bujaria, drejtësia etj., nuk rrjedhin apo e marrin shtysën nga jashtë (nga dëshira për t’i bërë mirë të tjerëve) por nga fakti se është gjykimi dhe vullneti ynë që i zgjedh apo i kryen ato. Në këtë kuptim, e mira nuk është një pasojë që zbulohet dhe shfaqet në veprimet e jashtme për të tjerët, por është shkaku që na shtyn së brendshmi të zgjidhim dhe të dëshirojmë të veprojmë në këtë mënyrë. “Prandaj, sjellja e duhur ndaj njerëzve të tjerë llogaritet si një e mirë për stoikun, pasi ajo rrjedh nga dhe kërkohet nga virtytet e vetvetes. Vetë njerëzit, sidoqoftë, nuk llogariten si ‘të mira’ (agatha) megjithëse nga të gjitha gjërat e jashtmet ata janë më ‘të vlefshmet’ (aksia)” (Stephens, 2017: 86-87). Për shembull, në rastin kur një prind rrezikon jetën e tij për të shpëtuar fëmijën nga rreziku, kjo nuk ndodh sepse jeta e fëmijës është një e mirë në vetvete që kërkon mbrojtjen e prindit por sepse mbrojtja e fëmijës është një nga funksionet dhe rolet e prindërimit. Pra ushtrimi si virtytshëm i këtij roli është një kusht i domosdoshëm për të ruajtur kushtet e drejta për të zgjedhur dhe për të qenë të lumtur si prind. Në këtë kuptim, prindi kërkon dhe e realizon të mirën e tij duke ushtruar funksionin e tij për shkak se kjo është në përputhje me natyrën e rolit të tij si prind (të mbrojtë fëmijën). Nisur nga kjo situatë konkrete, kuptojmë se në çdo situatë të jashtme pakënaqësie apo dhimbje, etika

stoike gjen të mirat e vërteta në brendësi të shpirtit të njeriut. Për këtë arsye, stoikët i kushtojnë rëndësi gjërave materiale vetëm në një “minimum si optimum”: si mjet që mbështet minimalisht jetën për t’i mundësuar njeriut të kryejë funksionet e shumëfishta në Polis: si prind, bashkëshort, qytetar, funksionar publik etj. Në këtë kuptim, pasuria dhe bollëku material janë të nevojshëm jo për mirëqenien individuale por për të mundësuar dhe mbështetur jetën e të tjerëve.

Nga ana tjetër, sipas stoikëve, këto akte besohet se do t’i shtynë të tjerët më lehtë të përftojnë edhe ata paqen shpirtërore dhe lumturinë. Megjithatë këtu ngrihet një pyetje e rëndësishme: nëse për stoikët jeta e të tjerëve nuk cilësohet si një e mirë përse është e jashtme, atëherë si ka mundësi që ai vepron në të mirë të të tjerëve, përmes ndjenjave si dashuria? “Epikteti beson se kujdesi për të tjerët është i natyrshëm në (rastet jopatologjike të) natyrës njerëzore. Ai pohon se njerëzit për nga natyra janë fisnikë, kanë një ndjenjë turpi dhe se është natyra jonë t’ia nënshtrojmë kënaqësinë, kryerjes së virtytshme të detyrave tona shoqërore” (Stephens, 2017: 91). Sipas Epitektusit, është në përputhje me natyrën tonë, që kënaqësitë t’i nënshtrojmë ndaj detyrave dhe obligimeve tona si njerëz të Polisit. Në aspektin antropologjik, kjo nënkupton se njeriu në thelb ka lindur si një qenie komunitare përse i ngjizur si një shumësi rolesh dhe funksionesh në shoqëri. Mirëpo kjo mënyrë të vepruari kryen dhe përmbush sy aspekte sipas stoikëve: së pari, përbën diçka natyrore dhe të zakonshme që të gjemë kënaqësi në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve sociale. Së dyti, është një gjë e mirë dhe racionale që të veprojmë në këtë mënyrë.

Nga ana tjetër, stoikët theksojnë se të gjitha këto vlera nuk bëhen me synimin për të bërë të tjerët të lumtur pasi kjo nënkupton një instancë të jashtme. Ato janë të nevojshme, edhe pse prekin

pozitivisht jetën e të tjerëve, sepse se janë të përputhshme me natyrën njerëzore e si të tilla duhen ushtruar dhe shpalosur në botë. Ato janë të nevojshme për të vet-ruajtur dhe prosperuar lumturinë dhe qetësinë shpirtërore. Por si mund ta kuptojmë idenë e stoikëve se jeta e të tjerëve nuk duhet të na shqetësojë edhe nëse dikush dashuron dikë që më pas ikën nga kjo botë? Si mund dikush të mos ndjejë dhimbje me ikjen e tij nga kjo botë? Fillimisht, stoikët kërkojnë të zgjidhin këtë dilemë duke bërë dallimin mes ndjenjave natyrore (si dashuria) që janë tërësisht pozitive dhe ndjenjave që shqetësojnë qetësinë shpirtërore. Kështu p.sh afeksioni familjar përbën një ndjenjë natyrore njerëzore, por jo një pasion. Në këtë kuptim, stoikët i kushtojnë rëndësi vetëm pasionit si gjendje që mund të shkatërrojë gjendjen shpirtërore. Pra dashuria sipas tyre nuk duhet të bëhet një patos apo pasion, por duhet të mbetet në sferën e ndjenjës njerëzore. Për pasojë, njerëzit duhet të bashkëndajnë dhe të bashkohen në lumturi por jo në dhimbje dhe trishtim. Sipas stoikëve, dhimbja dhe trishtimi i tjetrit nuk duhet të brendësohet dhe të bëhet dhimbja ime pasi ky është një fakt i jashtëm që turbullon qetësinë mendore dhe shpirtërore. Përherë dhimbja ndodh si një keqgjykim kur diçka e jashtme cilësohet si e keqe apo e dëmshme. Më pas, ajo kthehet në pasion, pra si një domosdoshmëri për të përmbushur

një jetë të mirë. Për rrjedhojë, duke qenë se e keqja është një keqgjykim atëherë sado që dikush vuan për dhimbjen e dikujt, ai nuk ja shuan dot këtë gjendje. E vetmja mënyrë që të pushojë dhimbja e dikujt dhe rrjedhimisht edhe e tjetrit që ndjen për të është që ai të gjykojë drejt dhe të mos ta shoh të mirën dhe lumturinë të gjërat e jashtme. Në një kuptim kozmologjik, Epiktetusi mendon se gjërat jashtë nesh (gjërat materiale apo njerëzit) nuk janë në zotërimin tonë, prandaj nuk duhet të vuajmë kur i humbim ato. Vdekja si edhe lindja bën pjesë në ciklin natyror të njeriut prandaj nuk duhet të përbëj shkak për shqetësim dhe dhimbje. Sipas Epiktetusit, nëse dikush e kupton këtë fakt natyror të pashmangshëm të jetës, atëherë jo vetëm që duhet t'i duam të tjerët kur janë në këtë botë, por duhet të ndalojmë që kjo ndjenjë të intensifikohet në një patos apo pasion shkatërrues. “Përkundrazi, dashuria dhe dashuria e natyrshme e stoikut zbuten nga arsyeja dhe shërben vetëm për të pasuruar humanitetin e saj, për të mos e nënshtruar kurrë atë ndaj mundimeve emocionale ose mendore” (Stephens, 2017, 106). Por për ta arritur këtë gjë nevojitet shumë edukim dhe kohë. Për këtë shkak, Epitetusi mendon se vetëm i mençuri dashuron me të vërtetë pasi nuk lejon që dashuria të kthehet në një patos që korrupton lumturinë dhe qetësinë shpirtërore.

REFERENCAT

- Bobzien, S. (1997). “Stoic conception of freedom and their relation to ethics”, *Bulletin of the Institute of Classical Studies*, no.68. pp. 71-89.
- Epictetus, & Dobbin, R. F. (2008). *Discourses and selected writings*, Penguin.
- Farnsworth, W. (2018). *The practicing stoic*, David R. Godine Publisher
- Gill, Ch. (2022). *Learning to live naturally. Stoic ethics and its modern significance*, Oxford University Press.
- Long, A. A. (2018). *How to be free: An ancient guide to the stoic life*, Princeton University Press.
- Long, A.A. (1996). *Stoic Studies*, University of California Press.
- Stephens, W. O. (2017). *Stoic ethics: Epictetus and happiness as freedom*, Bloomsbury.
- White, N. (1983). *Handbook of Epictetus*, Hackett Publishing Co.

ABSTRACT

In regard to the concept of human happiness and well-being, the paper analyzes some significant ethical moments of the Stoics as well as those of Epictetus, the most well-known representative of this philosophical school. Even though this school's concepts—which also come to us in the form of postulates and advice—might come across as idealistic or naive, they are still relevant in our time. Some key concepts are explored and illustrated by instances of Stoic ethics that focus on man's ultimate purpose: his happiness and well-being. Methodologically, various problems related to the question of happiness, the dilemmas and the aporic state that they seem to generate are revealed, and then the corresponding solutions of the Stoics are analyzed. In this regard, the question of happiness and well-being is related to such problems as the role of material goods, the presence of others, the events and factors that condition the realization of happiness, the conditions of bodily states and human will. Consequently, Stoic ethics remains even more relevant in today's times and appears as a possible way to choose a happy and spiritually successful life, as the above-mentioned elements display a stronger and more dominant presence in our time.

Keywords: *Happiness, well-being, peace of mind, choice, material things, will.*

ADOLESHENTËT, NGACMIMI KIBERNETIK DHE LIGJI. NJË PËRMBLEDHJE E SFIDAVE PSIKOLOGJIKE DHE LIGJORE

Ardita PRENDI

Universiteti Marin Barleti Tiranë

E-mail: arditaprendi@gmail.com

Flutura SHABANI

Universiteti Marin Barleti Tiranë

(Master Ekzekutiv)

E-mail: law.co@umb.edu.al

PËRMBLEDHJE

Ngacmimi kibernetik është një nga sfidat më të mëdha për shoqërinë dixhitale, me ndikime në shëndetin mendor të adoleshentëve. Rritja e numrit të rrjeteve sociale, aplikacioneve të mesazheve të çastit dhe platformave të lojërave online i ka bërë adoleshentët më të ekspozuar se kurrë ndaj ngacmimeve, frikësimeve dhe përjashtimeve të mundshme. Efektet e ngacmimit kibernetik ndryshojnë në varësi të individit, por pasojat e tij përfshijnë vetëbesim të ulët, ankth, ndjenja trishtimi, të qenit i frikësuar, depresion, zemërim, ulje të arritjeve akademike, një tendencë në rritje për të ngacmuar të tjerët, dhunë në shkollë dhe madje edhe vetëvrasje. Megjithatë prindërit, shkollat dhe faqet e rrjeteve sociale në internet inkurajohen të ofrojnë një mjedis të sigurt në internet, dihet pak për rrugët ligjore që mund të përdoren për të parandaluar ose për të vepruar si frenues ndaj bullizmit kibernetik. Ky artikull synonte të kryente një rishikim sistematik të provave empirike që trajtojnë se si përvojat e bullizmit kibernetik ndikojnë në perceptimet e adoleshentëve për vetë-imazhin dhe mirëqenien, si dhe përprjekjet për të eksploruar ligjet dhe sfidat aktuale që ekzistojnë për krijimin e legjislacionit të bullizmit kibernetik. Metoda e këtij rishikimi sistematik është zhvilluar në përputhje me Kriteret e Preferuara të Raportimit për Rishikimet Sistematike dhe Meta-Analizat (PRISMA). Sipas shumë studimeve, ngacmimi dhe ngacmimi kibernetik mund të kenë pasoja shkatërruese në shëndetin mendor dhe fizik të fëmijës; prandaj dënimi duhet të jetë i barabartë me ndikimin.

Teknologjia ka ofruar disa zgjidhje për raportimin dhe reduktimin e bullizmit kibernetik, megjithëse mund të mos gjykohej si plotësisht efikas për momentin, çështjet e juridiksionit dhe faktorë të tjerë psiko-socialë rezultojnë të jenë sfidues. Shkollat dhe prindërit duhet të jenë të parët që trajtojnë atë. Adoleshentët duhet të edukohen për natyrën e qëndrueshme dhe publike të përmbajtjes në internet. Ata duhet të kuptojnë se sapo të postohet diçka, ajo kurrë nuk mund të fshihet plotësisht nga interneti.

Fjalë kyçe: *vetë-imagjia, mirëqenia, adoleshentët, bullizmi kibernetik, ligj*

Prof. Asoc. Dr. **Ardita PRENDI** është lektore me një eksperiencë 22 vite në mësimdhënie në Universitete Publike dhe Private në Shqipëri. Autore e bashkautore e disa artikujve shkencorë në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrëse në trajnime e workshope, konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, anëtare në borde organizative dhe shkencore në revista dhe konferenca shkencore. Licencuar nga Urdhri i Psikologut si Mbikëqyrëse dhe Psikologe.

ME. **Flutura SHABANI** është pedagogje në Departamentin e Drejtësisë në Universitetin Barleti. Ajo ka mbi 10 vjet përvojë si pedagogje në fushën e së Drejtës. Ndër arritjet e saj janë pjesëmarrja në borde organizative dhe shkencore dhe në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe autore e shumë artikujve shkencorë botuar në revista dhe buletine kombëtare e ndërkombëtare. Eksperte në disa projekte të Bashkimit Europian, UNDP, USAID.

Ngacmimi (bullizmi) është një problem i madh tek të rinjtë dhe individët e përfshirë janë në rrezik për probleme psikologjike si: simptoma psikosomatike, depresion dhe tentativë ose vetëvrasje aktuale (Landstedt & Gillander, 2011). Ngacmimi tradicional mund të përfshijë veprime fizike, abuzim verbal dhe veprime si përjashtimi social apo përhapja e thashethemeve. Sipas përkufizimit të Olweus (1994), bullizmi ndodh kur një person është i ekspozuar ndaj veprimeve negative në mënyrë të përsëritur me kalimin e kohës, nga një ose disa njerëz në rrethin e tij shoqëror. Për adoleshentët, shkolla është arena kryesore e bullizmit. Teknologjia dixhitale ka krijuar mënyra të reja për të ndërvepruar dhe si rrjedhojë ka hapësira dhe vende të reja për ngacmimet. Adoleshentët përdorin gjerësisht komunikimin e bazuar në elektronikë dhe për këtë arsye janë në rrezik nga bullizmi kibernetik (Ybarra, Mitchell & Korchmaros, 2011). Studiuesit Kiriakidis & Kavoura (2010) pohojnë se ngacmimi kibernetik është konceptuar si ngacmim ku një medium elektronik përdoret për të kërcënuar ose dëmtuar apo për të shkaktuar poshtërim dhe frikë.

Shembuj të ngacmimeve kibernetike përfshijnë dërgimin e mesazheve të pahijshme, vjedhjen e informacionit të identitetit; pretendimin se jeni dikush tjetër; kryerjen e telefonatave anonime; ndarjen e sekreteve rreth viktimës duke postuar ose dërguar sekretin e dikujt tjetër; duke mashtruar dikë për të ndarë një sekret dhe më pas duke përhapur sekretin përreth; duke përhapur thashetheme të këqija apo të pavërteta; duke përdorur faqet e rrjeteve sociale; duke kërcënuar se do të dëmtojë dikë në botën offline; ose duke ngarkuar një foto ose video të turpshme të një videoje.

Gjatë vitit 2023, në platformën iSIGURT.al janë bërë 244 raportime të incidenteve të ndeshura online nga fëmijët apo prindër, mësues, kujdestarë të tyre. Gjetjet e raportit krahasuar me vitin e kaluar kanë vënë në dukje një rritje me 160 për qind të incidenteve të raportuara nga dhe për fëmijët. Çdo muaj raportohen të paktën 20 incidente online nga fëmijët. Rreth 62 për qind e të gjitha incidenteve të raportuara në iSIGURT.al janë bërë nga vajzat dhe rreth 34 për qind nga djemtë. Për herë të parë vajzat po raportojnë thujtse 2 herë më shumë se djemtë incidente gjatë navigimit

të tyre online. Grup-mosha e raportuesve vijon të udhëhiqet nga adoleshentët e moshës 15-18 vjeç, të ndjekur nga ata të grup-moshave 18-30 vjeç dhe 11-14 vjeç. Tik-tok dhe Instagram janë dy platformat të cilat fëmijët i kanë raportuar më shpesh për incidente online, me 47 dhe 27 për qind të rasteve, krahasuar me platformat e tjera. Bullizmi online është incidenti më i raportuar nga fëmijët dhe adoleshentët, në rreth 35 për qind të rasteve, të ndjekur në 21 për qind të rasteve nga gjuha e urrejtjes dhe 15 për qind shantazhe dhe kërcënime online. Dhuna, ngacmimet dhe shfrytëzimi seksual online ka kaluar në vend të katërt të incidenteve të raportuara, ndërkohë që deri në vitin e kaluar përbënte incidentin kryesor të raportuar nga fëmijët dhe adoleshentët.

Shqyrtim literature

Ngacmimi kibernetik ndodh në natyra apo mënyra të panumërta teknologjike. Studiuesit Smith et al. (2008) e përkufizuan bullizmin kibernetik si përdorimin e teknologjive elektronike nga të rinjtë për të ngacmuar, vënë në siklet dhe frikësuar të tjerët me qëllim armiqësor. Pjesa e “qëllimit armiqësor” e përkufizimit është një kërkesë që një sjellje ose sjellje e veçantë të kualifikohet si ngacmim kibernetik. Sipas Willard (2005), ngacmimi kibernetik përfshin zbulimin publik të informacionit personal; dërgimin e mesazheve të dëmshme ose kërcënuese, postimin e komenteve nënçmuese në faqet e internetit ose rrjetet sociale, kërcënimin fizik dhe frikësimin e dikujt në një sërë mjedisesh në internet (Burgess, Patchin & Hinduja, 2009); krijimin e faqeve të internetit me përmbajtje dhe postimin e fotografive duke u kërkuar njerëzve të tjerë të vlerësojnë gjërat, pa pëlqimin e një individi (Willard, 2005); duke shqetësuar dikë në internet duke ngacmuar në një mënyrë të keqe, duke telefonuar dikë me emra lëndues, lënia e qëllimshme e personave jashtë gjërave, kërcënim i

dikujt dhe thënia e gjërave të padëshiruara seksualisht (Patchin & Hinduja, 2006) etj.

Qasja në teknologjinë e lartë, hakmarrja, anonimiteti i perceptuar, mungesa e ndërjegjegjësimit, mungesa e mbikëqyrjes së familjes (Wells & Mitchell, 2008), përvojat negative personale negative dhe tjetërsimi prindëror, kërkimi i kënaqësisë dhe përfitimet sociale të perceptuara (Hinduja & Patchin, 2009) janë shkaqet kryesore të sjelljes së bullizmit kibernetik.

Metodologjia

Me këtë artikull synojmë të kryejmë një rishikim sistematik të provave empirike që trajtojnë se si përvojat e bullizmit kibernetik ndikojnë në perceptimet e adoleshentëve për vetë-imazhin dhe mirëqenien, si dhe përpjekjet për të eksploruar ligjet dhe sfidat aktuale që ekzistojnë për krijimin e legjislacionit për bullizmin kibernetik. Metoda e këtij rishikimi sistematik është zhvilluar në përputhje me Kriteret e Preferuara të Raportimit për Rishikimet Sistematike dhe Meta-Analizat (PRISMA). Literatura e shqyrtuar përfshin studime nga disiplina të ndryshme si psikologjia, arsimi, ligji, teknologjia e informacionit dhe studimet gjinore. Këto studime përfshijnë dizajne kërkimore ndërseksionale, gjatësore, cilësore, sasiore dhe të përziera. Studimet me adoleshentë e të rinj nga e gjithë bota u rishikuan për të hedhur më shumë dritë në konceptimin e bullizmit kibernetik si një shqetësim global për shoqërinë.

Impakti i bullizmit kibernetik në vetëvlerësim dhe në imazhin e vetes

Gjatë adoleshencës, individët i nënshtrohen një faze vendimtare të vetë-zbulimit dhe formimit të identitetit. Vetëvlerësimi, i cili i referohet perceptimit të një individi për vlerën dhe aftësitë e tij, luan një rol kyç në formësimin e mirëqenies emocionale, ndërveprimeve sociale dhe

perspektivave të së ardhmes. Vetëvlerësimi i lartë lidhet me rezultate pozitive të shëndetit mendor, duke përfshirë uljen e ndjeshmërisë ndaj stresit, ankthit dhe depresionit (Orth et al., 2016). Anasjelltas, vetëvlerësimi i ulët mund të çojë në ndjenja të pamjaftueshmërisë, izolimit dhe në një cenueshmëri të shtuar ndaj presioneve të jashtme. Marrëdhënia midis bullizmit kibernetik dhe vetëvlerësimit është e shumanshme. Viktimat e bullizmit kibernetik shpesh përballen me një breshëri mesazhesh lënduese dhe degraduese, duke çuar në shqetësime emocionale dhe një ndikim negativ në imazhin e vetes së tyre. Anonimiteti i ofruar nga platformat online mund të intensifikojë dëmin, pasi ngacmuesit mund të ndihen të guximshëm për të synuar individë pa u përballur me pasoja të drejtpërdrejta. Ky sulm i ndërveprimeve negative mund të gërryjë vetëvlerësimin dhe imazhin e vetes së adoleshentëve, duke shembur besimin dhe sigurinë e tyre. Për më tepër, vlerësimi i imazhit të vetes tonë njihet gjithashtu si vetëvlerësim (Marsh & Shavelson, 1985) ose qëndrim i vetëvlerësimit (Baumeister & Tice, 1990). Studime të ndryshme arrijnë në përfundimin se vetëvlerësimi luan një rol jetik në vetë-rregullimin dhe kuptimin e vlerës së jetës sonë (Mackinnon, 2015).

Impakti i bullizmit kibernetik në mirëqenien psikologjike

Studiuesit Patchin & Hinduja (2006), si dhe Wolak, Janis, David & Kimberly (2005) pohojnë se efektet e bullizmit kibernetik variojnë në varësi të individit, por pasojat e tij përfshijnë vetëbesim të ulët, ankth, ndjesi trishtimi, frikë, siklet, depresion, zemërim, mungesë mësimi, ulje të arritjeve akademike, një tendencë në rritje për të dhunuar të tjerët, dhunë në shkollë dhe madje, vetëvrasje. Ndër të gjitha përvojat e tjera, vetëvlerësimi i ulët, ankthi dhe depresioni janë rezultati i dëmshëm i bullizmit në internet. Vetëvlerësimi është

i rëndësishëm gjatë fazës së adoleshencës pasi vendos orientimin pozitiv ose negativ ndaj vetes. Ngacmimi kibernetik ndikon në mënyrë të kundërt në vetëvlerësimin e studentëve (Patchin & Hinduja, 2006). Për më tepër, individët e ngacmuar gjithashtu vuajnë nga ankthi i shtuar. Është një ndjenjë frike, shqetësimi dhe shqetësimi, zakonisht e përgjithësuar dhe e papërqendruar si një reagim i tepruar ndaj një situatë që shihet vetëm subjektivisht si kërcënuese. National Institutes of Health (2010), pohoi se se një faktor tjetër i mundshëm rreziku është lidhja e fortë midis bullizmit dhe depresionit, i karakterizuar nga trishtimi, humbja e interesit ose kënaqësisë, ndjenja e fajit ose vetëvlerësimi i ulët, gjumë i shqetësuar ose humbje oreksi, ndjenja e lodhjes dhe përqendrimi i dobët. Viktimat dhe autorët përjetuan probleme emocionale dhe psikosomatike, sfida sociale dhe simptoma të shtuara depressive, përdorim të substancave dhe sjellje vetëvrasëse. Studimi nënvizoi nevojën që profesionistët e shëndetit të njohin dhe adresojnë efektet e dëmshme të bullizmit kibernetik në mirëqenien e adoleshentëve (Bottino, 2015). Gjetjet e Ang & Goh (2010) treguan një ndërveprim domethënës në tre drejtime midis ndjeshmërisë afektive, ndjeshmërisë njohëse dhe gjinisë në lidhje me bullizmin kibernetik midis adoleshentëve. U vu re se në nivele të ulëta të ndjeshmërisë afektive, si djemtë ashtu edhe vajzat me ndjeshmëri të ulët njohëse shfaqën rezultate më të larta të bullizmit kibernetik. Për djemtë me ndjeshmëri të lartë afektive, ky trend vazhdoi. Studimi i Li (2006) hodhi dritë mbi përhapjen dhe karakteristikat e bullizmit kibernetik midis adoleshentëve. Gjetjet treguan se gati gjysma e studentëve të anketuar ishin viktima të bullizmit, me rreth një e katërta e tyre përjetuan bullizëm kibernetik. Për më tepër, shumica e studentëve raportuan se njihnin dikë që ishte sulmuar në internet. Studimi gjithashtu theksoi raportimin e incidenteve të bullizmit kibernetik nga

viktimat dhe kalimtarët tek të rriturit. Janë vërejtur dallime të rëndësishme gjinore, me meshkujt më të prirur për t'u përfshirë në bullizëm dhe bullizëm kibernetik, ndërsa femrat viktime të bullizmit kibernetik ishin më të prirura për t'u raportuar incidente të rriturve. Këto gjetje nënvizojnë nevojën për ndërhyrje gjithëpërfshirëse që synojnë bullizmin kibernetik, me vëmendje ndaj modeleve specifike gjinore dhe rëndësisë së inkurajimit të sjelljeve të raportimit tek adoleshentët

Impakti negativ i kiberbullizmit në arritjet akademike

Megjithëse është treguar se ngacmimi kibernetik kryhet kryesisht jashtë orarit të shkollës dhe jashtë mjediseve të shkollës (Cross et al., 2009) ai është një problem shqetësues për shkollat. Shqetësimet për përfshirjen e bullizmit kibernetik tek adoleshentët u shkaktuan nga rezultatet negative në fushën psikosociale dhe atë akademike. Hulumtimi i mundshëm për këto marrëdhënie është se ngacmimi kibernetik prish përvojat emocionale të të rinjve duke i bërë ata më të prekshëm ndaj rezultateve negative, për shkak të strategjive joefektive të përballimit. Viktimat kibernetike kanë më shumë gjasa se jo-viktimat të raportojnë nivele më të ulëta të lumturisë globale, lumturisë së përgjithshme shkollë, kënaqësisë në shkollë, kënaqësisë familjare dhe vetëkënaqësisë (Toledano et al., 2015). Përfshirja e bullizmit kibernetik ndikon gjithashtu në performancën akademike të të rinjve. Si viktimat kibernetike ashtu edhe ngacmuesit kibernetikë janë në një rrezik në rritje për vështirësi në shkollë, duke përfshirë problemet akademike, më pak motivim për shkollë, performancë të dobët akademike, arritje më të ulëta akademike dhe më shumë mungesa në shkollë (Mohamed & Bellamy, 2015). Funkcionimi i shkollave lidhet gjithashtu me kryerjen e bullizmit në internet dhe viktimizimin kibernetik

(Wright, 2015). Ngacmuesit kibernetikë dhe viktimat kibernetike përjetojnë nivele më të ulëta të funksionimit të shkollës në krahasim me dhunuesit kibernetikë, viktimat kibernetike dhe të rinjtë e pa përfshirë. Problemet e brendshme dhe të jashtme janë të lidhura me përfshirjen e bullizmit kibernetik të të rinjve (Mitchell et al., 2007; Patchin & Hinduja, 2006; Wright, 2014a; Ybarra et al., 2007).

Sfidat për menaxhimin e luftës kibernetike në Shqipëri

Siguria kibernetike është një sfidë jo vetëm në kontekstin global por edhe në atë shqiptar Pavarësisht hartimit të ligjeve e akteve nënligjore, rregulloreve dhe standardeve, nga analiza e kryer, si dhe nga vlerësimi i nivelit të maturimit të sigurisë kibernetike në vend, është evidentuar nevoja për rishikim të të gjithë kuadrit ligjor e rregullator. Siguria kibernetike është primare për ofrimin e shërbimeve dixhitale si pasojë e karakterit ndërlihdhës të sektorëve të ndryshme, një kërcënim në një sektor mund të afektojë të gjithë sistemin.

Ligjet kryesore që lidhen me sigurinë dhe krimin kibernetik janë:

- Ligj nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (KSH, 1995);
- Ligj nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike” (KSH, 2017).
- Ligj nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (KSH, 2008a);
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (KSH, 2008b);
- Ligji nr. 10, datë 2.02.2023 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar (KSH, 2023);
- Ligji nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar (KSH, 2008c);

- Ligji nr. 107, datë 15.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar (KSH, 2015).

Në Shqipëri, Kodi Penal nuk ka një nen specifik që të parashikojë drejtpërdrejt “kiberbullizmin” si një veprë penale më vete. Megjithatë, veprimet që përfshijnë ngacmimin, intimidimin, ose abuzimin online mund të ndëshkohen nën dispozita të ndryshme të Kodit Penal, që mbulojnë sjellje të ngjashme.

Shqipëria në vitin 2022 ka përgatitur një Projektligj të ri për sigurinë kibernetike duke e përafruar atë me direktivat e Bashkimit Europian duke krijuar mekanizmin e plotë dhe të qartë të kodifikuar, për të adresuar saktë problematikat dhe për t'i zgjidhur ato.

Kërcënimet kibernetike duke përfutur nga dobësitë teknologjike ose mungesa e njohurive në përdorimin e mirë të këtyre mjeteve, janë gjithnjë e më shumë në rritje, duke cënuar sigurinë e sistemeve të informacionit. Në “Strategjinë e Sigurisë Kombëtare” (KSH, 2024) dhe në “Dokumentin e Politikave për Sigurinë Kibernetike (KM, 2020). Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, për të përmirësuar situatën dhe kuadrin ligjor të sigurisë kibernetike. Hartimi i Strategjisë Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020–2025” një domosdoshmëri, për ngritjen e mekanizmave të duhur institucionalë, mbështetet në parimet themelore si: zbatim i vlerave të njëjta themelore në botën fizike dhe digjitale; mbrojtja e të drejtave themelore; liria e shprehjes, të dhënat personale dhe privatësia; qasja për të gjithë; qeverisje demokratike dhe efikase; përgjegjësi e përbashkët në garantimin e sigurisë kibernetike.

Rritja e kapaciteteve për t'u përballur me sfidat kibernetike është thelbësore dhe si pasojë duhet të ndryshohen strukturat, qasja, kapacitetet teknike dhe logjistike etj. Sa i përket legjislacionit në Shqipëri, edhe pse relativisht i ri, ai përfshin një gamë të

gjërë të akteve më kryesore si Kushtetutën, Konventa dhe Marrëveshje Ndërkombëtare por edhe ato ligje që njihen si ‘soft laws’, të cilat lidhen më shumë me rregulla dhe kode etike.

Përfundime dhe rekomandime

Ngacmimi kibernetik është një shqetësim që kërkon vëmendje nga të gjithë anëtarët e komuniteteve tona duke përfshirë: prindërit, mësuesit, studiuesit dhe ligjvënësit. Kërkimet të cilat janë zhvilluar në këtë fushë kanë nxjerrë në pah shumë problematika dhe sfida të vazhdueshme. Procesi i dixhitalizimit është sfidues jo vetëm në hartimin e ligjeve, por më së shumti në zbatimin e kuadrin ligjor. Vështirësia me ligjin në fushën e sigurisë kibernetike qëndron dhe te fakti që është një legjislacion i ri dhe dinamik, pasi edhe fusha është e tillë, që ndryshon me shpejtësi.

Krijimi i një platforme edukative online, për sigurinë kibernetike, për të rritur ndërgjegjësimin në grup-mosha të ndryshme të shoqërisë për përdorimin e internetit të sigurt dhe të infrastrukturës digjitale, si dhe krijimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve dhe adoleshentëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht brezin e ri të aftë për të përfutur nga përparësitë e teknologjisë së informacionit dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit.

Ngacmimi kibernetik është më i përhapur nga sa e pranojnë zakonisht prindërit dhe mësuesit. Shkollat dhe prindërit duhet të bashkëpunojnë për të ndihmuar në adresimin e ngacmimit kibernetik. Adoleshentët shpesh përpiqen të trajtojnë situatën vetë ose të shpërfillin dhunuesin. Ndërsa kjo qasje mund të jetë efektive në disa raste, ndikimi i bullizmit kibernetik në shëndetin mendor mund të jetë i rëndë. Për të zbutur këtë çështje, është thelbësore të edukohen adoleshentët për natyrën e qëndrueshme dhe publike

të përmbajtjes në internet. Ata duhet të kuptojnë se sapo të postohet diçka, ajo kurrë nuk mund të fshihet plotësisht nga interneti.

Prindërit duhet gjithashtu të rrisin ndërgjegjësimin dhe njohuritë e tyre për

teknologjitë elektronike. Krijta e njohurive për teknologjitë elektronike mund t'i ndihmojë prindërit të kuptojnë rëndësinë e teknologjisë në jetën e fëmijëve të tyre dhe të njohin rrezikun dhe mundësitë e përdorimit të teknologjisë elektronike nga fëmijët e tyre.

REFERENCAT

- Ang, R. P. & Goh, D. H. (2010). Cyberbullying among adolescents: the role of affective and cognitive empathy, and gender. *Child Psychiatry & Human Development*, 41(4), 387–397. <https://doi.org/10.1007/s10578-010-0176-3>
- Baumeister, R. F., & Tice, D. M. (1990). Anxiety and social exclusion. *Journal of Social and Clinical Psychology*, 9(2), 165–195. <https://doi.org/10.1521/jscp.1990.9.2.165>.
- Bottino, S. M. B., Bottino, C. M. C., Regina, C. G., Correia, A. V. L., & Ribeiro, W. S. (2015). Cyberbullying and adolescent mental health: systematic review. *Cadernos De Saude Publica*, 31(3), 463–475. <https://doi.org/10.1590/0102-311x00036114>
- Burgess, P. A.; Patchin, J. W. and Hinduja, S. (2009). “Cyberbullying and online harassment: Reconceptualising the victimization of adolescent girls”, Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall.
- Cross, Donna & Shaw, T & Hearn, Lydia & Epstein, M & Monks, H & Lester, Leanne & Thomas, L. (2009). Australian covert bullying prevalence study (ACBPS), https://www.academia.edu/97826458/Australian_covert_bullying_prevalence_study
- Hinduja, S. and Patchin, J. W. (2009). *Bullying beyond the schoolyard: Preventing and responding to cyberbullying*. Thousand Oaks, CA: Sage Publications. Corwin Press (parë, më 21.11.2024).
- Këshilli i Ministrave, KM. (2020). VKM Nr. 1084, datë 24.12.2020 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimit 2020-2025”, <https://www.mod.gov.al/images/strategji-MoD/2024/strategjia-Mbrojtje-Kibernetike-2024-2028-290324.pdf> (parë, më 21.11.2024)
- Kiriakidis, S.P. and Kavoura, A. (2010). “Cyberbullying: a review of the literature on harassment through the Internet and other electronic means”, *Fam Community Health*; 33:82–93
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (1995). Ligj nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; <https://www.krimizgjedhor.com/wp-content/uploads/2021/09/Ligji-Nr.-7895-date-27.1.1995.pdf> (parë, më 21.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2005). Ligj nr. 107, datë 15.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar; <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/ligj-2015-10-01-107.pdf> (parë, më 20.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2008a). Ligj nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Ligj_9918_19-05-2008-perditesuar-me-Ligjin-102_24-10-2012-me-Ligjin-107-dt.-20.12.2018.pdf (parë, më 20.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2008b). Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; <https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Ligj-2008-03-10-9887-perditesuar-nga-QBZ-1.pdf> (parë, më 21.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2008c). Ligji nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar; <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/ligj-2008-02-25-9880.pdf> (parë, më 21.11.2024)

- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2017). Ligj nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”; https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/Ligji_Per_Sigurine_Kibernetike_Nr_2_Date_26.1.2017-1.pdf (parë, më 21.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2023). Ligji nr. 10, datë 2.02.2023 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar; <https://president.al/wp-content/uploads/2023/09/Ligj-Per-infomacionin-e-klasifikuar.pdf> (parë, më 21.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. 2024. Ligj 14/2024 “Strategjia e sigurisë kombëtare”, <https://qzb.gov.al/eli/ligj/2024/02/08/14/6f7acb09-5b35-4f1b-83a8-bab03464a153;q=strategj> (parë, më 21.11.2024)
- Landstedt, E & Gillander, K. (2011). “Experiences of violence among adolescents: gender patterns in types, perpetrators and associated psychological distress”, *Int J Public Health*; 56:419–27.
- Li, Q. (2006). “Cyberbullying in schools. School Psychology International”, 27(2), 157–170. <https://doi.org/10.1177/0143034306064547>
- MacKinnon J. Neil. (2015). “Self-Esteem and Beyond”, Doi: 10.1057/9781137542304. ISBN: 978-1-349-50704-7
- Marsh, H. W., & Shavelson, R. (1985). “Self-concept: Its multifaceted, hierarchical structure”, *Educational Psychologist*, 20(3), 107–123. https://doi.org/10.1207/s15326985ep2003_1
- Mitchell, K. J., Ybarra, M., & Finkelhor, D. (2007). “The relative importance of online victimization in understanding depression, delinquency, and substance use”, *Child Maltreatment*, 12, 314–324
- Mohammed Yousef, W. S., & Bellamy, A. (2015). “The impact of cyberbullying on the self-esteem and academic functioning of Arab American middle and high school students”, *Electronic Journal of Research in Educational Psychology*, 13(3), 463–482. <https://doi.org/10.14204/ejrep.37.15011>
- National Institutes of Health (2010). “Depression high among youth victims of school cyber bullying”, *NIH researchers report*, Available at <https://www.nih.gov/news-events/newsreleases/depression-high-among-youth-victims-school-cyber-bullying-nih-researchers-report>.
- Olweus D. (1994). “Bullying at school: basic facts and effects of a school-based intervention program”, *J Child Psychol Psychiatry*; 35:1171–90.
- Orth, U., Robins, R. W., Meier, L. L., & Conger, R. D. (2016). “Refining the vulnerability model of low self-esteem and depression: Disentangling the effects of genuine self-esteem and narcissism”, *Journal of Personality and Social Psychology*, 110, 133-149. <http://dx.doi.org/10.1037/pspp0000038>
- Patchin, J. and Hinduja, S. (2006). “Bullies move beyond the schoolyard: A preliminary look at cyberbullying”, *Youth Violence and Juvenile Justice*, 4:148-169.
- Smith, P. K., Mahdavi, J., Carvalho, M., Fisher, S., Russell, S., & Tippett, N. (2008). “Cyberbullying: its nature and impact in secondary school pupils”, *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 49(4), 376–385. <https://doi.org/10.1111/j.1469-7610.2007.01846.x>
- Toledano, S., Werch, B. L., & Wiens, B. A. (2015). Domain-specific self-concept in relation to traditional and cyber peer aggression. *Journal of School Violence*, 14(4), 405–423.
- Wells, M., and Mitchell, K. J. (2008). “How do high-risk youth use the internet? Characteristics and implications for prevention”, *Child Maltreatment*, 13 (3): 227-234
- Willard, N. (2005). “Cyberbullying and cyberthreats” In: Office of Safe and Drug-Free Schools National Conference. Washington, D.C., United States of America. Pp.21-31
- Wolak, Janis., David, F. & Kimberly, M. (2005). “The Varieties of Child Porn Production.” In Viewing child pornography on the Internet: Understanding the offense, managing the offender, helping the victims, edited by E. Quayle & M. Taylor, 31–48. Dorset, UK: Russell House Publishing.
- Wright, M. F. (2014a). “Predictors of anonymous cyber aggression: The role of adolescents’

- beliefs about anonymity, aggression, and the permanence of digital content”, *Cyberpsychology, Behavior, and Social Networking*, 17, 431–438.
- Wright, M. F. (2015). “Cyber victimization and perceived stress: Linkages to late adolescents’ cyber aggression and psychological functioning”, *Youth & Society*, 47(6), 789–810.
- Ybarra ML, Mitchell KJ and Korchmaros J. D. (2011). “National trends in exposure to and experiences of violence on the Internet among children”, *Pediatrics*; 128: e1376–86.
- Ybarra, M. L., Diener-West, M., & Leaf, P. (2007). “Examining the overlap in internet harassment and school bullying: Implications for school intervention”, *Journal of Adolescent Health*, 1, 42–50.

ABSTRACT

Adolescent, Cyberbullying and the law: A review of psychological and legal challenges

Cyberbullying is one of the biggest challenges for digital society, with impacts on adolescent mental health. The increase in the number of social networks, instant messaging applications and online gaming platforms has made teenagers more exposed than ever to potential bullying, intimidation and exclusion. The effects of cyberbullying vary depending on the individual, but its consequences include low self-esteem, anxiety, feelings of sadness, being fearful, depression, anger, decreased academic achievement, an increased tendency to bully others, violence at school and even suicide. Although parents, schools and online social networking sites are encouraged to provide a safe online environment, little is known about the legal avenues that can be used to prevent or act as a deterrent to cyberbullying. This article aimed to conduct a systematic review of empirical evidence addressing how cyberbullying experiences affect adolescents’ perceptions of self-image and well-being, as well as attempts to explore the current laws and challenges that exist for establishing cyberbullying legislation. The method of this systematic review was developed in accordance with the Preferred Reporting Criteria for Systematic Reviews and Meta-Analyses (PRISMA). According to many studies, bullying and cyberbullying can have devastating consequences on a child’s mental and physical health; hence the punishment should equal the impact. Technology has offered some solutions to reporting and reducing cyberbullying, although it might not be judged as fully efficient at the moment, issues of jurisdiction and other factors psycho-social, prove to be challenging. Schools and parents should be the first to tackle. Adolescents should be educated about the sustainable and public nature of online content. They need to understand that once something is posted, it can never be completely erased from the internet.

Keywords: *Self-image, well-being, adolescent, cyberbullying, law*

NJË VËSHTRIM KRITIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË FUSHËN E VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Xhulia MUSTA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale
E-mail: Xhulia.Musta@unitir.edu.al

Rudina RAMA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave Sociale
Departamenti i Punës dhe Politikave Sociale
E-mail: Rudina.Rama@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Legjislacioni shqiptar në fushën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar është ndryshuar dhe pasuruar përgjatë tri dekadave për t'ju përgjigjur më mirë nevojave të personave me aftësi të kufizuar. Përfitimet në të ardhura mbeten një nga llojet më të vjetra dhe më të rregulluara të përfitimeve në legjislacion krahasuar me fusha të tjera si edukimi, aksesueshmëria, strehimi, përfshirja sociale etj. Këto përfitime në të ardhura janë mbuluar nga skema kontributive e jo kontributive. Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë në mënyrë kritike legjislacionin shqiptar në fushën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke identifikuar boshllëqet në skemat aktuale të vlerësimit të përfitimeve. Një rishikim i hollësishëm i legjislacionit shqiptar lidhur me skemën kontributive, jo kontributive dhe Statuset e Para-Tetraplegjisë e Verbërisë zbuloi se aktualisht në vendin tonë nuk përdoret një model i vetëm për vlerësimin e aftësisë së kufizuar. Skema kontributive e përfitimeve, si edhe Statuset e Para-Tetraplegjisë dhe Verbërisë mbështeten në modelin mjekësor, ndërkohë që skema jo-kontributive funksionon nga viti 2019 bazuar mbi një model bio-psiko-social të vlerësimit. Modeli Bio-Psiko-Social për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, edhe pse reflekton konceptin modern të aftësisë së kufizuar sipas KDPAK, nuk është

modeli mbizotërues në Shqipëri. Kritika në këtë drejtim nuk është vetëm çështje modeli, pasi përdorimi i standardeve të shumëfishta për vlerësimin e aftësisë së kufizuar rezulton në trajtim të diferencuar e nganjëherë të privilegjuar sikundër është mundësia e personave të verbër e para-tetraplegjikë për të përfituar nga skema kontributive e jo-kontributive në të njëjtën kohë. Rishikimi i disa aspekteve të legjislacionit, me fokus të veçantë në unifikimin e standardit të trajtimit, është i nevojshëm për sigurimin e një mbështetjeje më të drejtë në të ardhura për personat me aftësi të kufizuar.

Fjalët kyçe: *legjislacion PAK, analizë kritike, skema kontributive, skema jo-kontributive, mbështetje në të ardhura*

Xhulia MUSTA është kandidatë për gradën shkencore “Doktor” në shkencë sociale, nënfisha Punë Sociale pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, me një studim lidhur me reformën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri. Përveç angazhimit në mësimdhënie në arsimin publik e jo publik, autorja ka disa eksperiencë në fushën e mbrojtjes sociale, si pjesë e ekipit të MMSR dhe Shërbimit Social Shtetëror.

Rudina RAMA ka një përvojë të gjatë si pedagoge dhe kërkuese shkencore pranë Universitetit të Tiranës. Fushat e ekspertizës kërkimore përfshijnë dimensionin social në kujdesin shëndetësor, administrimin e politikave dhe shërbimeve sociale; mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve dhe aplikimin e metodave kërkimore në fushën e drejtësisë penale.

Aftësia e kufizuar nuk është një çështje e panjohur për shoqërinë njerëzore, por ajo që mund të thuhet me siguri është se të drejtat e personave me aftësi të kufizuar përgjatë dekadave të fundit janë sjellë gjithnjë e më në vëmendje të shoqërisë dhe politikë-bërjes. Në kontekstin shqiptar legjislacioni për garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar ka evoluar në mënyrë të ndjeshme, si një pjesë integrale e përpjekjeve të qeverisë për përafrimin e tij me standardet ndërkombëtare. Integrimi në familjen e madhe europiane kërkon harmonizimin e legjislacionit dhe politikave me ato të Bashkimit Europian në disa fusha, mes së cilave edhe fusha e politikave sociale dhe punësimit (MSA, 2006).

Përpjekjet për përafrimin e legjislacionit dhe politikave me standardet ndërkombëtare në fushën e aftësisë së kufizuar janë reflektuar fillimisht në ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) në 11 Shkurt 2012. Me ratifikimin e KDPAK, Shqipëria si shtet palë duhet të ndërmerre ndryshime ligjore dhe rregullatore për të garantuar barazi,

liri, jetesë të pavarur, mosdiskriminim, mbështetje dhe përfshirje sociale, ekonomike, politike e kulturore (UN, 2006). Çdo ndryshim ligjor do duhet të reflektonte konceptin e aftësisë së kufizuar si një ndërveprim kompleks mes faktorëve biologjikë, psikologjikë, socialë e mjedisorë, duke sjellë si rrjedhojë ndryshimin e mënyrës së vlerësimit dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuar. Konceptimi i aftësisë së kufizuar sipas KDPAK nxiti ndryshime në legjislacion dhe zhvillimin e politikave të reja që funksionojnë si një themel i qëndrueshëm për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri. Mbrojtja e dinjitetit, barazia, liria dhe integrimi i personave me aftësi të kufizuar në çdo aspekt të jetës janë parime që kanë drejtuar zhvillimin e politikave që shkojnë përtej përfitimeve në para, por që synojnë aksesueshmërinë, arsimimin, aftësimin profesional dhe punësimin.

Shqipëria ka trashëguar nga periudha e komunizmit një model tërësisht mjekësor të vlerësimit dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuar, në të cilën aftësia e kufizuar perceptohej vetëm si një patologji mjekësore.

Kuadri ligjor për aftësinë e kufizuar në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm, duke orientuar përpjekjet mbi përfshirjen sociale, megjithatë gjurmë të modelit të vjetëruar mjekësor për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar janë ende të pranishme.

Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë në mënyrë kritike legjislacionin shqiptar në fushën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke identifikuar boshllëqet në skemat aktuale të vlerësimit të përfitimeve, përmes një rishikimi të hollësishëm të legjislacionit aktual për skemën kontributive dhe jo-kontributive. Ky artikull do të nxjerrë në pah drejtime të mundshme në të cilat mund të zhvillohen ndërhyrje efektive për të siguruar një trajtim të drejtë për çdo person që ka një aftësi të kufizuar.

Aftësia e kufizuar në Shqipëri dhe e drejta për mbrojtje shoqërore

Një shoqëri plotësisht funksionale është një shoqëri e cila njeh, planifikon dhe garanton nevojat bazë të qytetarëve të saj (Vaso-Xhumari, 2009). E drejta për mbrojtje shoqërore është një e drejtë themelore që qytetarëve u garantohej në kushtetutë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 49, pika 2, përcakton se “të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës”, si edhe në nenin 51, pika 1 “kushdo ka të drejtën e sigurisë shoqërore në rast pleqërie apo paaftësie”. Në mënyrë të veçantë e drejta e mbrojtjes shoqërore sanksionohet në Kreun V mbi “Objektivat Sociale”, në të cilin shteti merr përsipër që me mekanizmat që zotëron të garantojë përkujdesje sociale për invalidët, riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar, integrimin në shoqëri dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të tyre të jetesës (KSH, 1998). Në mbështetje të kushtetutës, si ligj themeltar i shtetit, e drejta e mbrojtjes shoqërore rregullohet me një kuadër të plotë aktesh ligjore e nënligjore, të tilla, si:

Ligji “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (KSH, 1993);

- Ligji “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar (KSH, 1994);
- Ligji “Për Statusin e te Verbrit” (KSH, 1996);
- Ligji “Për Statusin e Invalidit Paratetraplegjik”, i ndryshuar (KSH, 2000);
- Ligji “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” (KSH, 2019);
- VKM “Për përfitimet nga Statusi i të Verbrit”, i ndryshuar (KM, 1997);
- VKM “Për përfitimet nga Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar (KM, 2001);
- VKM “Për zbatimin e Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e Invalidit”, i ndryshuar (KM, 2008);
- VKM “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, i ndryshuar (KM, 2020);
- VKM “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, i ndryshuar (KM, 2016);
- VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, i ndryshuar (KM, 2019).

Legjislacioni që rregullon fushën e aftësisë së kufizuar në Shqipëri shtrihet në shumë drejtime, duke përfshirë arsimimin, strehimin social, kulturën, aftësimin profesional dhe punësimin e kështu me

radhë, megjithatë pikënisja për secilin prej këtyre drejtime është vetë procesi i vlerësimit si një person me aftësi të kufizuar. Aktet e mësipërme ligjore dhe nënligjore qartësojnë se sistemi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri është i mbështetur në dy shtylla, konkretisht skema kontributive dhe jo-kontributive. Për qëllime të këtij artikulli, analiza do të zhvillohet në disa drejtime të tilla, si: kriteret e përfitimit – mundësitë dhe kufizimet, masat e përfitimeve, shumëllojshmëria e përfitimeve, përfitimet për ndihmësin personal, strukturat e komisioneve të vlerësimit etj.

E drejta e përfitimit në skemën kontributive. Invalidët e punës

Skema kontributive e mbrojtjes shoqërore i ka fillesat në Shek. XIX në shtetin e Bismarkut, ku mbrojtja shoqërore u konsiderua për herë të parë si e drejtë sociale e të gjithë qytetarëve që derdhnin kontribute (Palier, 2010). Ky sistem pati ndikim në të gjitha vendet e Europës, por ndikimi nuk ishte i njëjtë në vendet me udhëheqje komuniste. Shqipëria nën pushtetin komunist zhvilloi një model të veçantë të sistemit të mbrojtjes sociale, karakteristik për të gjitha vendet e bllokut sovjetik, i cili mbështetej mbi sistemin e Bismarkut, mirëpo hiqte dorë nga parimi i sigurimit. Punonjësit mund të përfitonin nga sistemi i mbrojtjes sociale jo sepse derdhnin kontribute, por vetëm për faktin që ata ishin të punësuar (Vaso-Xhumari, 2009). Shteti merrte përsipër punësim për të gjithë dhe për rrjedhojë përfitimi nga sistemi i mbrojtjes sociale konsiderohej një e drejtë e padiskutueshme.

Pas rënies së sistemit komunist, e drejta për mbrojtje shoqërore në Shqipëri mori formë të re. E drejta e përfitimit nga skema kontributive rregullohet me ligjin “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (KSH, 1993) dhe në mënyrë

të veçantë me ligjin “Për Statusin e Invalidit të Punës”, i ndryshuar (KSH, 1994). Kjo skemë administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ligji “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë (neni 19) përcakton se qytetarët mbulohen me përfitime në para për disa kushte të caktuara të tilla, si: pleqëria, invaliditeti, barrëlindja, sigurimi i papunësisë, aksidenti në punë, pensionet familjare dhe sociale etj., duke përcaktuar shumë qartë kushtet dhe mënyrën e llogaritjes së masës së përfitimit për secilin prej pensione.

E drejta e përfitimit në skemën kontributive është pashmangshmërisht e lidhur me sëmundjen që vendos qytetarin në kushte invaliditeti, si edhe periudhën e sigurimit. Kjo qasje vlerësuese, si dhe përbërja e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) nga mjekë të specialiteteve të ndryshme sipas rregullores “Për Organizimin, të Drejtat, Detyrat dhe Funkcionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve” (ISSH & MSH, 2005) dëshmojnë përdorimin e një modelit tërësisht mjekësor në vlerësimin e invaliditetit në skemën kontributive.

Kriteret e përfitimit: referuar Ligjit për Sigurimet Shoqërore (KSH, 1993),

pensioni i invaliditetit përcaktohet si një përfitim në të ardhura në rastet kur një person bëhet i paaftë për të kryer veprimtari ekonomike dhe ka gjymtime/dëmtime fizike (duke përfshirë verbërinë).

Pensioni i invaliditetit që paguhet nga Dega e Përfitimeve mund të jetë pension invaliditeti i plotë, pension invaliditeti i pjesshëm, pension invaliditeti i reduktuar (po aty, neni 30, pika c, ç, ç/1). Ndërsa në nenin 35 (pika 2) përcaktohet se përfitimi i pensionit të plotë ose të pjesshëm të invaliditetit kërkon që periudha minimale e sigurimit të jetë sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën

që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj kontribute të sigurimeve shoqërore. Invaliditeti i pjesshëm përfitohet kur personi i siguruar ka plotësuar periudhën minimale të sigurimit e ku për çdo arsye, përveç aksidentit në punë dhe sëmundjes profesionale, bëhet i paaftë të kryejë punën e fundit, por mund të punojë në kushte të veçanta pune (neni 37, pika 1). Nëse personi i siguruar është në kushtet e invaliditetit të plotë për shkak të sëmundjes por nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit sipas nenit 35, ka të drejtën e përfitimit të pensionit të reduktuar të invaliditetit (neni 37/1).

Ligji për sigurimet shoqërore është ndryshuar mbi 10 herë që prej vitit 1993, duke reflektuar ndryshimet dinamike të forcës punëtore në shoqëri. Nga një rishikim i detajuar i ndryshimeve të miratuara ndër vite, rezulton se vendosja e kriterit për pasjen e të paktën 12 muajve të kontributeve të sigurimeve shoqërore në 5 vitet e fundit daton në vitin 2014 (KSH, 2014). Ky kriter nuk ka zëvendësuar apo ndryshuar ndonjë kriter ekzistues, por është shtuar në listën e kriterëve të detyrueshme për të përfituar pension invaliditeti nga skema kontributive.

Në një vështrim kritik, kriteri për pasjen e të paktën 12 muajve kontribute të sigurimeve shoqërore në 5 vitet e fundit mund të vendosë në pozita diskriminuese disa qytetarë (të cilët nuk janë subjekt i nenit 37/1) që mund të kenë kontribuar përgjatë të gjithë jetës, por që nuk kanë të paktën 12 muaj kontribute të sigurimeve shoqërore në 5 vitet e fundit. Ndryshimet e nenit 35 të ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 1993, mbi kriteret e përfitimit, kanë lehtësuar barrën ekonomike në skemën kontributive. Të gjithë qytetarët që përjashtohen nga përfitimi në skemën kontributive për shkak të mos përmbushjes së kriterit të 12 muajve të kontributeve të sigurimeve shoqërore në 5 vitet e fundit drejtohen për të aplikuar për përfitim pranë skemës jo-kontributive,

duke rritur në mënyrë të konsiderueshme kostot e buxhetit të shtetit për programin e mbrojtjes sociale.

Nga ana tjetër, ekziston një lloj dakordësie me vendosjen e këtij kriteri në faktin se qëndrueshmëria e skemës kontributive garantohet nga mbledhja e vazhdueshme e kontributeve të sigurimeve shoqërore. Kjo skemë nuk mund të ketë aftësi pagueuse për të gjithë personat që invalidizohen në një moment të caktuar të jetës nëse mbledhja e kontributeve nuk ka baza të qëndrueshme. Megjithatë, këto ndryshime ligjore duhet të ishin mbështetur në një proces të gjatë konsultimi mes institucioneve që prekeshin prej tij (ISSH dhe SHSSH) në mënyrë që kjo të mos prodhonte efekte të konsiderueshme në asnjë prej skemave.

Masa e përfitimit: masa e pensionit të invaliditetit, sipas nenit 36/1 të ligjit për sigurimet shoqërore (KSH, 1993) përbëhet nga një shumë bazë dhe një shtesë, të cilat varen nga periudha e sigurimit në raport në periudhën e kërkuar për përfitim. Shtesa mujore mbi pensionin e invaliditetit sipas nenit 7/ 1 të ligjit për statusin e invalidit (KSH, 1994), jepet si përfitim paaftësie për të gjithë invalidët që kanë qenë të punësuar në ndërmarrje ose institucione shtetërore, ish-kooperativa bujqësore e që janë me sëmundje profesionale ose të aksidentuar në punë. Me vendimin për zbatimin e ligjit për statusin e invalidit janë miratuar shtesat mujore mbi masën e pensionit të invaliditetit në masat:

- 3300 lekë për invaliditet të plotë, të dëmtuar nga sëmundje të përgjithshme dhe 2200 lekë për invaliditet të pjesshëm, të dëmtuar nga sëmundje të përgjithshme;
- 4000 lekë për invaliditet të plotë nga aksidente në punë dhe sëmundje profesionale dhe 2700 lekë për invaliditet të pjesshëm nga aksidente në punë dhe sëmundje profesionale (KM, 2008).

Në një skemë ku e drejta e përfitimit është e lidhur drejtpërdrejtë me masën dhe kohëzgjatjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, duket se personat që gëzojnë statusin e invalidit të punës diskriminohen pozitivisht, duke përfituar nga buxheti i shtetit një shtesë mujore mbi invaliditetin.

E drejta e përfitimit në skemën jokontributive. Modeli Bio-Psiko-Social

Parimi se e drejta për mbrojtje shoqërore u përket të gjithëve është themeli i skemës jo-kontributive. Në Shqipëri, e drejta e përfitimit nga skema jokontributive rregullohet me ligjin për asistencën sociale (KSH, 2019) dhe administrohet nga Shërbimi Social Shtetëror. Lindja e të drejtës për përfitim është e pa lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore, mbështetet në faktin e të qënurit qytetar i vendit dhe zbatohet bazuar në disa kritere të miratuara me akte ligjore dhe nënligjore. Ky ligj (në nenin 8) përcakton se përfitues të aftësisë së kufizuar janë:

- Personat para dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha;
- Personat që deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-it, por nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit sipas ligjit për sigurimet shoqërore, i ndryshuar;
- Personat me aftësi të kufizuar që vlerësohen si të tillë nga Komisionet Shumë-Disiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në të gjithë Shqipërinë;
- Invalidët e punës (të cilët përfitojnë pagesën dhe shtesën mujore mbi invaliditetin e punës).

Në Shqipëri, nga viti 2019, ka nisur një proces i ri i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, Modeli Bio-Psiko-Social, ku vlerësimi realizohet nga një ekip shumë-disiplinor i përbërë nga mjekë dhe punonjës

socialë (MSHMS, 2019). Ky vlerësim u pilotua në vitin 2017, fillimisht në njësinë administrative nr. 6 dhe nr. 7 në Tiranë, bazuar në dispozitat e vendimit për “Përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot” (KM, 2016). Me shtrirjen e zbatimit të Modelit Bio-Psiko-Social në të gjithë Shqipërinë u miratua vendimi për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre (KM, 2019).

Kriteret e përfitimit: vendimi për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre” (KM, 2019) përcakton qartë (kreu II/1) kriteret që duhet të plotësojë një qytetar për të marrë përfitime të aftësisë së kufizuar. Konkretisht:

- të ketë dëmtime fizike, mendore, sensore të nivelit të lehtë, moderuar, rëndë ose thellë;
- të jetë i paaftë për punë;
- të mos plotësojë kushtet për të përfituar pension të invaliditetit të punës sipas ligjit për sigurimet shoqërore;
- të mos ketë lindur e drejta për përfitim të pensionit të pleqërisë/social sipas ligjit të sipër përmendur.

Kjo pikë përcakton në mënyrë të qartë se cilët persona mund të aplikojnë për përfitim sipas Modelit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social, por nuk ka një qëndrim të qartë lidhur me llojet e tjera të përfitimeve të parashikuara në legjislacionin për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Ligji për sigurimet shoqërore (KSH, 1993) parashikon disa lloje përfitimesh, një ndër të cilat është pensioni familjar. Sipas nenit 40:

pensionin familjar mund të përfitohet nga personat që janë në ngarkim të të siguruarit që vdes dhe që kishte kushtet për pension invaliditeti ose pension pleqërie, ose merrte pension.

Një qëndrim më i qartë lidhur me pensionin familjar në vendimin për zbatimin e Modelit Bio-Psiko-Social (KM, 2019) do të shmangte nevojën për interpretime nga ana e profesionistëve që u duhet të vlerësojnë përshtatshmërinë për aplikim dhe përfitim nga Modeli i Vlerësimit Bio-Psiko-Social, si edhe në rastin më të keq rënien në gabime që prodhojnë efekte për qytetarët.

Çdo model vlerësimi përfshin sikurse edhe përjashton persona nga aplikimi dhe përfitimi. Vendimi mbi të cilin bazohet Modeli Bio-Psiko-Social (KM, 2019) sanksionon (kreu VI/1 mbi “Dispozitat kalimtare”) se procedurës së vlerësimit sipas Modelit Bio-Psiko-Social nuk i nënshtrohen të verbërit dhe personat para-tetraplegjikë (përfitues ose aplikues) për përfitime nga ligji për statusin e të verbërit (KSH, 1996) dhe ligji për statusin e invalidit para-tetraplegjik (KSH, 2000). Kjo dispozitë sqaron se për kushte shëndetësore si “verbëria” dhe “para-tetraplegjia” një person nuk mund të aplikojë dhe përfitojë në Modelin Bio-Psiko-Social, por nuk evidenton nëse një person që gëzon Statusin e Para-Tetraplegjisë ose Verbërisë mund të aplikojë në Modelin Bio-Psiko-Social për tu vlerësuar për gjendje të tjera shëndetësore (sëmundje kronike, shëndet mendor etj.). Paqartësia në këto kritere ligjore qoftë për përfshirje, qoftë për përjashtim, mund të krijojë hapësira për gabime dhe abuzim.

Masa e përfitimit: për qëllime krahasimore risjellim në vëmendje edhe njëherë se masa e pensionit të invaliditetit në skemën kontributive mbështetet në një pagesë bazë dhe një shtesë mujore që mbulohet nga buxheti i shtetit. Në dallim nga kjo skemë, masa e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar në skemën

jokontributive (për fëmijët dhe të rriturit) përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe është 150 % e shumës së pensionit social sipas përcaktimeve të ligjit për sigurimet shoqërore (KSH, 1993). Bazuar në vendimin për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre, kreu IV, pika 4, masa e pagesës indeksohet sa herë indeksohet pensioni social (KM, 2019).

E drejta e përfitimit të statusit të para-tetraplegjisë dhe verbërisë. Dy Ligje të Veçanta

Kriteret e përfitimit: përveç përfitimeve që rrjedhin nga ligji për sigurimet shoqërore (KSH, 1993) dhe ligji për asistencën sociale (KSH, 2019), personat që janë në kushtet e para-tetraplegjisë dhe verbërisë mbështeten me përfitime nga ligji për statusin e të verbërit” (KSH, 1996) dhe ligji për statusin e invalidit para-tetraplegjik” (KSH, 2000). Vlerësimi për statusin e para-tetraplegjisë dhe verbërisë bëhen nga KMCAP-i i nivelit të parë i para-tetraplegjisë dhe Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë (KMPV) si edhe nga komisionet Eprorë. Të gjitha komisionet kanë në përbërje mjekë specialistë të fushave përkatëse dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ligji për statusin e invalidit para-tetraplegjik (KSH, 2000), në nenin 1, përcakton se “nga ky ligj përfitojnë të gjithë personat paraplegjikë ose tetraplegjikë pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit apo sigurimi”. Në zbatim të këtij ligji është miratuar vendimi për përfitimet nga statusi i invalidit para-tetraplegjik (KM, 2001) në pikën 4 të së cilit përcaktohet se “pagesa si invalid para-tetraplegjik përfitohet pavarësisht moshës dhe të ardhurave të tjera”. Ky përcaktim legjitimon të drejtën e personave paraplegjikë-tetraplegjikë

për të përfituar pagesën e statusit të para-tetraplegjisë pavarësisht të ardhurave të tjera të përfituara në kushte invaliditeti pune, pensioni pleqërie, familjar etj., sipas përcaktimeve të legjislacionit për sigurimet shoqërore. E thënë në fjalë më të thjeshta, kjo u siguron invalidëve të punës mundësinë e marrjes së pagesave nga skema kontributive dhe jokontributive në të njëjtën kohë.

Ligji për statusin e të verbrit (KSH, 1996), në Nenin 1, sanksionon se përfitues të këtij ligji janë “personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi”, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësorë janë të paaftë për punë në kushte normale”. Vendimi i miratuar për zbatimin e këtij ligji sanksionon se “përfitimet nga Statusi i të Verbrit merren pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat e tjera, që përfitojnë nga shteti” (KM, 1997).

Nga ana tjetër, ligji për sigurimet shoqërore (KSH, 1993) thekson se “pensioni i invaliditetit përfitohet nëse një person bëhet i paaftë për të kryer veprimtari ekonomike dhe ka gjymtime/dëmtime fizike (duke përfshirë verbërinë)”. Këto dy ligje së bashku, legjitimojnë të drejtën e personave që kanë humbje të pjesshme ose të plotë të shikimit të përfitojnë pagesë nga skema kontributive dhe jokontributive për të njëjtën gjendje shëndetësore (humbje shikimi) nëse ky është një kusht i fituar gjatë jetës ose në rast se personi ka qenë kontribuues.

Ballafaqimi i këtyre dy ligjeve na vendos përpara pyetjes: a jemi në kushtet e një diskriminimi pozitiv për personat me humbje shikimi? Kjo është një çështje tepër e debatueshme duke qenë se përfitimi nga skema kontributive është e drejtë e lindur për shkak të derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe nga ana tjetër përfitimi nga statusi i të verbrit rrjedh nga fakti se ligji për statusin e të verbrit është ligj i veçantë jashtë fushës së veprimit të ligjit për asistencën sociale në Shqipëri.

E drejta për ndihmës personal: një vështrim kritik nga skema kontributive, jokontributive dhe Statusi i Para-tetraplegjisë dhe Verbërisë

Ndihmësi personal është një nga shërbimet e konsoliduara, me mbulueshmëri 100 për qind në të gjithë vendin (MSHMS, 2019). Ky shërbim ofrohet në skemën kontributive dhe jokontributive, si edhe në Statuset e Para-Tetraplegjisë dhe Verbërisë. Konkretisht:

Ligji për sigurimet shoqërore (KSH, 1993) në nenin 38 sanksionon ofrimin e të ardhurave shtesë për përkujdesje, duke theksuar se nëse “përfituesi i pensionit të invaliditetit bëhet fizikisht ose psikikisht i paaftë dhe ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme të një personi tjetër, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 për qind të bazës së vlerësuar neto. Pra, koncepti i ndihmësit personal në skemën kontributive është në formën e një shtese mbi pagesën e invaliditetit.

Në Modelin Bio-Psiko-Social, i cili përfaqëson skemën jokontributive, nevoja për ndihmës personal përcaktohet nga komisionet shumë-disiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për personat që kanë kufizime të rënda ose të thella (KM, 2019). Ndihmësi personal ofrohet në formën e një pagese që indekskohet nga Shërbimi Social Shtetëror në bazë të indeksimit të pensionit social. Ndihmësi personal është një shërbim i parashikuar po ashtu edhe në ligjin për statusin e të verbrit dhe ligjin për statusin e invalidit para-tetraplegjik (KSH, 1996; KSH, 2000) dhe në aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve. Sipas VKM për përfitimet nga statusi i të verbrit (KM, 1997) personat që janë përfitues të grupit të parë kanë nevojë për ndihmës personal dhe ndihmësi personal përfiton të njëjtën masë pagesë si personi i verbër (pika 1a dhe 4). Masa e pagesës indekskohet çdo vit.

Me VKM janë rregulluar përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik

(KM, 2001). Në pikën 4 sanksionohet se “ndihmësit personalë të personave që gëzojnë statusin e paraplegjikut ose tetraplegjikut marrin të njëjtën masë pagese si personi para-tetraplegjik”. Deri në këtë pikë të analizës, ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuar në të gjitha skemat marrin një trajtim të barabartë. Mirëpo, ndihmësit personalë të personave që gëzojnë statusin e para-tetraplegjisë në ndryshim nga ndihmësit personalë të personave me aftësi të kufizuar (fizik apo mendor), invalidëve të punës apo të verbërve, u njihet periudha e shërbimit si periudhë kontributive për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, barrëlindjes, aksident në punë, sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor. Kontributet përllogariten mbi pagën minimale dhe mbulohen nga buxheti i shtetit (KM, 2001; pikën 4/1).

Trajtimi i diferencuar i ndihmësit personal për personat që gëzojnë Statusin e Para-Tetraplegjisë është diskriminim pozitiv nga ligji. Investimi si ndihmës personal, koha, energjia dhe përkujdesi është i njëjtë për cilindo ndihmës personal, pavarësisht nëse po kujdeset për një të verbër, për një fëmijë me probleme të zhvillimit etj. Ligji dhe aktet nënligjore duhet të kenë një justifikim për trajtimin e diferencuar të ndihmësit personal në aspektin e njohjes së periudhës së përkujdesit si periudhë kontributive, në të kundërt është i nevojshëm rishikimi i kujdesshëm i tyre për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë.

Përfundime dhe Rekomandime

Legjislacioni shqiptar në fushën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar ka pësuar ndryshime të konsiderueshme me kalimin e viteve, ndryshime që kanë mundësuar një trajtim më cilësor për personat me aftësi të kufizuara. Prezantimi i konceptit të aftësisë së kufizuar si ndërveprim i faktorëve bio-psiko-socialë e ka modernizuar sistemin e

vlerësimit të aftësisë së kufizuar në vend, megjithatë një vështrim kritik i panoramës së plotë të vlerësimit të aftësisë së kufizuar që përfshin skemën kontributive dhe jokontributive, evidentoi aspekte që mund të kenë nevojë të ri-mendohen për të siguruar shpërndarje më të drejtë të përfitimeve. Në mënyrë të përmbledhur disa nga gjetjet e analizës së legjislacionit janë:

- Në Shqipëri aftësia e kufizuar nuk matet me një “etalon” të vetëm, gjë e cila evidentohet nga përdorimi i Modelit Mjekësor dhe Modelit Bio-Psiko-Social;
- Modeli mbizotërues duket se vazhdon të jetë Modeli Mjekësor (në skemën kontributive dhe në Statuset e Para-Tetraplegjisë dhe Verbërisë), ndërkohë që Modeli Bio-Psiko-Social zbatohet vetëm në skemën jokontributive për personat që kanë aftësi të kufizuara fizike e mendore;
- Aktet nënligjore për zbatimin e Modelit Bio-Psiko-Social kanë paqartësi për sa i takon kriteret e përfshirjes dhe përjashtimit nga aplikimi dhe përfitimi. Kjo paqartësi lë hapësira për interpretim, e për rrjedhojë rënie në gabim ose abuzim;
- Legjislacioni shqiptar lë hapësira për trajtim diskriminues, qoftë pozitiv apo negativ, e cila evidentohet në garantimin e të drejtës së përfitimit në skemën kontributive dhe jokontributive në të njëjtën kohë për kategori të caktuara si të verbërit dhe personat që janë në kushtet e paraplegjisë ose tetraplegjisë, të cilët mund të përfitojnë status pavarësisht moshës dhe të ardhurave të tjera;
- Përfitimi i ndihmësit personal është shërbim që ofrohet në skemën kontributive, jokontributive dhe në Statuset e Para-Tetraplegjisë dhe Verbërisë, megjithatë evidentohet diskriminim pozitiv në trajtimin e ndihmësve personalë të personave që

gëzojnë Statusin e Para-Tetraplegjisë, të cilëve periudha e kujdesit për invalidin para-tetraplegjik u njihet si periudhë kontributive për efekt pensioni pleqërie, barrëlidnjeje etj.

- Masa e përfitimit për aftësinë e kufizuar ndryshon në skemën kontributive dhe jokontributive, pasi pavarësisht sëmundjes ose kufizimeve të ngjashme, përfitimet në skemën kontributive janë pashmangshmërisht të lidhura me periudhën e sigurimit. Megjithatë, lidhur me masën e përfitimeve vërehet një trajtim favorizues për invalidët e punës të cilët përfitojnë një shtesë mbi invaliditetin që mbulohet nga buxheti i shtetit.

Mbështetur mbi këto gjetje rekomandohet:

- Unifikimi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të siguruar që aftësia e kufizuar matet më një standard;
- Rishikim i legjislacionit për Modelin Bio-Psiko-Social me qëllim përcaktimin e qartë të kriterëve për përfshirjen dhe përjashtimin nga skema;
- Rivlerësimi i përfitimeve në tërësi për të siguruar sheshim të diferencave mes skemave, si edhe rivlerësim në veçanti të përfitimeve për ndihmësin personal, duke konsideruar përkujdesin si periudhë kontributive për të gjithë ndihmësat personalë.

REFERENCES

Referencat

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore, ISSH & Ministria e Shëndetësisë, MSH. (2005). “Rregullore për Organizimin, të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve”; <https://www.iss.gov.al/wp-content/uploads/2017/04/Rreg-KMCAP-30-5-2005.pdf> (parë më 15.11.2024)
- Këshilli i Ministrave, KM. (1997). Vendim nr. 277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar; <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fshendetesia.gov.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2024%2F07%2FVKM-nr.-277-i-azhornuar.doc&cwdOrigin=BROWSELINK> (parë më 15.11.2024)
- Këshilli i Ministrave, KM. (2001). Vendim nr. 31, datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar; <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Vendim%20i%20KM:31:20.01.2001> (parë më 12 nëntor 2024)
- Këshilli i Ministrave, KM. (2008). Vendim nr. 869, datë 18.6.2008 “Për zbatimin e Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e Invalidit”, i ndryshuar; <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2009/12/16/1235/aad6de6e-dfd0-4c14-a12e-962a1e46887d> (parë më 13.11.2024)
- Këshilli i Ministrave, KM. (2016). Vendim nr. 431, datë 08.06.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, i ndryshuar; https://platforma-pak.al/wp-content/uploads/2021/09/431_VENDIM.pdf (parë më 15.11.2024)
- Këshilli i Ministrave, KM. (2019). Vendim nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, i ndryshuar; https://platforma-pak.al/wp-content/uploads/2021/09/722_vendim-2019-11-11-722-1.pdf (parë më 12.11.2024)
- Këshilli i Ministrave, KM. (2020). Vendim nr. 182, datë 26.2.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat

- me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal”, i ndryshuar; <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/09/09/707/42cf403d-c56c-4a31-8d57-4c7dba04b0f9> (parë më 10.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (1993). Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Link: https://www.isshe.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/LIGJ-Nr.-7703-date-11.05.1993_i-perditesuar_2023.pdf (parë më 10.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (1994). Ligji 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar; <https://adrf.al/images/publications/Guida-statusi-i-invalidit-te-punes.pdf> (parë më 15.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (1996). Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e te Verbërit”; https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Ligj-1996-03-28-8098_statusi_te-verberit.pdf (parë më 12.10.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (1998). “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ce-4bc5-8d93-d928cf6f2abd> (parë më 13.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2000). Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Para-Tetraplegjik”, i ndryshuar; <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2000/06/22/8626> (parë më 12.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2014). Ligji nr. 13/2014, datë 13.2.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë””; <https://qbz.gov.al/preview/10351a58-7d0c-4297-b2c1-cb6e7c55226f/cons/20230901> (parë më 11.11.2024)
- Kuvendi i Shqipërisë, KSH. (2019). Ligji nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/07/18/57/37004448-df0e-4768-9e88-35766f95ec4f> (parë më 15.11.2024)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, MSHMS. (2019). “Dokumenti i Politikave për Reformimin e Skemës së Aftësisë së Kufizuar”; https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/VKM2024-03-13-152_.pdf (parë më 10.10.2024)
- Ministria e Punëve të Jashtme, MSA. (2006). “Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit mes Shqipërisë dhe vendeve anëtare të Bashkimit Europian”, <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/MSA-BE-Shqiperi-sq.pdf> (parë më 15.10.2024)
- Palier, B. (2010). *A long goodbye to Bismark*, Amsterdam University Press
- United Nations, UN. (2006). *Convention on the Rights of People with Disabilities*. New York.
- Vaso-Xhumari, M. (2009). *Proceset dhe institucionet e politikës sociale*. Tiranë: ABC.

ABSTRACT

Albanian legislation on disability assessment has been enriched over the past three decades to better address the needs of people with disabilities. Cash benefits remain one of the oldest and most regulated types of benefits in legislation, compared to other areas such as education, accessibility, housing, social inclusion, etc. Cash benefits are provided by both contributory and non-contributory schemes. The purpose of this article is to analyse Albanian legislation on disability assessment, identifying gaps in current assessment schemes. A detailed review of Albanian legislation related to the contributory and non-contributory schemes revealed that currently, there is no a unified standard used for disability assessment in Albania. The contributory scheme relies on the medical model, while the non-contributory scheme has been operating for at least five years based on a bio-psycho-social assessment model. Although the

Bio-Psycho-Social model for disability assessment reflects the modern concept of disability according to the UN Convention for the Rights of PwDs, it is not the dominant model in Albania. The critique in this realm is not solely a matter of “a model”, as the use of multiple standards for disability assessment results in differential and sometimes privileged treatment, such as the opportunity of blind and paraplegic individuals to benefit from both contributory and non-contributory schemes simultaneously. Revisiting certain aspects of the legislation, with a particular focus on unifying treatment and assessment standards, is necessary to ensure fairer support for people with disabilities.

Key words: *Legislation PwDs, critical analysis, contributive scheme, non-contributive scheme cash benefits*

**OBJEKTIVAT SOCIALË TË SANKSIONUARA
NË KUSHTETUTËN SHQIPTARE,
NË KUADËR TË JURISPRUDENCËS
SË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Enkeleida SHYLE PETANAJ
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Drejtësisë
E-mail: enkeleida.petanaj@fdut.edu.al

Klaudia REKA
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Drejtësisë
(Doktorante)
E-mail: klaudia.reka@fdut.edu.al

PËRMBLEDHJE

Në punim shqyrtohen rastet e iniciativave kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë të lidhura me detyrimet e shtetit për përmbushjen e objektivave sociale të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Metodologjia e punimit është përshkruese dhe analizuese mes studimeve të rastit të dispozitave kushtetuese dhe vendimeve të gjykatës dhe jep përgjigje të pyetjeve kërkimore: a është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese shqyrtimi i kërkesave në lidhje me objektivat social; cilat janë parimet dhe standardet kushtetuese kombëtare dhe ndërkombëtare që duhet të përmbushin iniciativat ligjore të shtetit, në përmbushje të objektivave social? Qëllimi i këtij punimi është evidentimi e nxjerrja në pah e mekanizmave kushtetues dhe ligjor për përmbushjen e objektivave sociale nga ana e shtetit, si dhe vështirësitë që kanë hasur gjatë gjykimit Kushtetues nga ana e grupeve për realizimin e të drejtave të tyre. Objektivat sociale të shtetit edhe pse janë të përfshirë në kushtetutë nuk përbëjnë një të drejtë themelore të individit, por nëpërmjet sanksionimit të tyre në aktin themelor e imponon shtetin për bërjen dhe vënien në zbatim të politikave

efektive, të cilat duhet të kenë si qëllim realizimin e tyre, pasi objektivat social nuk janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pas analizave konstatohet se rregullimet që i përkasin sistemit të mbrojtjes sociale të shtetit duhet të përputhen me parimet, vlerat dhe standardet kushtetuese si dhe detyrimet që burojnë nga Karta Sociale Europiane, të cilat janë: dinjiteti njerëzor, shteti i së drejtës, barazia, respekti për të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit.

Fjalë kyçe: *Objektiva socialë, parime, standarde kushtetuese, Karta Sociale Europiane*

Dr. **Enkeleida SHYLE PETANAJ** ka një përvojë në mësimdhënie prej vitit 2003. Nga tetori i vitit 2019 është angazhuar si pedagoge e ftuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Publike. Nga viti 2023 është lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të së Drejtës Publike. Ajo është pjesëmarrëse në disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka publikuar disa artikuj në revista të ndryshme lidhur me fushat e saj të interesit.

Klaudia REKA është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, ku është asistent lektor. Ka kryer Shkollën Kombëtare të Avokatisë, ku ka marrë edhe titullin Avokat në vitin 2016. Gjatë karrierës së saj ka pasur eksperiencë të ndryshme si: asistent avokat në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, juriste në organizata jo-fitimprurëse NGO “Futural”, qendra “Equilibrium” dhe “Woman to Ward Integration”. Karrierën akademike e ka nisur në Fakultetin e Drejtësisë në vitin 2016. Ajo është pjesëmarrëse në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare si dhe ka publikuar artikuj shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare.

Gjkimi kushtetues i objektivave social të një shteti është një temë që kërkon një studim të thellë të doktrinës dhe jurisprudencës së gjykatës Kushtetuese Shqiptare. Gjatë këtij studimi ka qenë e vështirë të plotësohet e gjithë pamja doktrinare dhe juridike që lidhet me të gjitha pikat e sanksionuara në Kushtetutën Shqiptare, si objektiva socialë të shtetit. Vështirësi janë hasur në gjetjen e studimeve konkrete në këtë aspekt dhe doktrinën ligjore, e cila ka trajtuar gjykimin kushtetues të objektivave socialë. Pavarësisht kufizimeve u shfrytëzua jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, dhe raste të GJEDNJ-së e të gjykatave Kushtetuese të vendeve të tjera, për të sjellë një punim modest për këtë temë, mendime dhe sugjerime duke e lënë në vijimësi të hapur trajtimin e saj.

Vështrim kushtetues i objektivave social

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë që në preambulën e saj ka shpërfaqur parime dhe vlera, të cilat jo vetëm garantojnë të drejta dhe liritë themelore të individit, por duke marrë përsipër edhe përgjegjësi për të

ardhmen për të ndërtuar me vendosmëri një shtet të së drejtës, demokratik e social, i cili garanton këto të drejta dhe liritë themelore të njeriut. Përfshirja edhe pse me debate (OSCE, 2006) në preambulën e kushtetutës së termit shtet social krahas atij demokratik, ishte një element i ri në doktrinën kushtetuese, madje edhe atë botërore dhe kishte të bënte me detyrimet që i vihen shtetit për të marrë parasysh interesat sociale. Ky term u përdor pas Luftës së Dytë Botërore nga gjermanët për t'i treguar popullit dhe botës se politikën që do të ndiqnin në vazhdimësi do të ishin të tilla: nga njëra anë do të lejonin konkurrencën e lirë e zhvillimin, nga ana tjetër, nuk do të lejonin në asnjë mënyrë krijimin e krizave, si ato që çuan në vendosjen e diktaturës. Në këto ndikim u pa e nevojshme përfshirja e konceptit të shtetit social në preambulën e kushtetutës sonë, por realizimi i së cilit do mbështetej nga dispozita të tjera kushtetuese.

Në këtë frymë të preambulës së Kushtetutës menjëherë pas renditjes së lirive dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore nga hartuesit e Kushtetutës u pa e nevojshme përfshirja në të e një kreu të veçantë, në të cilin të vendoseshin objektivat

e shtetit në përmbushjen e të drejtave dhe nevojave sociale për personat. Përfshirja tyre në një kre të veçantë tregonte qartazi frymën e saj moderne dhe inovative.

Objektivat social të shtetit shqiptar parashikuar në nenin 59 të kreut të V të Kushtetutës janë:

- punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
- plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
- standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
- arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;
- një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;
- përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;
- zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;
- riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;
- mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Objektivat social të renditura në nenin 59 të kushtetutës, edhe pse të vendosura menjëherë pas kreut të të drejtave dhe lirive themelore të individit nuk njehsohen me to, pasi përmbushja e tyre nuk mund të kërkohej si një e drejtë, drejtpërdrejtë në gjykatë (Kushtetuta, 1998).

Të drejtat sociale dallojnë nga objektivat socialë, pasi këta të fundit janë shprehje e qëllimeve të shtetit dhe parimeve të politikave të hartuara prej tij për orientimin e veprimtarisë në përgjithësi dhe veçanërisht,

të politikave sociale. Objektivat socialë janë shprehje e veprimit pozitiv të shtetit në favor të personave me aftësi të kufizuara dhe për rrjedhojë, realizimi i tyre është ngushtësisht i lidhur me kushtet, mjetet dhe mundësitë e disponueshme buxhetore të shtetit. Megjithatë ato përbëjnë një tregues të rëndësishëm për të matur shkallën e respektimit të të drejtave social-ekonomike në vend (Omari & Anastasi, 2017: 89). Këto objektiva shteti synon t'i realizojë vetë nëpërmjet respektimit të kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private (Kushtetuta, 1998). Kushtetuta bën referimin te ligji, si instrumenti më i rëndësishëm që përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohej realizimi i këtyre objektiveve. Megjithëse mendohet se objektivat social kanë karakter deklarativ, Kushtetuta i ngarkon organet shtetërore të marrin përsipër të kryejnë detyrat që u ngarkon ajo për të hartuar politika dhe duke nxjerrë ligjet përkatëse, në përputhje me vlerat dhe parimet e saj. Por nga ana tjetër kushtetuta bën kujdes që krahas standardeve që duhet të përmbushen, të mbahen parasysh fakti se masa e zbatimit të tyre në praktikë, varet edhe nga mundësia e brendshme e vendit (Omari & Anastasi, 2017: 89).

Megjithatë shteti, për përmbushjen e objektiveve social, duhet të zbatojë dhe angazhimet që ka marrë nga aktet përkatëse ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat lidhen me respektimin të drejtave social-ekonomike, sikurse është Karta Sociale Evropiane (KE, 1966) dhe Konventa Evropiane e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KE, 1950).

Kushtetuta sociale e Evropës, karta sociale evropiane

Karta Sociale Evropiane, e miratuar në vitin 1961 dhe e rishikuar në vitin 1996, është homologia e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e të drejtave

ekonomike dhe sociale. Ajo garanton një gamë të gjerë të të drejtave të njeriut të lidhura me punësimin, strehimin, arsimin, mbrojtjen sociale dhe mirëqenien. Nuk ka asnjë instrument tjetër ligjor në nivelin evropian që përmban një mbrojtje të tillë të gjerë dhe të plotë të të drejtave sociale sa mbrojtja që ofrohet nga Konventa. Për këtë arsye, karta konsiderohet si Kushtetuta Sociale e Evropës dhe përfaqëson komponentët thelbësorë të arkitekturës së të drejtave të njeriut të kontinentit (KE, 2020). Që nga mesi i viteve 2000, dispozitat e Kartës janë ndarë në katër grupe tematike:

- Grupi 1. Punësimi, trajnimi dhe mundësitë e barabarta (neni 1, 9, 10, 15, 18, 20, 24, 25).
- Grupi 2. Shëndeti, sigurimet shoqërore dhe mbrojtja sociale (neni 3, 11, 12, 13, 14, 23, 30).
- Grupi 3. Të drejtat e punës (neni 2, 4, 5, 6, 21, 22, 26, 28, 29).
- Grupi 4. Fëmijët, familjet, emigrantët (neni 7, 8, 16, 17, 19, 27, 31).

Respektimi i Kartës nga Shtetet palë shqyrtohet nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale çdo 5 vjet nga ratifikimi. Janë dy mekanizma monitorimi të Kartës: procedura e ankesave kolektive dhe procedura e raportimit. Sot, Karta është një nga standardet më të pranuar të të drejtave të njeriut brenda Këshillit të Evropës. Shqipëria e ka nënshkruar atë që në vitin 1998 dhe ratifikuar në 14.11.2002. Që prej ratifikimit Shqipëria ka paraqitur 13-të raporte ndërmjet viteve 2005-2023 mbi zbatimin e Kartës Sociale. Në raportin e 13-të të Këshillit të Evropës në lidhje me implementimin e saj nga qeveria shqiptare, në shtator të vitit 2022, për periudhën e monitorimit 2017-2020, në lidhje me zbatimin e grupimit të tretë të Kartës, “të drejtat e punës” ka rezultuar se (KE, 2023):

Shqipëria ka shkelur disa nene kritike të Kartës Sociale Evropiane në lidhje me

mbrojtjen e shëndetit, kushtet e sigurta të punës, ndihmën sociale, mjekësore dhe të mirëqenies, mbrojtjen sociale dhe të drejtën për mbrojtje nga varfëria dhe përjashtimi social. Shqipëria ka dështuar vazhdimisht në përmbushjen e standardeve për nenin 3 të Kartës, i cili i referohet të drejtës për kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune për shkak të mos konsultimit të qeverisë me punëdhënësit dhe organizatat e punëtorëve për çështjet përkatëse.

Gjithashtu Shqipëria nuk ka dispozita për të mbrojtur punëtorët nga rreziqet shëndetësore në punë, duke përfshirë rreziqet psikosociale. Për më tepër, nuk kishte mbrojtje për punëtorët e përkohshëm dhe asnjë konsultim me palët e interesuara në asnjë moment. Një nivel “i papërshtatshëm” i mbrojtjes për punëtorët kundër asbestit u raportua gjithashtu pasi autoritetet nuk kanë arritur të hartojnë një inventar të vendndodhjeve që e përdorin atë ose të ndërmarrin hapa për të mbrojtur punëtorët që punojnë aty ku ai është i pranishëm. Në temën e të drejtës për kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune, Shqipëria dështoi në zbatimin e rregulloreve të shëndetit dhe sigurisë. Raporti konstatoi se aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale nuk monitorohen në mënyrë efektive dhe aktivitetet e Inspektoratit të Punës nuk janë efektive në praktikë. Nuk ka masa për të nxitur zhvillimin progresiv të shërbimeve shëndetësore dhe nuk ka strategji për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore në punë për të gjithë punëtorët.

Shqipëria dështoi gjithashtu në përmbushjen e detyrimeve për nenin 11 që trajton të drejtën për mbrojtjen e shëndetit. Raporti konstatoi se shpenzimet publike për shëndetësi janë shumë të ulëta dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor është subjekt i vonësve të panevojshme. Në veçanti, Shqipëria nuk arriti të ofrojë informacion mbi jetëgjatësinë për grupet urbane, rurale, etnike dhe minoritetet. Shteti shqiptar nuk

ka ofruar informacion në lidhje me shkallën e vdekjeve për punë specifike ose afërsinë me zona aktive industriale ose të kontaminuara. Nuk u dha asnjë informacion për kujdesin shëndetësor seksual dhe riprodhues për gratë dhe vajzat, as nuk kishte dëshmi për ndonjë politikë për të parandaluar vdekjen e parakohshme të grave dhe vajzave në këtë kontekst. Pyetjet e rëndësishme për abortin, vdekshmërinë e nënave, kontracepsionin dhe sëmundjet e transmetuara nga gjaku mbeten jokonformuese.

Shqetësime të tjera ishin që edukimi shëndetësor duhet të përfshihet në kurrikulën shkollore dhe se këshillimi dhe kontrolli duhet të ofrohen për gratë shtatzëna në të gjithë vendin. Akoma më shqetësuese, raporti vuri në dukje se qeveria nuk ka marrë masat e duhura për të mbrojtur qytetarët nga ndotja e mjedisit. Gjithashtu, në temën e vaksinimeve, ka pasur mospërputhje me të drejtën për një program efikas të imunizimit dhe monitorimit epidemiologjik, duke vënë në dukje se kjo nuk zbatohet në Shqipëri. Ende nuk është publikuar raporti i 14-të, i cili ka të bëjë me grupin 4 “Shëndeti, sigurimet shoqërore dhe mbrojtja sociale”. Ndërkohë qeveria ka hartuar strategji dhe plane kombëtar për përmbytjen e detyrimeve që vijë nga kushtetuta, në kuadër të përmbytjes së objektivave social të sanksionuara në kushtetutë” (KM, 2024), si dhe ka miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore për secilën nga pikat e nenit 59 të kushtetutës.

Një vështrim i përgjithshëm mbi jurisprudencën e gjykatës kushtetuese shqiptare në lidhje me gjykimin kushtetues të objektivave social

Sikurse e theksuam edhe më sipër nga njëra anë objektivat social të parashikuara në dispozitat Kushtetuese kanë karakter deklarativ, por nga ana tjetër baza e shtetit janë parimet dhe vlerat e sanksionuara në kushtetutë (neni 3) të cilat shteti ka për

detyrë ti respektojë dhe mbrojë. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese mbrojtja sociale e personave realizohet përmes dy mekanizmave: së pari, nëpërmjet zbatimit të garancive të shprehura në të drejtat dhe liritë ekonomiko-sociale, të parashikuara në Kreun IV të Kushtetutës dhe së dyti, nëpërmjet përmbytjes së objektivave sociale përmes materializimit të tyre në ligje, në referim të nenit 59 të Kushtetutës. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese (GJK, 2012a; GJK, 2012b; GJK, 2013) vazhdimisht ka mbajtur qëndrimin se përmbytja e objektivave socialë nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që u përkasin juridiksionit të kontrollit kushtetues. Gjykata Kushtetuese e ka gjetur si të pabazuar pretendimin e kërkuar për cenimin e parimit të sigurisë juridike duke mbajtur qëndrimin se përmbytja e objektivave socialë nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që u përkasin juridiksionit kushtetues pasi “natyra e përfitimit të kompensimit për shërbimin e transportit, energjinë elektrike dhe telefoninë fikse për shkak të aftësisë së kufizuar, është shprehje e mbrojtjes sociale e realizuar përmes përmbytjes së objektivave socialë, në kuptim të nenit 59 të kushtetutës. Ky përfitim si objektiv social përmbyhet brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon Këshilli i Ministrave (GJK, 2013). Në vijim është arsyetuar se objektivat socialë janë shprehje e veprimit pozitiv të shtetit në favor të personave me aftësi të kufizuara dhe për rrjedhojë, realizimi i tyre është ngushtësisht i lidhur me kushtet, mjetet dhe mundësitë e disponueshme buxhetore të shtetit. Por gjykata ka arsyetuar se: “në çdo rast, këto kufizime nuk duhet të cenojnë thelbin e së drejtës dhe duhet të respektojnë kërkesat kushtetuese të parashikuara në nenin 17 të kushtetutës (po aty). Janë pikërisht kufijtë e vendosur në nenin 17 të Kushtetutës që duhet të vlerësohen dhe të merren parasysh në rastin e gjykimin kushtetues të

masave të marra nga Këshilli i Ministrave, apo legjislatori që vendosin standardet kushtetuese nëse e cenojnë ose jo thelbin e së drejtës. Gjykimi kushtetues në raste të tilla do të duhet të bëjë së pari kontrollin nëse ligji nuk është miratuar në përputhje me Kushtetutën. Neni 59/2 i Kushtetutës vendos detyrime për ligjvënësin, se është ligji, i cili duhet të përcaktojë kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i objektivave socialë, dhe jo Këshilli i Ministrave. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kjo për faktin se rezerva absolute e ligjit, sipas përkufizimit të bërë nga doktrina kushtetuese, kërkon që një çështje të rregullohet vetëm nga ligji në kuptimin ngushtësisht formal. Kushtetuta ka sanksionuar gjithashtu se kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj (Kushtetuta, 52/2).

Ndërkohë që Kushtetuta vendos detyrime për organet e pushtetit publik, që në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre (Kushtetuta, 15/2). Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese i është referuar parimit të dinjitetit njerëzor si një vlerë që duhet garantuar nga shteti, në përmbushje të objektivave social të tij, por nuk ka sqaruar se cilat janë detyrimet që rrjedhin nga kjo vlerë për ligjvënësin në rastet e hartimit të një ligjit i cili përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave. Kushtetuta në nenet e parë të saj ka sanksionuar se:

“pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa

fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë”.

Ndërkohë dinjiteti i njeriut si një vlerë themelore kushtetuese (GJK, 2006), i imponon në radhë të parë ligjvënësit detyrimin e marrjes së masave për respektimin dhe garantimin e kësaj vlere pasi në një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Sipas jurisprudencës së Gjykatës “të jetuarit me dinjitet përfshin jo vetëm nevojën e ndërveprimit apo bashkëveprimit në shoqëri, por edhe nevojën për të mos u lënë mënjanë nga shteti (po aty).

Gjykata orienton ligjvënësin, konkretisht parlamentin se edhe në rastin e marrjes së masave legjislativë për të realizuar një interes publik të caktuar, siç mund të jetë mbajtja nën kontroll e financave publike apo garantimi i sigurisë ekonomike në rastin e kategorisë së individëve që e kanë të kufizuar aftësinë për të gëzuar plotësisht të drejtat kushtetuese, si pjesa tjetër e popullsisë, duhet të jenë në vëmendjen e veçantë të ligjvënësit. Ajo gjithashtu ka vendosur një standard përse i përket hartimit të legjislacionit në përmbushje të objektivave social të shtetit duke sanksionuar se:

në çdo rast këto rregullime duhet të përputhen me parimet vlerat dhe standartet kushtetuese si dhe me detyrimet që burojnë nga Karta Sociale Europiane që janë: barazia, drejtësia sociale, respekti për të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit (GJK, 2013).

Në lidhje me këtë parim edhe sipas GJEDNJ-së, nëse shtetit i është dhënë një hapësirë e gjerë për të marrë masat e duhura për politikën sociale, roli i Gjykatës është të përcaktojë, nëse ato bien brenda

kufijve të “arsyeshmërisë”. Shteti nuk është i kufizuar nga një parim i ngurtë i mos përkeqësimit të të drejtave sociale, për aq kohë sa masat ndjekin qëllimin e mirëqenies së përgjithshme dhe zbatohen në mënyrë progresive dhe proporcional. Po kështu, në çështjen “Larioshina kundër Ruisisë” (GJEDNJ, 2002; cit. UT, 2012) kjo gjykatë ka pohuar se:

një vlerë e pensionit dhe përfitimeve sociale tërësisht e pamjaftueshme për të mbrojtur aplikantin nga dëme fizike, mendore apo situata degradimi të papajtueshme me dinjitetin njerëzor, mund të ngrejë një problem sipas nenit 3 të konventës.

Ndërsa Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë ka theksuar se është detyrë e shtetit të sigurojë kushtet minimale për një ekzistencë të dinjitetit njerëzor nëpërmjet përfitime shtetërore nëse është e nevojshme. Sipas saj “ekziston një e drejtë themelore për garantimin e një minimumi jetik që është në përputhje me dinjitetin njerëzor.” Në këtë vendim ajo ka sanksionuar se është ligjvënësi, dhe jo ekzekutivi ai që duhet të krijojë përfitime sociale e të përcaktojë nivelet e tyre mbi bazën e një procedure transparente e të përshtatshme, në përputhje me nevojën aktuale, zhvillimin e komunitetit dhe kushtet ekzistuese të jetesës (GJKGJ, 2008). Ligjvënësi, në funksion të detyrimit kushtetues për realizimin e objektivave sociale, duhet të mbajë parasysh nocionin e një bërthame minimale të të drejtave dhe lirive të njeriut, siç është zhvilluar nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore¹. Komiteti ka mbajtur qëndrimin se “çdo shtet palë ka detyrimin për të respektuar

një bërthamë minimale që përmbush nivelin minimal esencial të çdo të drejte. Neni 2(1) i konventës detyron çdo shtet palë të ndërmarrë hapa të nevojshëm, duke shfrytëzuar maksimalisht burimet që ka në dispozicion. Nëse një shtet palë ia atribuon dështimin e tij për të përmbushur detyrimin e tij minimal mungesës së burimeve në dispozicion, ai duhet të demonstrojë se është bërë çdo përpjekje për të përdorur të gjitha burimet në dispozicion për të përmbushur, si një çështje prioritare, këto detyrime minimale.” Janë pikërisht këto standarde që duhet të merren parasysh, jo vetëm nga shteti gjatë hartimit të legjislacionit për hartimin e masave dhe kriterëve, për përmbushjen e objektivave sociale, por edhe nga vet gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesave për përmbushjen e standardeve kushtetuese të legjislacionit mbi objektivat social.

Përfundime e rekomandime

Detyrimi i shtetit për të përmbushur objektivat social buron nga Kushtetuta, por rregullat e detajuara të sistemit të mbrojtjes shoqërore nuk përcaktohen nga vetë Kushtetuta, ndaj në këtë drejtim ligjvënësi gëzon diskrecion në përcaktimin e këtyre rregullave. Megjithatë, ky diskrecion nuk është i pakufizuar pasi parimi i sigurisë juridike, si standard kushtetues, i zhvilluar nga jurisprudenca e Gjykatës i imponon ligjvënësit detyrimin për të përcaktuar kriterë ligjorë të qarta, të qëndrueshme dhe mbi të gjitha jo arbitrare, dhe nuk duhet t'i delegojë Këshillit të Ministrave marrjen e masave konkrete, duke qenë se nga raportet e Këshillit të Evropës Shqipëria ka shkelur disa nene kritike të Kartës Sociale Evropiane. Gjykata Kushtetuese

¹ Komiteti për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR) është një organ që monitoron implementimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nga shtetet palë. Ky komitet është krijuar nga rezoluta nr. 1985/17, datë 28 maj 1985, e Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC). Shqipëria është shtet palë i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore që prej datës 4 tetor 1991.

në jurisprudencën e saj pa arsyetuar dhe në mënyrë të paqartë ka shmangur apriori juridiksionin e kontrollit kushtetues të ligjeve duke vendosur se përmbushja e objektivave socialë nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit të kontrollit kushtetues, pasi në praktikën e saj është shprehur se parimi i sigurisë juridike mbrohet dhe të drejta të tjera ligjore. Ndërkohë siguria juridike dhe mbrojtja e të drejtave të fituara, e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca e Gjykatës, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 4 të Kushtetutës.

Një standard tjetër kushtetues që duhet të mbahet parasysh për përmbushjen e objektivave social është ai që shteti, me qëllim garantimin e dinjitetit njerëzor, të një niveli të pranueshëm jetese si dhe ruajtjen e interesave të të gjitha shtresave të shoqërisë, mund të ndryshojë mekanizmin e realizimit të këtyre të drejtave, veçanërisht kur nuk ka mundësi financiare për rishpërndarje proporcionale të fondeve në dispozicion ose kur këto masa diktohen nga nevoja për të eliminuar apo parandaluar rreziqe reale ndaj sigurisë ekonomike, por në çdo rast, këto kufizime nuk duhet të cenojnë thelbin e së drejtës dhe duhet të respektojnë kërkesat e parashikuara në nenin 17 të kushtetutës.

REFERENCAT

- Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). 2012. “Valkov dhe të tjerë kundër Bullgarisë, nr. 2023/04), https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/handbook_non_discr_law_sqi_02 (parë më 20.12.2024).
- Gjykatës Kushtetuese e Gjermanisë, GJKGJ. 2008. “Vendim 25 kokrrik 2008; [https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/docx/?library=ECHR&id=001-127474&filename=CASE%20OF%20VON%20HANNOVER%20v.%20GERMANY%20\(No.%202\)%20-%20%5BAlbanian%20Translation%5D%20by%20the%20COE%20Human%20Rights%20Trust%20Fund.docx&logEvent=False](https://hudoc.echr.coe.int/app/conversion/docx/?library=ECHR&id=001-127474&filename=CASE%20OF%20VON%20HANNOVER%20v.%20GERMANY%20(No.%202)%20-%20%5BAlbanian%20Translation%5D%20by%20the%20COE%20Human%20Rights%20Trust%20Fund.docx&logEvent=False) (parë më 12. 9. 2024).
- Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (GJK). 2006. “Vendimi nr. 20/2006, https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2017/04/Vendimi_nr1_20__date_11.07.2006.pdf (parë më 10. 9. 2024).
- Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (GJK). 2012a. “Vendimi nr.34, datë 28.05.2012 (parë më 12. 9. 2024). https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=1207&nr_vendim=1 (parë më 12. 10. 2024).
- Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (GJK). 2012b. “Vendimi nr. 37, datë 13.06.2012; https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=1214&nr_vendim=1 (parë më 10. 10. 2024).
- Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (GJK). 2013. “Vendimi nr. 10, datë 18.03.2013; https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=1350&nr_vendim=1 <https://www.gjk.gov.al/> (parë më 10. 11. 2024).
- Këshilli i Europës (KE). 1950. “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj)”, https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/convention_sqi (parë më 12. 10. 2024).
- Këshilli i Europës (KE). 1966. *Karta Sociale Evropiane* (e rishikuar), <https://rm.coe.int/168047e169> (parë më 11. 10. 2024).
- Këshilli i Europës (KE). 2020. “Karta social evropiane në një vështrim...”: <https://rm.coe.int/la-charte-sociale-en-bref/1680a090d3> (parë më 10. 10. 2024).
- Këshilli i Europës. (KE). 2023. “Albania and the European Social Charter”, <https://rm.coe.int/albania-september2023-en-2766-2408-4232-1/1680ad398f> (parë më 12. 10. 2024).

- Këshilli i Ministrave (KM). 2024. Vendim Nr. 152, 13.3.2024 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”, https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/VKM2024-03-13-152_.pdf (parë më 12. 10. 2024).
- Kuvendi i Shqipërisë (Kushtetuta). 2022 [1998]. “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (me ndryshimet), <https://qbz.gov.al/preview/635d44bd-96ee-4bc5-8d93-d928cf6f2abd> (parë më 12. 11. 2024).
- Omari, Luan dhe Aurela Anastasi. 2017. *E drejta kushtetuese*, Tiranë: Dajti 2000.
- OSCE (ed.). 2006. *Debati Kushtetues*, Vëllimi 1, Tiranë: Botimet OSCE
- OSCE (ed.). 2006. *Debati Kushtetues*, Vëllimi 2, Tiranë: Botimet OSCE
- Universiteti i Tiranës, UT. 2022. “Roli i Gjykatës Kushtetuese në zhvillimin e së drejtës”, Proceedings; <https://fdut.edu.al/wp-content/uploads/2024/04/Libri-per-Web.pdf> (parë më 10. 9. 2024).

ABSTRACT

The purpose of this article is to review instances decided by the Constitutional Court of the Republic of Albania involving constitutional initiatives concerning the state's responsibility to meet the social objectives outlined in the Republic of Albania's Constitution. The methodology of the work is descriptive and analytical between case studies of Constitutional provisions and Court decisions and provides answers to research questions: Is it within the Constitutional Court's jurisdiction to evaluate requests relating to social objectives? What are the national and international constitutional principles and criteria that must be met by the state's legal actions to achieve social objectives? The purpose of this paper is to highlight the constitutional and legal mechanisms for the fulfillment of social objectives by the state, as well as the difficulties encountered during the Constitutional trial by the groups for the realization of their rights. Although the social objectives of the state are included in the Constitution, they do not constitute a fundamental right of the individual; however, their inclusion in the basic act imposes on the state the obligation to develop and implement effective policies aimed at achieving them, because the social objectives are not directly applicable. Following analysis, it is discovered that the state's social protection system regulations must abide by the principles, values, and standards of the constitution as well as the duties derived from the European Social Charter, which include the prohibition of discrimination, equality, social justice, and respect for human rights.

Keywords: *Social objectives, principles, constitutional standards, European social cards.*

AUTORITARIZMI DHE DEMOKRACIA.

RASTI FUJIMORI

Fejzi LILA

Kolegji Universitar i Biznesit, Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/Ministria e Drejtësisë

E-mail: fezilila@gmail.com & flila@kub.edu.al

PËRMBLEDHJE

Alberto Fujimori në fillim të viteve 1990, nga profesor universiteti krijoi partinë, shfrytëzoi krizat e shoqërisë duke u bërë president dhe arriti të fitojë duke u mbështetur tek peruanët e thjeshtë. Ai përfaqësonte politikanët e vjetër dhe me influence por i shurdhër ndaj shqetësimeve të njerëzve të thjeshtë. Me një ligjërimit populist u shndërrua alternativë për ndryshim të Perusë nga gjendja aktuale dhe ta udhëhiqte drejt një fati më të mirë. Përballja me elitën e vjetër politike, format tradicionale të pushtetit dhe qenia i jashtëm për politikën peruane nuk e ndihmuan në konsolidimin e pushtetit. Fujimori i mungonte eksperiencia e politikave legjislativë dhe durimi për të pritur, preferoi të qeveriste i vetëm në vend të negociimit e bashkëqeverisjes, anashkaloi Kongresin, qeverisi me dekrete ekzekutive dhe me angazhim të pakët ndaj institucioneve demokratike. Ai përdori programe sociale dhe u paraqit si lider tradicional demokratik.

Aftësia, personaliteti dhe karakteri i tij shërbyen për të avancuar në qëllimet e tij politike duke minuar demokracinë dhe përqafuar qasjet neo-autoritare ndaj liderit. Fujimori për dy vjet nga shpresë e peruanëve u shndërrua autoritarizëm të theksuar dhe tipare tiranie. Ai rikujton se demagogët e zgjedhur me votë mund të fitojnë postet publike pa pasur plan për autokraci, por shkatërrimi i demokracisë mund të bëhet edhe pa plan.

Përqendrimi i pushtetit, qasja populiste dhe dobësia e partive politike, sugjerojnë se tensioni midis elementeve demokratike dhe autokratike nuk mund të pajtohet kurrë siç duhet. Metodologjia e punimit bazohet në të dhëna empirike dhe analitike, konkluzionet e arritura mund të na ndihmojnë në fushën e studimit të shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: *Fujimori; Shoqëria Peruane; Alternativë Politike; Institucione; Autoritarizëm; Demokraci.*

Fejzi LILA është Doktor i shkencave në profil “Shkenca Politike & Marrëdhënie Ndërkombëtare” nga Universiteti European i Tiranës (UET), ndërsa më herët ka kryer Akademinë e Forcave Tokësore “Skënderbej” Tiranë (bachelor & master i shkencave) si dhe posdiplomimin për “Marrëdhënie Ndërkombëtare & Diplomaci” dhe “Lidership & Menaxhim Krizash” pranë Akademisë Diplomatike Shqiptare (ADSH). Ai është bashkëautor i librit “Lidershipi Shqiptar përmes Historisë së Ushtrisë” dhe autor i librit “Lidershipi Shqiptar - Shqipëria Politike: 1912 – 1989”. Nga viti 2014 e në vijim është pjesë e Akademisë Diplomatike Shqiptare (ADSH) anëtar i rregullt (good standing) i Institutit Shqiptar të Sociologjisë (AIS & ALBSA), pjesë e institucioneve të sigurisë kombëtare, autor i mjaft punimeve shkencore brenda dhe jashtë vendit dhe pjesë e stafit akademik në Shqipëri e rajon.

Udhëheqësi peruan Alberto Fujimori nuk e kishte menduar se një ditë do bëhej president e jo më diktator. Si profesor universiteti dhe me prejardhje japoneze, ai synonte një vend në senat, por asnjë subjekt politik nuk e nominoi. Në fillimet e viteve 90’ shekulli i kaluar, Fujimori krijoi partinë e vet dhe me parrullën “Një president si ju” arriti të nominojë veten. Duke shfrytëzuar krizat që kishte përfshirë shoqërinë peruane, kolapsin ekonomik, inflacionin e lartë dhe alergjinë e krijuar ndaj partive të vjetra politike, emri i tij arriti shumë shpejt vetëm rritje (Correa, 2021: 1-4). Kjo figurë në balotazh me shkrimtarin më të famshëm vendas e fitues i çmimit Nobel në letërsi, arriti të fitojë duke u mbështetur tek peruanët e thjeshtë. Fujimori nga një komentator politik dhe anëtar themelues i partisë Cambio 90-Nueva Mayoría, ishte një kandidat surprizë për zyrën qendrore të vendit, konkurrues kundër romancierit Mario Vargas Llosa, ky i fundit njeri i konsideruar e pjesë e një elite dhe figurë e njohur në sytë e publikut (Pilan, 2019: 24).

Për opinionin publik peruan Vargas Llosa përfaqësonte klasën e lartë dhe të arsimuar, politikanët e vjetër e me influencë, median, një pjesë të botës së biznesit por i shurdhërt ndaj shqetësimeve e halleve të njerëzve të thjeshtë. Fujimori përqafoi klasën e pashkolluar dhe më të ulët dhe me një ligjërim populist në këtë lloj zemërimi paralajmëroi se shoqëria peruane po përballlej me një nga krizat më të mëdha të historisë së saj republikane. Shumë shpejt ligjërimi populist i Fujimorit u shndërrua

në alternativën e vetme për ndryshim dhe fitoi. Fujimori mori shifra të larta votimi për shkak të perceptimit të ish-Profesorit që nuk i përshtatej modelit standard të politikanit, deklaratave në lidhje me ndryshimet ekonomike dhe shpjegimit të një procesi të qëndrueshëm për reduktimin e rrezikut të goditjes inflacioniste (Beman, 2021: 14). Fujimori gjithashtu përfaqësonte një kontrast të mprehtë social dhe etnik me imazhin e bardhë dhe elitë të Vargas Llosa-s. Shoqëria peruane karakterizohej nga dhuna, korrupsioni, terrorizmi dhe trafikimi i drogës. Fujimori si alternativë u zotua ta nxjerrë Perunë nga gjendja aktuale e ta udhëhiqte drejt një fati më të mirë. Vendi kishte nevojë për reforma të thella dhe intesifikim të luftës ndaj terrorizmit, ndërsa Fujimori demonstronte vetëm disa ide të vakëta se si mund ti arrinte këto. Përballja me elitën e vjetër politike, miq të pakët në angjesisë tradicionale të pushtetit dhe qenia i jashtëm për politikën ishin pengesa mjaft serioze për konsolidimin e pushtetit. Sulmet e zhvilluara gjatë betejës elektorale ndaj elitës së vjetër duke e etiketuar “oligarki të korruptuar” e që kishin shkatërruar vendin, Fujimori shumë shpejt kupton se ata që kishte mundur në fushatë elektorale vazhdonin të kishin në duar e kontrollonin shumë nivele të pushtetit. Studimet tregojnë se ka mjaft rrugë për të siguruar politikanë cilësorë, ndërsa përvoja ka treguar se e vetmja garanci efektive është “ekzistenca e një shtrese shoqërore që, nga ana e saj, është produkt i proceseve të rrepta përzgjedhëse” (Halevy, 2009: 112).

Fujimori, një bir emigrantësh japonezë, u rrethua me kandidatë të tjerë me prejardhje provinciale dhe me lëkurë të errët. Kjo rezononte shumë mirë me shumicën e popullsisë pasi ai përfaqësonte luftërat e klasave të burrave dhe grave të përditshme të Perusë. Strategjia e tij populiste për të arritur masat në një mënyrë personale dhe jo nga institucionet e themeluara si partitë apo organizatat, bëri që Fujimori të dukej sikur ishte ‘një nga njerëzit’ dhe i bëri zgjedhjet presidenciale të vitit 1990 një konkurrencë shumë të qartë midis ‘popullit’ (Fujimori) kundrejt ‘elitës’ (Vargas Llosa). Demokracia nënkupton që të gjitha grupet t’ia nënshtrojnë interesat e tyre pasigurisë (Halevy, 2009: 154). Votuesit shpesh e shihnin Fujimorin duke hipur në një rimorkio traktori në krahinën e Perusë, ndërsa ai ishte duke bërë fushatë ose duke kërcyer këngë folklorike mes popullatës lokale dhe i veshur si populli thjeshtë. Demokracia nënkupton që të gjitha grupet t’ia nënshtrojnë interesat e tyre pasigurisë (Halevy, 2009: 154). Këto strategji populiste rezonuan me votuesit dhe Fujimori fitoi zgjedhjet presidenciale të vitit 1990 me 57% të votave (Correa, 2021).

Fujimori u përball me fillim të vështirë me Kongresin i cili nuk i kalonte ligjet për aprovim, por atij nuk i mungonte vetëm eksperiencia e politikave legjislative, por edhe durimi për të pritur. Fujimori përballë faktit të ftesës ndaj Presidentit të Senatit Presidencial për të biseduar e kaluar ligjet, preferoi të qeveriste Perunë i vetëm nga laptopi i tij. Kështu, në vend të negociimit e bashkëqeverisjes, Fujimori preferoi etiketimin e drejtuesëve të Kongresit me fjalë të ashpra si “sharlatanë joproduktivë”, sulmoi gjyqtarët që nuk bashkëpunonin si “çakej” “zullumtarë”. Demokracitë mund të vdesin si pasojë e një coup d’etat (grusht shteti) ose mund të vdesin ngadalë. Kjo e dyta ndodh në rrjedhje të një mashtrimi, pak nga pak, fillon me zgjedhjen e një udhëheqësi autoritarian dhe

vazhdon me abuzimin e pushtetit qeverisës dhe shtypjen e plotë të opozitës. (Levitsky & Ziblatt, 2018). Në vitin 1992, Fujimori me mbështetjen e ushtrisë shpërndahu Kongresin e vendit në një përpjekje për të konsoliduar kontrollin politik kundër përfaqësuesve kundërshtarë të qytetarëve, ai kreu zëvendësimin e Kongresit nga një Asamble Kushtetuese që përmbante një shumicë të madhe mbështetësish të Fujimorit (Beman-Cavallaro, 2021: 16).

Gjendja u bë më shqetësuese kur fillon të anashkalojë Kongresin dhe qeverinë me dekrete ekzekutive. Administrata e tij fillon të qahet se kushtetuta e Perusë ishte “e ngurtë”, “kufizuese” dhe se angazhimi i Fujimorit ndaj institucioneve demokratike kishte i pakët. Në një dalje publike me biznesmenët më të rëndësishëm peruanë, Fujimori ngre pyetjen: “a jetojmë në një demokraci të vërtetë? ... vështirë të përgjigjesh po! Jemi një vend që në të vërtetë jemi udhëhequr gjithnjë nga grupe të vogla me pushtet, oligopolët, klikat, lobet...”.

Klasa e vjetër politike peruane nga alarmi i ngritur bën një hap pas. Fujimori me synimin për të futur brenda në burg terroristët, anashkaloi gjykatat duke liruar mijëra të dënuar për krime të vogla. Kundërpërgjigja vjen nga Shoqata Kombëtare e Gjykatësve e akuzoi për “autoritarizëm antidemokratik të papranueshëm” dhe shpallën si jokushtetuese disa dekrete. Kritikët mjaft shpesh e etiketuan “authoritarian” ndërsa media në vend si perandori japonez duke shoqëruar me iniciativa e mocione mosbesimi. Studimet politike sugjerojnë se; *kur populistët fitojnë zgjedhjet, sulmin e parë shpesh e drejtojnë kundër institucioneve demokratike* (Levitsky & Ziblatt, 2018: 33).

Fujimori vazhdon më tej me sjellje kryeneçe duke deklaruar se nuk do ndalem derisa t’i shemb të gjithë, një nga një. Do jem trefish më i guximshëm në rrëzimin e të gjithë mureve që ndajnë vendin nga progresi.

Rreth fundit të vitit 1991 ekzekutivi i dërgon kongresit për miratim një paketë me rreth 120 dekrete ku përfshihen masa antiterrorizëm dhe duke kërcënuar të drejtat e liritë e individit. Kongresi nuk i miraton dhe ky i fundit akuzohet nga Fujimori se kontrollohet nga krimi dhe klanet e drogës. Konflikti përshkallëzohet kur Senati kalon mocion mosbesimi e dorëheqje me motivacionin “moralisht i paafte”. Në këtë kohë në opinionin publik peruan qarkullonte shprehja se: “ose Kongresi do vrasë Presidentin, ose Presidenti do vrasë Kongresin”! *Dy norma dallojnë si shumë të rëndësishme në funksionimin e një demokracie: toleranca e dyanshme dhe vetëpërmbajtja institucionale* (Levitsky & Ziblatt, 2018: 120-121). Në mes të vitit 1992, Fujimori në television deklaronte se “do shpërndajë Kongresin dhe nuk njeh Kushtetutën”. Sipas qasjes “transparente” të Fujimorit “... udhëheqësit kanë arsye të mjaftueshme strategjike për të gënjyer popullin e vet, si edhe vendet e tjera (Mearsheimer, 2011: 17).

Vepimet e Fujimorit për të përmirësuar ekonominë dhe për të eliminuar terrorizmin ishin kushte të nevojshme për të fituar mbështetje të madhe popullore për regjimin e tij neo-autoritar/neopopulist. Vetëm këta dy faktorë nuk shpjegojnë plotësisht arritjen e suksesit politik gjatë gjithë mandatit të tij. Regjimi i Fujimorit ishte i suksesshëm si rezultat i tre faktorëve shtesë si; kontrolli dhe manipulimi i medias, përdorimi i pushtetit për të synuar burimet fiskale në Peru drejt llojeve të caktuara të programeve sociale, shtyrja e qytetarëve peruanë të besojnë se ai ishte përgjegjës për mirëqenien dhe suksesin e tyre të pashmangshëm, dhe personaliteti i tij karizmatik neopopulist.

Fujimori përdori fuqinë e zyrës ekzekutive për të kontrolluar median, për të hartuar ligje dhe urdhra ekzekutivë dhe për të drejtuar burimet fiskale për të shtrembëruar në mënyrë specifike perceptimin e publikut për regjimin e tij (Correa, 2021: 3). Në rreth dy vjet pas

zgjedhjes së tij, Fujimori nga shpresë e peruanëve u shëndërrua autoritarizëm të theksuar, në tiran (Levitsky & Ziblatt, 2018: 91)! Duke kombinuar elementë të populizmit, strategjisë standarde politike dhe një imazhi si një i huaj, Fujimori, në harkun kohor prej katër muajsh, u nis nga një avokat i panjohur politik deri te lideri i popullit të Perusë, duke fituar zgjedhjet presidenciale (Beman, 2021: 15). Eksperienca e zgjedhjes së Fujimorit na rikujton se demagogët e zgjedhur me votë mund të fitojnë postet publike pa pasur plan për autokraci, por shkatërrimi i demokracisë mund të bëhet edhe pa plan.

**Autoritarizmi elektoral
dhe demokracia;
një model formal
i tranzicionit të regjimit.
Regjimi autoritar konkurrues.**

Shkencëtari politik Juan Linz, në një vepër me ndikim të vitit 1964, referuar regjimit autoritar në Spanjë, mbi librin “Modernism and Totalitarianism: Rethinking the Intellectual Sources of Nazism and Stalinism, 1945 to the Present” [Modernizmi dhe totalitarizmi: Rimendimi i burimeve intelektuale të nazizmit dhe stalinizmit, nga viti 1945 e në vijim] dhe autorit Richard Shorten i cili përkufizoi autoritarizmin si zotërimin e katër cilësive (Shoten, 2012: 67):

- Pluralizëm i kufizuar politik, i cili arrihet me kufizime mbi legjislativin, partitë politike dhe grupet e interesit.
- Legjitimiteti politik i bazuar në thirrjet ndaj emocioneve dhe identifikimin e regjimit si një e keqe e nevojshme për të luftuar “problemet shoqërore lehtësisht të dallueshme, të tilla si moszhvillimi apo kryengritja”.
- Mobilizimi minimal politik dhe shtypja e aktiviteteteve kundër regjimit.
- Kompetencat ekzekutive të keqpërcaktuara, shpesh të paqarta dhe

të zhvendosura, të përdorura për të zgjeruar pushtetin e ekzekutivi.

Një studim i vitit 2006 nga ekonomisti Alberto Abadie ka arritur në përfundimin se terrorizmi është më i zakonshëm në vendet me liri të ndërmjetme politike. Kombet me më pak terrorizëm janë kombet me dhe më pak demokratike dhe se “kalimet nga një regjim autoritar në një demokraci mund të shoqërohen me rritje të përkohshme të terrorizmit”. Në raportin Liria & Terrorizmi, sulmet më të shumta terroriste ndodhin në demokracitë e pjesshme dhe janë më të paktat në autokracitë strikte dhe demokracitë e plota” (Amichai, 2018: 111).

Autoritarizmi dhe demokracia nuk janë domosdoshmërisht të kundërta dhe mund të mendohen si pole në skajet e kundërta të një shkalle, kështu që është e mundur që disa demokraci të kenë elemente autoritare dhe që një sistem autoritar të ketë elemente demokratike (Frantz, 2018: 87–89). Sipas studimeve politike dhe të regjimeve dhe Lueders (2022) citohet se regjimet autoritare gjithashtu mund t’u përgjigjen pjesërisht ankesave të qytetarëve që nuk minojnë stabilitetin e regjimit (Lueders, 2022). Një demokraci joliberal, ose demokraci procedurale, dallohet nga demokracia liberale, ose demokracia substanciale, në atë që demokracive joliberele sepse u mungojnë tipare të tilla si sundimi i ligjit, mbrojtja për grupet e pakicave, një gjyqësor i pavarur dhe ndarja reale e pushteteve (Henriksen, 2007: 199).

Hulumtimet e ndryshme dhe të Bankës Botërore tregojnë se kombet demokratike kanë shumë më pak vrasje nga qeveria, vende të zhvilluara mesatarisht përpara aplikimit të politikave liberale demokratike. Banka Botërore sugjeron se institucionet politike janë jashtëzakonisht të rëndësishme në përcaktimin e përhapjes së korrupsionit dhe se sistemet parlamentare, stabiliteti politik dhe liria e shtypit janë të gjitha të lidhura me korrupsionin e ulët (Lederman, Loayza & Soares, 2021).

Një lloj i regjimit autoritar është regjimi autoritar konkurrues, një lloj regjimi civil ose “regjim hibrid” u shfaq gjatë dhe pas epokës së Luftës së Ftohtë. Në një regjim autoritar konkurrues, “institucionet formale demokratike ekzistojnë dhe shihen gjerësisht si mjetet kryesore për të fituar pushtetin, por ... abuzimi i shtetit nga pushtetarët i vendos ata në një avantazh të konsiderueshëm kundrejt kundërshtarëve të tyre” (Levitsky & Way, 2010a: 5–7).

Regjimet konkurruese autoritare ndryshojnë nga regjimet plotësisht autoritare në atë që zgjedhjet mbahen rregullisht, opozita mund të veprojë hapur pa rrezik të lartë internimi ose burgimi dhe “procedurat demokratike janë mjaftueshëm kuptimplote që grupet opozitare t’i marrin ato seriozisht si arena përmes të cilave konkurrojnë për pushtet. Regjimeve autoritare konkurruese u mungojnë një ose më shumë nga tre karakteristikat e demokracive si zgjedhjet e lira; mbrojtjen e lirive civile (d.m.th. lirinë e fjalës, shtypit dhe shoqatës) dhe një fushë loje të barabartë, për sa i përket aksesit në burime, media dhe rekursin ligjor (Levitsky & Way, 2010: 7–12).

Qeverisja demokratike do të funksionojë me dobi të plotë vetëm nëse të gjitha interesat që kanë të bëjnë me të janë praktikisht unanime jo vetëm për besnikërinë e tyre ndaj vendit, por edhe në besnikërinë ndaj parimeve strukturore të shoqërisë ekzistuese. Demokracia u jep mundësinë liderëve që, nëpërmjet demagogjisë, të fitojnë besimin e masave, domethënë pushtetin (Halevy, 2009: 75). Sa herë që janë vënë në diskutim këto parime dhe sa herë ato janë shtruar në mënyrë të tillë që e ndajnë kombin në dy kampe armiqësore, ajo që ka dalë e dëmtuar ka qenë demokracia. Ajo mund të pushojë së funksionuari në çastin që interesat dhe idealet janë ndërthurur në mënyrë të tillë sa njerëzit të refuzojnë kompromisin (Halevy, 2009: 112). Studimet mbi lidhësit dhe shoqëritë demokratike citojnë se jo të gjithë udhëheqësit e zgjedhur në mënyrë

demokratike mendojnë se popujt e tyre duhen të mashtrohen, sepse ata nuk mund t'i njohin me saktësi faktet e një situatë apo të kapin të vërtetën "... demokracitë janë në disavantazh kur krahasohen me vendet jo demokratike, sepse publiku i gjerë është pengesë për hartimin e një politike të jashtme të mençur dhe të guximshme" (Mearsheimer, 2011: 79).

Skandali i spiunazhit

Në vitin 1995, Fujimori u rizgjodh dhe fitoi një fitore dërrmuese. Shumica e votuesve përmendën fitoret e tij mbi kryengritësit e majtë dhe hiperinflacionin si arsye për t'i dhënë atij mbështetjen e tyre. Tranzicioni paqësor drejt demokracisë kërkon, zgjidhjen e problemit të institutizimit të pasigurisë, pa kërcënuar interesat e atyre që mund ta kthejnë sërisht mbrapsht procesin (Halevy, 2009: 155).

Por një numër në rritje i peruanëve filluan të shprehin shqetësimin se metodat e përdorura kundër kryengritjes po përdoren gjithashtu kundër kundërshtarëve demokratikë të presidentit. Kritikët e tij e akuzuan atë për përdorimin e shërbimit të inteligjencës të udhëhequr nga Montesinos për të frikësuar dhe spiunuar rivalët. Ata thanë se ai ushtroi kontroll të padrejtë mbi median dhe gjyqësorin dhe përdori burimet e qeverisë për të mbështetur fushatat e tij. Këto kritika u shtuan kur ai njoftoi se do të garonte për një mandat të tretë radhazi të paprecedentë. Demokracia ka rregulla të shkruara (kushtetuese) dhe arbitra (gjykatat). Këto rregulla ose norma shërbejnë si rojtarë të butë të demokracisë (Levitsky & Ziblatt, 2018: 120). Edhe pse ai fitoi zgjedhjet e majit 2000, mes akuzave të mëtejshme për manipulim të votave, mandati i tretë i vlerësuar filloi fillimin e rënies së tij. Pas shpërthimit të skandalit të Montesinos, opozita fitoi kontrollin e Kongresit për herë të parë në tetë vjet dhe shkarkoi zotin Fujimori me arsyetimin e "paaftësisë morale".

Burimi i pushtetit për Neo-Populizmin dhe Neo-Autoritarizmin. Autoritarizmi konkurrues

Peruanët u mashtruan duke besuar se vetë-grushti ishte për përmirësimin e vendit dhe për popullin, kur në fakt grushti i shtetit shërbeu vetëm për t'i dhënë Fujimorit pushtet autokratik dhe për të rritur popullaritetin e tij në nivele më të larta kur përpjekjet e tij nuk kishin të bënin me ekonominë dhe terrorizmin. Sondazhet e opinionit pas grushtit të shtetit treguan se përpjekjet e Fujimorit funksionuan, edhe më shumë sesa të kishte një ekonomi në përmirësim (Arce & Roberts, 1998). Tendenca për të kontrolluar dhe manipuluar median është karakteristikë e një regjimi autoritar konkurrues. Në fund, ajo shërbeu si një nga taktikat përcaktuese të trashëgimisë së Fujimorit. Duke përdorur një grusht shteti presidencial, Fujimori portretizoi politikën e Amerikës Latine të viteve 1990 si jo të ndryshme nga tendencat e epokave të mëparshme, pasi përmbysja e qeverisë merr shumë forma dhe ka sukses përmes procedurave ligjore emergjente, si dhe luftës së armatosur (Beman, 2021: 16).

Ai përdori fuqinë e zyrës ekzekutive për të kontrolluar median, për të hartuar ligje dhe urdhra ekzekutivë dhe për të drejtuar burimet fiskale për të shtrembëruar në mënyrë specifike perceptimin e publikut për regjimin e tij. Studimet politike mbi elitat theksojnë se "*Lidershipi është një marrëdhënie pushtet ndërmjet udhëheqësve dhe pasuesit*" (Joseph, 2008: 85). Tre janë strategjitë që përdorin autoritarianët e zgjedhur kur janë në kërkim të konsolidimit të pushtetit dhe synojnë kthimin e fushës së lojës kundër kundërshtarëve: kapjen e arbitrave, anashkalimin e aktorëve dhe ndryshimin e rregullave (Levitsky & Ziblatt, 2018: 201).

Autoritarizmi konkurrues

Levitsky dhe Way (2010b) hedhin dritë mbi metodat e Fujimorit. Levitsky dhe Way e zhvilluan këtë term për të përshkruar një

situatë në të cilën një lider i shoqërisë e paraqet veten si demokrat, por në realitet përdor mashtrime, shkëlqje të lirive civile dhe abuzim të burimeve shtetërore dhe mediatike për të heshtur opozitën dhe për të mbështetur më tej kandidaturën e tij. Në fund të fundit, demokraci të tilla nuk janë asgjë tjetër veçse demokratike, pasi ato bazohen në metoda mashtruese që e bëjnë të vështirë konkurrimin me to. Pa një fushë loje të ndershme, konkurrentët e Fujimorit u përpoqën të bindin çdo peruan tjetër se ata do të ishin të denjë për Zyrën e Presidentit, gjë që i mundësoi Fujimorit të vazhdonte dhe të lulëzonte në këtë stil lidhshipi konkurrues, autoritar (Correa, 2021: 4-5).

Neo-populizmi

Populizmi synon të bazojë vendimet në opinionin e përgjithshëm të qytetarëve në krahasim me çështjet e drejtpërdrejta, me synimin drejt favorizimit të personit të zakonshëm në krahasim me dëshirat e elitave të perceptuara të një organizate. Kur konceptet e neo-populizmit shoqërohen me autoritarizëm konkurrues, ai ndihmon në shpjegimin e veprimeve të ndërmarra nga Fujimori dhe në përpjekjen e tij për të fituar mbështetje në shkallë të gjerë. Referuar autorit Kurt Weyland mbi neo-populizmin, mbështetja dhe karakterizimin në një situatë në të cilën liderët u drejtohen masave (shpesh të përjashtuar nga pjesëmarrja politike), në një mënyrë personale dhe që anashkalojnë organizatat e krijuara si partitë politike dhe institucionet. Kjo qasje ndihmon për të ndërtuar mbështetje mbi axhendën e liderit (Weyland, 2006: 13-38). Me këto koncepte si sfond, kjo tezë synon të avancojë kërkimet ekzistuese dhe dëshmitë empirike rreth faktorëve që kontribuan në suksesin e perceptuar të regjimit Fujimori.

Qasja neo-populiste dhe të kuptuarit e thellë në regjimin e Fujimorit, karizma e tij, ka rëndësi sepse ofron një kontekst mbi qeveritë që nga të gjitha pamjet e jashtme fillojnë si demokratike dhe më pas me

kalimin e kohës kthehen në regjime thuajse autoritare. Tranzicione të tilla nuk janë produkt i një grushti shteti por përkundrazi mashtrojnë popullatën dhe komunitetin më të gjerë ndërkombëtar. Karizma është e panvarur dhe i vendos vetë kufizimet e saj. Bartësi i saj merr përsipër detyrimet për të cilat është destinuar dhe u kërkon të tjerëve t'i binden dhe ta ndjekin për shkak të misionit që ka marrë përsipër (Halevy, 2009: 93).

Shtetet autoritare mund të përmbajnë institucione nominalisht demokratike si partitë politike, legjislaturat dhe zgjedhjet, të cilat menaxhohen për të rrënjësuar sundimin autoritar dhe mund të shfaqin zgjedhje mashtruese dhe jo konkurruese (Svolik, 2012). Kjo analizë e të gjitha dokumenteve kryesore të lidhura me median, duke përfshirë fjalimet, konferencat për shtyp televiziv, transmetimet në radio dhe televizion, raportet zyrtare nga Ambasada e SHBA-së në Peru, Ligjet e Dekreteve dhe sondazhet e opinionit publik në dritën e vetë-grushtit të 1992 tregon të njëjtën gjë.

Temat e trajtuara nga autorë të ndryshëm mbi lidhshipin sygjerojnë se “udhëheqësit e zgjedhur janë në gjendje të krijojnë përparësi vendimtare dhe të përhershme ndaj kundërshtarëve të tyre, ...dhe devijimi drejt autoritarizmit jo gjithmonë shoqërohet me rënien e kampionave të alarmit” (Levitsky & Ziblatt, 2018: 110).

- Një korrelacion ndërmjet kontrollit të medias dhe rritjes së mbështetjes popullore. Sa më shumë që Fujimori rregullonte median, aq më e lartë rritej mbështetja e tij popullore.
- Një përpjekje strategjike për të dominuar narrativën për të maskuar veprimet - të cilat u kataloguan si negative - në një pozitive.
- Përdorimi i programeve sociale të synuara dhe strategjive populiste për të arritur një nivel mbështetjeje që kundërshtonte performancën e tij me ekonominë dhe terrorizmin.

Ai gjithashtu konfirmon censurën e imponuar nga regjimi i Fujimorit dhe se homogjeniteti në media duhej të projektohej me qëllimin për të kufizuar çdo informacion të paautorizuar nga vetë Fujimori. Si i tillë, që nga nata e grushtit të shtetit, peruanët kanë dëgjuar vetëm një anë të historisë: anën e Fujimorit. Për më shumë se 24 orë, popullata mori një sërë mesazhesh koncize që përfshinin fjalë pozitive, “rindërtim i qeverisë”, “ristrukturim i kongresit”, “riorganizim i gjyqësorit” në të gjitha format e medias dhe nga i vetmi zë i lejuar për të folur: qeveria. Fujimori e cilësoi grushtin e shtetit si një veprim që ishte jo vetëm i nevojshëm për të mirën e kombit, por edhe një veprim demokratik. Asnjë nga mediat nuk shtypi apo shpërndau ndonjë kritikë apo kontradiktë ndaj këtyre masave për 48 orët e ardhshme. Në të vërtetë, justifikimet e Fujimorit për grushtin e shtetit u përsëritën vazhdimisht nga të gjitha format e medias. Ky manipulim i medias la një përshtypje të madhe te njerëzit dhe më pas e ngriti popullaritetin e Fujimorit në nivele shumë përtej përmirësimit të ekonomisë dhe reduktimit të terrorizmit. Sipas Fukuyamas “gënjeshtrat e zyrtarëve të qeverisë ndaj njëri-tjetrit apo ndaj popullit mund ta gjymtojnë procesin e hartimit të politikave të shtetit, qoftë ai në demokraci ose jo demokraci” (Fukuyama, 1995: 108).

Historikisht, funksioni kryesor i regjimeve fashiste ka qenë mbajtja e kombit në një gjendje të vazhdueshme gatishmërie për luftë. Fashistët vëzhguan se si mobilizimet e shpejta dhe masive ushtarake gjatë Luftës së Parë Botërore mjegulluan linjat midis roleve të civilëve dhe luftëtarëve. Duke u mbështetur në ato përvoja, sundimtarët fashistë përpiqen të krijojnë një kulturë të tërbuar nacionaliste të “qytetësisë ushtarake”, në të cilën të gjithë qytetarët janë të gatshëm dhe të përgatitur të marrin përsipër disa detyra ushtarake gjatë kohërave të luftës, duke përfshirë luftimet aktuale. Për më tepër,

fashistët e shohin demokracinë dhe procesin zgjedhor si një pengesë të vjetëruar dhe të panevojshme për ruajtjen e gatishmërisë së vazhdueshme ushtarake. Ata gjithashtu e konsiderojnë një shtet totalitar, njëpartiak si çelësin për përgatitjen e kombit për luftë dhe vështirësitë ekonomike dhe sociale që rrjedhin prej saj. Zgjedhja e një presidenti me votën popullore do të ishte shumë e lehtë të fitohej nga ata që janë të aftë të luajnë me frikën dhe injorancën e njerëzve, të cilët me tu zgjedhur mund të shndërrohen në tiranë (Levitsky & Ziblatt, 2018: 52).

Sot, pak qeveri e përshkruajnë veten publikisht si fashiste. Në vend të kësaj, etiketa përdoret më shpesh në mënyrë poshtëruese nga ata që kritikojnë qeveritë ose liderët e veçantë. Termi “neofashist”, për shembull, përshkruan qeveritë ose individët që përkrahin ideologji politike radikale, të ekstremit të djathtë, të ngjashme me ato të shteteve fashiste të Luftës së Dytë Botërore. Referuar edhe autorë të tjerë, Peruja e viteve 1990 – 2000 ishte shtet autoritar me institucione nominalisht demokratike dhe të cilat menaxhohen për të rrënjësuar sundimin autoritar. Ky shtet dhe shtete të tjera të Amerikës Latine e në mbarë globin mund të shfaqin zgjedhje mashtruese dhe jo konkurruese, por që nga viti 2000, diktaturat kanë më shumë gjasa të fillojnë përmes kthimit demokratik, ku një udhëheqës i zgjedhur në mënyrë demokratike vendos një regjim autoritar. Mënyrat e tranzicionit dhe lindja e demokracisë në Amerikën Latine dhe Europën Lindore “e përbashkëta e këtyre rasteve është humbja e kontrollit nga elita dhe paaftësia e organizatave masive për të imponuar një strategji të re koherente për arësye të brendshme dhe të jashtme” (Halevy, 2009: 207-215).

Përfundime

Epoka e Fujimorit do të hyjë në historinë e Perusë si një periudhë e shënuar nga përfitimet ekonomike dhe fundi i

akteve të terrorizmit. Të dyja këto synime u arritën nga administrata Fujimori, dhe ato janë të admirueshme dhe të lavdëruara nga shkencëtarët politikë dhe studiuesit e Amerikës Latine. Përdorimi i grushtit të shtetit presidencial dhe portretizimi i politikës së viteve 1990 në Amerikën Latine si jo të ndryshme nga tendencat e epokave të mëparshme, pasi përmbysja e qeverisë merr shumë forma dhe ka sukses përmes procedurave ligjore emergjente e luftës së armatosur.

Pavarësisht nga ky perceptim, kjo tezë synonte të zbulonte shumë kompleksitete të tjera që përcaktuan mandatin e Fujimorit si president i Perusë. Presidenca e tij u ndikua shumë nga epoka në të cilën ai shërbeu, duke përfshirë qeverinë që trashëgoi nga paraardhësit e tij dhe komunitetin më të madh të Amerikës Latine në të cilën ekzistonte Peruja. Fujimori mori presidencën në një kohë kur populli peruan ishte gati për diçka ndryshe, gati për të përqaftuar një njeri që dukej dhe nga jashtë vepronte më shumë si një person i zakonshëm laik dhe jo një figurë elitare presidenciale. Karakteri i tij karizmatik dhe rreshtimi i vazhdueshëm si “një nga njerëzit” i ndihmuan zgjedhësit e tij të rezononin me të, t’i besonin dhe të besonin në të. Me këtë kontekst mjedisor dhe sfond politik, së bashku me karakterin e tij të gjallë, Fujimori bëri gjëra që nuk do të ishin të pranueshme dhe as që do të kishin ndodhur nën ndonjë president tjetër. Kombinimi nga Fujimori i veprimeve për të përmirësuar ekonominë dhe eliminuar terrorizmin ishin kushte të nevojshme për të fituar mbështetje të madhe popullore për regjimin e tij neo-autoritar/neopopulist, por aplikimi edhe i faktorëve të tjerë shtesë si kontrolli dhe manipulimi i medias, aplikimi i pushtetit duke synuar burimet fiskale drejt llojeve të caktuara të programeve sociale dhe qasja karizmatike neopopuliste i siguroj ngritje të shpejtë dhe mbështetje të gjerë në shoqërinë peruane. Fujimori përdori fuqinë e zyrës ekzekutive për të kontrolluar

median, për të hartuar ligje dhe urdhra ekzekutive dhe për të drejtuar burimet fiskale për të shtrembëruar në mënyrë specifike perceptimin e publikut për regjimin e tij.

Sot shkencëtarët politikë duhet të sfidohen për të zbërthyer më tej presidencën e Fujimorit, për të parë përtej përfitimeve ekonomike dhe eliminimin e veprimeve terroriste si kriterin e vetëm për matjen e rezultateve të presidencës së Fujimorit. Studiuesit e ardhshëm duhet të fitojnë një vlerësim më të madh për temat që u shfaqën gjatë analizës cilësore të dokumenteve në këtë tezë.

Temat specifike të theksuara në këtë tezë tregojnë se Fujimori ishte një njeri kompleks, i cili në mënyrë strategjike u përpoq të kontrollonte dhe manipulonte mediat, të lëkundte mendjet e publikut peruan dhe të përfitonte nga aspiratat e tij politike. Aftësia e tij për të ndërmarrë këto veprime ka të ngjarë të ketë një ndikim të madh në përfitimet ekonomike që ai arriti. Manipulimi, kontrolli dhe rryshfeti që ndodhën me median ka të ngjarë të ketë pasur efekte të tjera në suksesin e tij në uljen e terrorizmit; në të vërtetë, njëra nuk mund të ekzistonte pa tjetrën.

Analiza në këtë tezë të dekreteve dhe ligjeve të ditës tregoi se si Fujimori shpenzoi burimet federale për programet sociale, jo vetëm për të kufizuar shpenzimet lokale për programe të tilla, por edhe për të avancuar pozicionin e tij dhe për të marrë meritat për ndihmën e popullit, duke ndërtuar kështu mbështetjen e tij, si president. Këto akte të rënda për të drejtuar burimet fiskale gjatë kohërave dhe zonave gjeografike ku ai vendosi se ishte e nevojshme, ishin vetë-shërbyese dhe duhet të përfshihen gjithashtu në përshkrimet historike të presidencës së tij. Në një vend që ka luftuar me varfërinë për dekada, burimet fiskale për programet sociale janë të një rëndësie kritike dhe Fujimori përdori në avantazhin e tij për të ndërtuar një bazë pushteti që i mundësoi atij të drejtonte në mënyrë të fshehtë vendin të

besonte se ishte “nga njerëzit, për popullin” presidenti demokrat. Në fakt, ai ishte më shumë një diktator i fshehtë, i cili përparonte mbi gjithçka tjetër interesat e tij personale.

Vetëm nëpërmjet një shqyrtimi dhe analize të thellë të dokumentit historik, ne jemi në gjendje të vlerësojmë plotësisht nuancat komplekse që përcaktuan presidencën e Fujimori. Nëpërmjet këtij niveli të zgjeruar të mirëkuptimit dhe ndërgjegjësimit, ne mund të jemi në gjendje të sigurojmë që figurat politike të zgjedhura në të ardhmen të jenë të vërteta ndaj premtimeve të tyre të fushatës, të qeverisin mbi parimet demokratike dhe t’u shërbejnë në mënyrë të përshtatshme zgjedhësve të

tyre me integritetin dhe ndershmerinë që është e denjë për degën ekzekutive të qeveria.

Si konkluzion mund të theksojmë se Fujimori në rreth dy vjet pas zgjedhjes së tij, u transformua nga shpresë e peruanëve në autoritarizëm të theksuar, në tiran. Elementë të populizmit e të kombinuar me strategjitë standarde politike dhe imazhin e një të huaji, Fujimori, në harkun kohor prej katër muajsh nga një avokat i panjohur politik, fitoi zgjedhjet presidenciale dhe përfundoi si lider i popullit të Perusë. Eksperiencia e zgjedhjes së tij na rikujton se demagogët e zgjedhur me votë mund të fitojnë postet publike pa pasur plan për autokraci, por shkatërrimi i demokracisë mund të bëhet edhe pa plan.

REFERENCAT

- Amichai, Magen. (2018). “Fighting Terrorism: The Democracy Advantage”, *Journal of Democracy*, Johns Hopkins University Press, Volume 29, Number 1, January 2018, 10.1353/jod.2018.0009
- Arce, M., & Roberts, K. M. (1998). “Neoliberalism and lower-class voting behavior in Peru”, *Comparative Political Studies*, 31(2), doi: 10.1177/0010414098031002004.
- Beman-Cavallaro, Andrew. (2021). “Election Campaigns, Counterinsurgency, and Privatization in Fujimori’s Peru: Examples of Regional, Public, and Control Historiographies,” *Graduate Review*: Vol. 1: Iss. 1, Article 4. Available at: <https://openspaces.unk.edu/grad-review/voll/iss1/4>
- Correa, Javier. (2021). “A Thesis in the Field of International Relations for the Degree of Master of Liberal Arts in Extension Studies”, Harvard University, March.
- Frantz, Erica. (2018). “Authoritarian Politics: Trends and Debates”, *Politics and Governance*, 6 (2). doi:10.17645/pag.v6i2.1498.
- Fukuyama, Francis. (1995). *Trust: The Social Virtues and Creation of Prosperity*, New York: Free Press.
- Halevy E. E. (2009). *Klasat & Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim*, Tiranë: Botimet Dudaj
- Henriksen, Th. H. (2007). *American Power after the Berlin Wall*, Palgrave Macmillan
- Joseph S. Nye JR. (2008). *The Powers to LEAD*, Oxford University Press.
- Lederman, Daniel and Loayza, Norman and Soares, Rodrigo R. (2016) Accountability and Corruption: Political Institutions Matter (November 2001). Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=632777> (parë, më 31 tetor 2024).
- Lederman, Daniel; Loayza, Norman and Soares, Rodrigo R. (2021). “Accountability and Corruption: Political Institutions Matter” Archived 2021-01-19 at the Wayback Machine, *World Bank Policy Research Working Paper No. 2708* (November 2001).
- Levitsky, S & Way, L. (2010a), “Elections Without Democracy - The Rise of Competitive Authoritarianism” *Journal of Democracy* Volume 13, Number 2 April 2012
- Levitsky, S & Ziblatt, D. (2018). *Si vdesin demokracitë*, Prishtinë: Pema
- Levitsky, S., & Way, L. (2010b), “Competitive authoritarianism: Hybrid regimes after the cold war”. Cambridge: Cambridge University Press.

- Online ISBN:9780511781353, DOI: <https://doi.org/10.1017/CBO9780511781353>
- Lueders, Hans. (2022). "Electoral Responsiveness in Closed Autocracies: Evidence from Petitions in the former German Democratic Republic", *American Political Science Review*, 116 (3); doi:10.1017/S0003055421001386
- Mearsheimer, John J. (2011). *Përse Gënjejnë Udhëheqësit*, Tiranë: AHS
- Pilan, Adrienne. (2019). "Alberto Fujimori", *Salem Press Biographical Encyclopedia*, <http://db20.linccweb.org/login?url=http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&db=ers&AN=90669572&site=eds-live> (parë më 24.9.2024).
- Shorten, Richard. (2012). *Modernism and Totalitarianism: Rethinking the Intellectual Sources of Nazism and Stalinism, 1945 to the Present* Archived 2020-01-09 at the Wayback Machine (Palgrave Macmillan).
- Svolik, Milan W. (2012). *The Politics of Authoritarian Rule*. Cambridge University Press. Archived from the original on 21 October 2019. Retrieved 21 October 2019.
- Weyland, K. (2006). The rise and decline of fujimori's neopopulist leadership. In Carrion, J. (Ed.), *The Fujimori legacy: The rise of electoral authoritarianism in Peru*. University Park, PA: Pennsylvania State University Press.

ABSTRACT

Alberto Fujimori in the early 1990s, from a university professor created the party, used the crises of society to become president and managed to win by relying on ordinary Peruvians. He represented the old and influential politicians but was deaf to the concerns of the common people. With a populist discourse, it became an alternative to change Peru from the current situation and lead it to a better destiny. Confrontation with the old political elite, traditional power concerns and being an outsider to Peruvian politics did not help him consolidate power. Fujimori lacked the experience of legislative policies and the patience to wait, preferred to govern alone instead of negotiating co-governance, and bypassed Congress, governed by executive decrees and with little commitment to democratic institutions. He used social programs and presented himself as a traditional democratic leader. His ability, personality and character served to advance his political goals by undermining democracy and embracing neo-authoritarian approaches to leadership. Fujimori for two years turned from the hope of the Peruvians into pronounced authoritarianism and tyrannical features. He recalls that demagogues elected by vote can win public positions without having a plan for autocracy, but the destruction of democracy can also be done without a plan. The concentration of power, the populist approach and the weakness of political parties suggest that the tension between democratic and autocratic elements could never be properly reconciled. The methodology of the paper is based on empirical and analytical data, it reaches conclusions that can help us in the field of studying political sciences and international relations.

Keywords: *Fujimori; Peruvian Society; Political Alternative; Institutions; Authoritarianism; Democracy.*

SFIDAT E LIDERSHIPIT NË SHKOLLAT RURALE

Liri JOLLJA

Shkolla 9-vjeçare Vadarhtë Sukth, Durrës

E-mail: jolljaliri@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Lidershipi është forma dhe metodologjia e funksionimit të shkollave që synojnë ndryshimin dhe transformimin demokratik të tyre. Centralizimi, përfshirja e grupit të interesit dhe angazhimi i gjithë stafit, punonjësve, nxënësve dhe komunitetit është prioritet i funksionimit të shkollës sot. Ky punim sjell përvojën e funksionimit të një shkolle rurale në formën e një studimi rasti. Punimi bazohet në metoda cilësore duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës së fushës, konsultimit të dokumentacionit zyrtar mbi drejtimin e shkollës si dhe në intervistat e mësuesve, nxënësve drejtuesve dhe prindërve. Punimi sjell një pamje të nivelit të zbatimit të lidërshiptit në përcaktimin e vizionit dhe misionit të shkollës, vendimmarrjen si dhe në veprimtaritë e përdorshme të shkollës. Në mënyrë analitike nëpërmjet metanalizës, punimi evidenton një sërë faktorësh dhe barrierash që has drejtimi i shkollës mbi bazat dhe parimet e lidërshiptit shkollor. Problemi më sfidues në shkollat rurale është përballja me mentalitetin tradicional. Drejtorët autoritarë duket se dëshirohen edhe nga opinioni i grupit të interesit. Mësuesit, nxënësit dhe prindërit shpesh krijojnë konflikte dhe përfshihen në situata të pakëndshme, pikërisht nga perceptimet e ndryshme që kanë për modelin e shkollës efektive, marrjen e përgjegjësisë dhe zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë shkollën. Studimi provon gjithashtu se përcaktimi i vizionit dhe strukturimi i planeve afatmesme dhe atyre vjetore të shkollës nuk vjen si rezultat i diskutimeve dhe studimeve konstruktiviste, po merren apriori. Kjo qasje krijon shkëputje dhe mospërputhje të drejtimit të shkollës sipas një strategjie efektive. Punimi jep disa rekomandime për drejtuesit, mësuesit dhe nxënësit e shkollave.

Fjalë kyç: lidërshipt, shkollë rurale, drejtor, mësues, vizion, komunitet

Liri JOLLJA ka kryer studimet në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, në degën Gjuhe-letërsi në vitin 2011. Në vitin 2013 ka filluar punë si mësuese e gjuhë-letërsisë në shkollën 9-vjeçare "Vadarhtë" Sukth, Durrës. Në vitin 2013-2015 vijoi studimet në Universitetin Aleksander Moisiu Durrës në Fakultetin e Edukimit, ku është diplomuar në Master i Shkencave në "Menaxhim dhe Supervizim i Institucioneve Arsimore". Në vitin 2022 është certifikuar për drejtimin e institucioneve të sistemit parauniversitar nga Shkolla e Drejtoresh dhe prej këtij viti është zëvendës drejtore në të njëjtën shkolle. Ka marrë pjesë në disa konferenca ndërkombëtare brenda dhe jashtë Shqipërisë. Është gjithashtu pjesëmarrëse aktive në trajnime të ndryshme në mësuesi, në rrjetet profesionale dhe aktivitete të ndryshme. Në vitin 2023-2024 ajo ka fituar kategorinë e dytë si mësues specialiste me rezultatin më të lartë.

Ndryshimi i shkollës sot trajtohet me prioritet, pasi konsiderohet si domosdoshmëri e ofrimit të arsimit në shërbim të zhvillimit aktual të shoqërisë. Mirëpo përballja me sfidat e ndryshimet po provon që procesi i tij ecën me ngadalë pa reflektuar rezultatet e pritshme. Kjo po ndodh më dukshëm në shkollat rurale. Studiuesit shtrojnë pyetjen pse ndryshimi përparon me kaq ngadalë, ndërkohë që vlerësohet pozitivisht nga të gjithë aktorët e arsimit? (Young et al., 2023). Në pamjen e parë perceptohen se drejtuesit e shkollave dhe mësuesit e zonave rurale nuk kanë kapacitete apo nuk e pranojnë ndryshimin. Studimet kanë provuar se koha fizike është më e kufizuar se sa koha e mësuesve në zonat urbane edhe për shkak të udhëtimit për në banesat e tyre. Po kështu rezistenca e komunitetit është më e fortë dhe ndikimet e modeleve tradicionale janë më të besueshme (Sumintono, et al., 2019).

Ndryshimi i shkollës nuk mund të jetë ndryshim sa për formë (Albu, 2013). Transformimi i një shkolle është një sfidë që kërkon kohë dhe guxim për t'u përballur me barrierat dhe sfidat frenuese (Mincu, 2022). Drejtorët ndjejnë presionin e reformës arsimore nga njëra anë dhe rezistencën e mentaliteteve të ngulitur në modelet tradicionale të zhvillimit të shkollës. Po kështu dhe mësuesit edhe pse konsiderohen si forca e ndryshimit nuk e shohin me aq interes sa drejtuesit (Fullan, 2001).

Mësuesit e kërkojnë suksesin të rezultatet e të nxënës, të normaliteti i zhvillimit të mësimi larg ngjarjeve negative apo konfliktet me prindërit dhe drejtuesit e shkollave. Njëkohësisht mësuesit janë të mbingarkuar. Programet, përgatitja mësimore, dokumentacioni shkollor dhe ngarkesat e tjera ditore i përqendron mësuesit për më së shumti të veprimtaritë ditore sesa të vizioni, planifikimet afatmesëm dhe ato afatgjata. Në këtë mënyrë jo të gjithë mësuesit e duan ndryshimin dhe jo të gjithë besojnë

në pritshmëritë e ndryshimit. Ndryshimi perceptohet nga mësuesit si vizion i një politike arsimore e diktuar nga lart (Hill, Mellon, Laker & Goddard, 2017). Mirëpo angazhimi i mësuesve në hartimin e vizionit të shkollës është shumë i rëndësishëm. Siç theksojnë studiuesit në realizimin e vizionit të shkollës, modeli kulturor, niveli i përgjegjshmërisë qytetare dhe profesionale është përcaktues në këtë proces. Po dhe drejtuesit e shkollave, në rastet kur përballja brenda shkollës është e ashpër dhe prioritetet emergjente tejkalojnë politikatat e ndryshimit, sipas studimeve, ata shpesh i injorojnë udhëzimet e ekspertëve të ndryshimeve (McHenry, 2009).

Në këtë proces ndryshimi: mësuesit, nxënësit, prindërit, punonjësit dhe komuniteti përfshihen intensivisht e me përgjegjshmëri. Të gjithë aktorët duhen të informohen, trajnohen dhe të kontribuojnë bashkërisht për të marrë role të përgjegjësi (Albu, 2013). Shoqëria e ndryshimeve ka nevojë veçanërisht për një individ proaktiv, krijues, iniciator, guximtar, me gjykim të pjekur që vendos dhe nuk vepron ashtu siç i pëlqen apo për të kënaqur egon e tij mediokre (Sumintono, et al. 2019). Në këtë vizion, qëllimi themelor i shkollës nuk do të ishte integrimi në shoqëri, por edukimi i njeriut të hapur ndaj ndryshimit (Albu, 2013). Ndryshimet e brendshme kërkojnë një strategji të miratuar nga stafi në përshtatje dhe individualitetin e çdo shkolle (Alamassi et al., 2015).

Drejtorët e shkollave rurale duhet ta pranojnë se ndryshimi është një sfidë jo e lehtë për ta dhe shkollën e tyre, prandaj duhet të jenë të përgatitur për marrjen e vendimeve të vështira dhe përballjen me pasojat e tyre. Mosbesimi i njerëzve është krijuar nga zhgënjimet e pësuarat gjatë viteve në mënyrën e menaxhimit të shkollës. Drejtori para se të udhëheqë procesin e ndryshimit duhet të tregojë se ai është protagonist i ndryshimit, jo delegues i tij të tjerët (Hill, Mellon, Laker & Goddard, 2017).

Drejtorët efektivë ofrojnë mundësi lidërshepi që janë në përputhje me vizionin dhe misionin e shkollës, identifikojnë mundësitë e lidërshepit që mësuesit mund t'i menaxhojnë në mënyrë efektive dhe ofrojnë një rrjet sigurie dhe mbështetje, ndërsa mësuesit angazhohen në praktikën e lidërshepit në mënyrë që ata të rriten dhe zgjerojnë aftësitë e tyre (Ayda, Kaşot, & Güneyli, 2018). Sipas studimeve, drejtorët besojnë se ata mund t'i kapërcejnë barrierat e jashtme nëpërmjet bashkëpunimit, komunikimit dhe marrëdhënieve interaktive me mësuesit, punonjësit arsimorë, prindërit, nxënësit dhe gjithë aktorët që ndikojnë në performancën e shkollës. Ata, sipas studimeve shqetësohen dhe gjykojnë se përballen me mungesat e mbështetjes së zyrave arsimore qendrore, e kapërcimit të mentaliteteve kulturore, mungesat e qëndrueshmërisë dhe gatishmërisë aktive të stafit në procesin e ndryshimit për shkak edhe të mungesës së përvojës dhe motivimit të tyre. Barrierat mund të shkaktohen nga faktorë të jashtëm edhe të brendshëm, që burojnë nga praktikatat joefektive të menaxhimit të ndjekura nga drejtori i shkollës (Alamassi et al., 2015). Këto barrierat shfaqen në funksionimin e shkollës të ndërthurura dhe ndikuese të njëra-tjetra. Prandaj reformat arsimore, edhe pse strukturohen mbi standarde, mbështesin zhvillimin e tyre brenda kontekstit shkollor. Për këtë arsye rekomandohet që drejtuesit e shkollave duhet të projektojnë e të ndjekin një plan menaxhimi të përshtatshëm të kohës së punës së mësuesit dhe hartimit të programeve për përmirësimin e shkollës, në vend të kërkimit të vazhdueshëm të modeleve dhe praktikave të publikuara (Hoque & Raya, 2009).

Reformimi i shkollës në kuadrin e ndryshimit reflektohet në kornizën kurrikulare dhe udhëzimet e politikave arsimore. Në brendësinë e tyre ato orientojnë funksionimin e shkollës sipas parimeve konstruktiviste, që në thelb synojnë decentralizimin e institucionit shkollor

dhe funksionimin e vendimmarrjes me pjesëmarrje (Antonakis & House, 2014). Gjithsesi, roli në angazhimin aktiv të individit, përpjekjet individuale dhe kolektive të mësuesve janë thelbësore për të përmirësuar të nxënësit dhe formimin e nxënësve (Varthana, 2023).

Hulumtimet kanë provuar se kur drejtorët nuk i fuqizojnë kapacitetet e brendshme të mësuesve në shkollë, shkolla nuk mund të ketë suksesin e pritur. Mirëpo, studime të ndryshme provojnë se ritmi global i përshpejtimit të nxituar konfuzohet nga përfshirja dhe angazhimi në një larmi ndryshimesh të pastuduara. Kjo mënyrë e zhvillimit të procesit të ndryshimit e kthen në qëllim në vetvete duke humbur optikën e domosdoshmërisë, rëndësisë dhe vlerës së ndryshimit. Procesi i ndryshimit në shkollë nuk mund të ndodhë pa përfshirë edhe komunitetin e nxënësve, kur është e mundur. Nisur nga paradigma e zhvillimit të procesit me në qendër nxënësin, kërkesa e praktikave menaxhuese i japin rëndësi socializimit të nxënësve. Në fakt, prej studimeve kuptojmë se në përgjithësi drejtorët e shohin si të dobishme përfshirjen dhe pjesëmarrjen e nxënësve në administrimin e shkollës (Bommer & Rich & Rubin, 2005).

Mulford, thekson se lidërshepi ndikon në mënyrën se si nxënësit i perceptojnë metodat dhe modelet e organizimit të mësimit nga ana e mësuesve dhe si ata i mbështetin nxënësit e tyre. Po kështu, nxënësit janë të ndjeshëm ndaj qëndrimit të drejtuesve. Ata e duan përfshirjen aktive të tyre në vendimmarrjen që lidhen me çështjet që prekin dhe ndikojnë në jetën e tyre në shkollë (Mulford, 2003).

Metodologjia

Ky punim është bazuar në kërkimin cilësor. Shqyrtimi i literaturës ka paraprirë çështjet dhe pyetjet e intervistave të kryera me grupin e interesit në shkollë. Punimi ka vlerë kryesisht për shkollën ku u krye

hulumtimi, shkolla 9-vjecare “Vadardhe”. Drejtuesit, mësuesit, prindërit dhe nxënësit u pyetën me pyetje të të njëjtit kontekst.

Pyetja e parë

- për drejtuesit: cili është stili i drejtimit të drejtorit që aplikoni gjatë procesit të shkollës?
- për mësuesit, prindërit dhe drejtuesit: cili tip i drejtuesit është më funksional në shkollën tone?

Pyetja e dytë

- për drejtuesit: në ç’nivel është bashkëpunimi pedagogjik midis mësuesve dhe drejtorit të shkollës?
- për mësuesit, prindërit dhe drejtuesit: në ç’nivel jeni të përfshirë dhe ju jepet mundësia të bashkëpunoni me njëri – tjetrin dhe me drejtorin e shkollës?

Pyetja e tretë

- për drejtuesit: në ç’nivel ndikon vizioni i shkollës në veprimtaritë e saj dhe si e realizoni këtë?
- për mësuesit, prindërit dhe drejtuesit: në ç’nivel ju ndihmon vizioni i shkollës për të kuptuar veprimtarinë dhe funksionimin e shkollës?

Intervistat u kryen me mësuesit që drejtojnë departamentet sipas organizimit. Intervistat me prindërit u kryen me kryetarët e këshillave të prindërve. Me mësuesit sipas niveleve u zhvilluan fokus grupe.

Rezultatet

Shkolla 9-vjecare “Vadardhe” ndodhet në adresën Lagja 3 (Vadardhë) Sukth, Durrës. Ajo është hapur në vitin 1954 në një godinë dykatëshe. Shkolla është shembur pas tërmetit të vitit 2019 dhe ende nuk ka nisur ndërtimi i saj, prandaj mësimi zhvillohet pasdite në një shkollë tjetër në Sukth. Fëmijët për të ndjekur mësimin në këtë shkollë transportohen me autobus. Kjo është një sfidë për drejtuesit,

mësuesit dhe komunitetin. Mësuesit për më shumë se katër vite shoqërojnë nxënësit në autobus në ardhjen dhe largimin e tyre nga shkolla.

Sfidë është për mësuesit, të cilët vijnë nga qyteti i Durrësit një orë përpara fillimit të procesit mësimor për të asistuar në marrjen e nxënësve nga vendbanimi i tyre në Vadardhë për në shkollën “Njazi Mastori” në Sukth. E njëjta procedurë ndiqet në shoqërimin e tyre në vendbanim dhe kthimin e punonjësve arsimor në vendbanimin e tyre në Durrës tashmë kur është errësuar dhe ka kaluar më shumë se 40 minuta nga përfundimi i procesit mësimor.

Dua të vlerësoj dhe falënderoj të gjithë stafin pedagogjik, i cili nuk nguroi ta përballojë me sukses këtë sfidë që koha na vuri.

Sfidë është edhe për Drejtuesit e Institucionit, të cilët edhe vete janë përfshirë në këtë mision duke përbushur një nga parimet e mësuesit: përkushtimin ndaj nxënësit. Së bashku do t’ia dalim!

Drejtuesit e shkollës janë të tre të pajisur me certifikatën nga Shkolla e Drejtorëve e Arsimit Parauniversitar (CSL) mbi drejtimin e institucioneve arsimore.

Gjatë vitit shkollor 2024 – 2025 vijnë mësimin 508 nxënës. Në shkollë janë të punësuar 31 mësues dhe një psikolog. Por Komuniteti rreth shkollës është heterogjen. Shumica e tyre (78%) janë të ardhur nga rrethi i Dibrës dhe 22% nga zona të tjera. Duhet theksuar se një pjesë e nxënësve janë kthyer nga emigrimi. Shtatë prej tyre janë të lindur në Greqi .

Nisur nga të dhënat demografike shumica e prindërve baballarë punojnë në emigracion dhe nënat punojnë me orare të zgjatura kryesisht në fasoneri. Kjo reflektohet në përfshirjen e pak prindërve në jetën e shkollës. Po kështu niveli arsimor, kulturor dhe mentaliteti i prindërve është barrierë e dukshme në pranimin e situatave dhe vendimmarrjen në shkollë.

Rezultatet nga përgjigjet për pyetjen mbi stilin e drejtimit:

Drejtori i shkollës shprehet se sfida më e madhe në shkollën e tyre është akomodimi dhe menaxhimi ditor i procesit mësimor, pasi mësimi zhvillohet pasdite në mjediset e një shkolle tjetër në të cilën angazhimi i mësuesve është i kufizuar. Në këtë situatë sipas drejtorit në shumicën e rasteve i duhet të jetë autoritar për zbatimin e ligjit dhe për kryerjen korrekte të punës. Autoritetin e përdor kryesisht me ata që neglizhojnë dhe janë të pandërgjegjshëm për detyrën e tyre. Mirëpo në shumicën e rasteve për ta bërë leadershipin aktiv, veprimtaria e drejtuesve është bashkëpunuese duke respektuar organizmat në shkollë. Drejtuesit shprehen se sa më shumë anëtarë të marrin pjesë, aq më efektive janë proceset e diskutimit, ndërtimi i konsensusit dhe vendimmarrja institucionale.

Një mësues shprehet se stili i drejtimit nuk varet vetëm nga temperamenti dhe kultura e drejtuesit, po edhe nga klima, qëndrimet dhe angazhimi i mësuesve, pasi ata kanë shumë forcë në mbarëvajtjen e institucionit arsimor. Ka ardhur koha që komuniteti, mësuesit dhe filozofia e shkollës e kërkon drejtorin demokrat, drejtorin që komunikon, merr ide dhe në mënyrë interaktive merr vendime me pjesëmarrjen e grupit të interesit.

Rezultatet nga përgjigjet për pyetjen mbi nivelin e bashkëpunimit:

Niveli i bashkëpunimit shprehet një mësues duhet të fillojë pike se pari nga vetë drejtoria e shkollës midis vetë drejtuesve. Në vijim të kësaj vetë drejtuesi thotë se drejtimi i shkollës nuk mjaftohet vetëm me zbatimin e kuadrit ligjor, por mbi të gjitha duhet mirëkuptimi midis drejtorit dhe drejtuesve duke respektuar pozicionet dhe rolet e tyre. Po kështu në raport me mësuesit duhet nivel i lartë bashkëpunimi. Natyrisht, siç shprehet drejtori, ai ka një rol kryesor në nxitjen dhe përkrahjen e bashkëpunimit pedagogjik

midis mësuesve, sepse ai është drejtuesi kryesor i shkollës dhe ka ndikim në politikat dhe organizimin e shkollës.

Nga ana tjetër një mësuese shprehet se “Veprimtaritë ndërvepruese dhe bashkëpunuese na ndihmojnë në krijimin e mjediseve mësimore të pasura dhe të stimulueshme për nxënësit, duke ndihmuar ata të arrijnë sukses akademik më të madh dhe zhvillimin e aftësive të tyre të tjera.”

Pra siç del nga këto intervista, ndërveprimi dhe bashkëpunimi ndihmojnë jo vetëm fuqizimin e kapaciteteve bashkëpunuese, po ndikon edhe në krijimin e mjediseve mësimore të pasura dhe motivuese për nxënësit. Përtej kësaj një kolege shprehet se niveli i bashkëpunimit pedagogjik në hartimin e planeve të organizimit të drejtorisë, varet nga kulturat dhe praktikat e shkollës, ku roli i drejtuesit të shkollës si lider është shumë i rëndësishëm.

Rezultatet nga përgjigjet për pyetjen mbi vizionin i shkollës

Vizioni lidhet direkt me misionin, i cili shprehet në planet afatmesme dhe ato vjetore të shkollës. Drejtorët me vizion inkurajojnë dhe organizojnë aktivitete të ndryshme për të nxitur bashkëpunimin midis mësuesve. Një mësuese shprehet se praktika që nxit mësuesit të ndërmarrin nisma të guximshme për të orientuar vizionin e shkollës tregon se sa te preokupuar janë mësuesit për mbarëvajtjen e procesit të ndryshimit të shkollës së tyre. Nëse një drejtor ka qenë një mësues i mirë patjetër që do ketë mbështetjen e kolegëve dhe patjetër që performanca e tij ndikon tek kolegët e tij.

Drejtori duhet të ketë një vizion të qartë dhe të frytshëm për të ardhmen e shkollës dhe përfitimet që do të sjellë ndryshimi. Liderët e fortë inkurajojnë mësuesit dhe personelin e shkollës të bashkohen në përpjekjet e ndryshimit dhe të ndajnë përgjegjësi dhe motivim. Kryetari i bordit të shkollës shprehet se “Suksesi i ndryshimit varet nga përfshirja aktive dhe përkushtimi

i mësuesve. Drejtori duhet të krijojë një kulturë të përkrahjes dhe bashkëpunimit, duke i dëgjuar dhe mbështetur mësuesit, prindërit dhe nxënësit në përbushjen e qëllimeve të ndryshimit, pavarësisht se sa mundësi dhe ide kanë ata.” Po kështu një kryetar i këshillit të një klase thotë se “Drejtori duhet të përfshijë prindërit dhe komunitetin në procesin e ndryshimit, duke krijuar partneritet të fortë dhe duke zhvilluar bashkëpunim të mirëfillt”.

Mësuesit ndajnë të njëjtin mendim se ndryshimet e suksesshme vijnë nga një përkushtim i fortë drejt vizioneve të qarta, bashkëpunimit të fuqishëm dhe zbatimit të planifikimit strategjik. Nga ana e tij drejtori i shkollës shpreh rezervat e tij duke mos e përjashtuar dhe mundësinë e ndikimit të tij si faktor frenues kur thotë se “... ka dhe raste kur ka paqartësi apo nuk bëhen shpjegime të plota. Mësuesit jo gjithmonë i presin mirë disa kërkesa, por pasi futen në realizimin e tyre përgjithësisht së bashku ia dalin dhe shohin rezultate konkrete të ndryshimit.”

Përfundime

Ky punim nëpërmjet një studimi rasti solli përvoja mbi sfidat e lidershipit në shkollat rurale. Punimi u zhvillua me metoda cilësore dhe gjetjet dhe konkluzionet kanë vlerë vetëm për këtë shkollë.

Kjo shkollë ndodhet në një zonat rurale, ku sfida më aktuale është efektiviteti i mësimit në kushte jo të përshtatshme deri në rindërtimin përfundimtar të shkollës.

Komuniteti është heterogjen dhe niveli i përfshirjes së prindërve dhe i komunitetit është i ulët. Ky nivel bëhet edhe më i ulët edhe për arsye se mësimi zhvillohet në një shkollë tjetër në turnin e pasdites, i cili ka ndikuar edhe në rezultatet jo fort të dëshiruara nga stafi. Emigracioni, punësimi me kohë të zgjatur i nënave në fasoneri e zbehin angazhimin e tyre që kërkon një shkollë qendër komunitare. Gjithsesi mësuesit, drejtuesit dhe prindërit aktivë

punojnë për të arritur nismat e tyre.

Nga studimi del se lidershipi si model demokratik i funksionimit të shkollës njihet dhe vlerësohet si nga drejtuesit, ashtu edhe nga mësuesit e shkollës.

Konkluzioni që del nga rezultatet e gjetura është se në zonat rurale drejtori dhe drejtuesit e shkollës kanë mundësi, forcë dhe përparësi kryesore në angazhimin e mësuesve dhe të gjithë komunitetit në funksionimin e lidershipit.

Mundësia më e mirë për të arritur përfshirje të lartë është diskutimi dhe përcaktimi i vizionit të shkollës. Vizioni nuk prek drejtpërdrejt ngarkesën e mësuesve po nxit fantazinë, idetë dhe perceptimet e tyre. Kjo është një ftesë e mirë për t'i bërë të ndjehen pjesë organike e drejtimit me lidership të shkollës.

Vijueshmëria e hartimit të planeve mbi projektimin e vizionit është tjetër mundësi e përballimit të sfidës.

Drejtori i shkollës, mësuesit dhe komuniteti të fokusohen në marrëdhëniet e respektimit reciprok të ideve, mendimeve pa i shpërfillur apo përbuzur ato. Ky respekt dhe ekuilibër, arrihet duke iu referuar kuadrit ligjor dhe misionit të shkollës.

Drejtori i shkollës si dhe dy nendrejtorët janë të gatshëm

Rekomandime

Nga përfundimet e këtij punimi dalin edhe disa rekomandime për mësuesit dhe drejtuesit e shkollës. Mësuesit e shkollës duhet:

- Të kuptojnë dhe të performojnë sipas vizionit dhe misionit të shkollës. Ata duhet të këmbëngulin për të hartuar një vizion të qartë dhe të dobishëm për shkollën dhe paraprirjen e veprimtarisë së tyre.
- Të njohin dhe të kuptojnë mirë rolin dhe përgjegjësitë që i ofron Rregullorja e funksionimit të institucioneve arsimore dhe të angazhohen aktivisht, pasi prej

- tyre varet edhe cilësia e funksionimit të lidershipit.
- Të trajnohen vazhdimisht dhe të përqafojnë risitë në arsim duke përdorur teknologjinë.
- Drejtuesit e shkollës duhet:
 - Në bazë të vizionit të shkollës duhet të ndjekin me rigorozitet çdo planifikim, organizim dhe plan përmirësimi .
 - Të sigurojnë zhvillim, zbatim dhe përmirësim të një cilësie të vazhdueshme.
- Të jenë çelësi i drejtimit të suksesshëm duke u mbështetur në zbatimin e strategjive të reja, motivimin e stafit, ngritjen e cilësisë së shkollës duke e bërë atë konkurruese me shkollat elitare.
- Të jenë modeli i bashkëpunimit, atmosferës dhe i klimës pozitive në bashkëpunimin interaktiv të shkollës.
- Duhet të gjejnë mënyrat dhe masën e përfshirjes së komunitetit në jetën shkollore.

REFERENCAT

- Alamassi, S. M. S. & Al Jneibi, F. S. & et al (2015). "What Hinders Educational Change? School Principals' Perspectives in the UAE Context", *Multilingual Academic Journal of Education and Social Sciences*, Vol. 3, No. 1, 2015: 43 – 59.
- Albu. G. (2013) "The issue of change: teacher and student", 1877-0428 © 2013 The Authors.
- Antonakis, J., & House, R. J. (2014). "Instrumental leadership: Measurement and extension of transformational–transactional leadership theory", *The Leadership Quarterly*, Volume 25, Issue 4, August 2014, pages 746-771
- Ayda, K. N. & Kaşot, N. & Güneyli, A. (2018). "Approaches of School Administrators toward Teachers with Different Types of Human Nature: The Cyprus Case". *Behav Sci (Basel)*. 2018 Aug; 8(8): 66. Published online 2018 Jul 25, doi: 10.3390/bs8080066.
- Bommer, W. H., Rich, G. A., & Rubin, R. S. (2005). "Changing attitudes about change: Longitudinal effects of transformational leader behavior on employee cynicism about organizational change", *Journal of Organizational Behavior*, 26, 733–753.
- Fullan, M. (2001). *Leading in a culture of change*, San Francisco: Jossey-Bass.pg 6-7. <https://www.csus.edu/indiv/j/jelinekd/cdte%20227/fullanleadinginacultureofchange.pdf>
- Hill, A. & Mellon, L. & Laker, B. & Goddard, J. (2017). "How the Best School Leaders Create Enduring Change", *Harvar Business Review*, September 14, 2017
- Hoque, E. K & Raya, T. Z (2009): "Relationship between Principals' Leadership Styles and Teachers' Behavior", *Behav. Sci.* 2023, 13(2), 11; <https://doi.org/10.3390/bs13020111>
- Lucia, D. J. (2011). *Barriers and Supports to Implementation of Principal Leadership for School Change*, Minnesota, US: Walden University
- McHenry, N. A. (2009). *The Relationship Between Leadership Behaviors, Teacher Collaboration, and Student Achievement*, US: University of Southern Mississippi.
- Mincu, M. (2022). "Why is school leadership key to transforming education? Structural and cultural assumptions for quality education in diverse contexts" Doi: 10.1007/s11125-022-09625-6 PMID: 9628287. PMID: 36339494
- Mulford, B. (2003). "School leaders: changing roles and impact on teacher and school effectiveness", A paper commissioned by the Education and Training Policy Division, OECD, for the Activity Attracting, Developing and Retaining Effective Teachers. Published by Elsevier B.V. Open access under CC BY-NC-ND license. Selection and/or peer-review under responsibility of PSIWORLD 2012, doi: 10.1016/j.sbspro.2013.04.271

- Sumintono, B., Nugroho, J. P., Hariri, H. and Izzati, A. U. (2019). "The Role of Districts in Supporting School Leaders' Instructional Leadership: a View and Experience from a Developing Country", *Journal of Educational Administration* DOI:10.1108/JEA-09-2019-227
- Varthana, T. (2023). "School Vision and Mission: Why is it important?". <https://varthana.com/school/author/team-varthana/>
- Young, C. D.; White, E.R & Williams, A. M. (2023). "The Roles of Educational Leaders in the Policy Process" ISBN: 978-1-80382-482-6, eISBN: 978-1-80382-481-9

ABSTRACT

Leadership is the form and methodology of the functioning of schools that aim at their change and democratic transformation. Decentralization, stakeholder involvement, and engagement of all staff, employees, students, and the community is a priority for school operations today. This paper brings the experience of the operation of a rural school in the form of a case study. The work is based on qualitative methods based on the review of the literature of the field, the consultation of the official documentation on the management of the school as well as the interviews of teachers, students, leaders and parents. The paper also brings a picture of the level of implementation of leadership in defining the school's vision and mission, decision-making as well as in the useful activities of the school. Analytically, through meta-analysis, the paper highlights a number of factors and barriers encountered by school management on the bases and principles of school leadership. The most challenging problem in rural schools is dealing with the traditional mentality. Authoritarian directors also seem to be desired by interest group opinion. Teachers, students and parents often create conflicts and get involved in unpleasant situations precisely because of the different perceptions they have about the effective school model, taking responsibilities and solving problems that concern the school. The study also proves that the determination of the vision and the structuring of the medium-term and annual school plans do not come as a result of discussions and constructivist studies, they are taken a priori. This approach creates disconnection and inconsistency in running the school according to an effective strategy. The paper gives some recommendations for leaders, teachers and school students.

Key words: *Leadership, rural school, director, teacher, vision, community*

PËRVOJAT E PROGRAMEVE AKADEMIKE TË SHKËMBIMEVE

Nevila FURXHI

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale

E-mail: nkocollari@gmail.com

Asunta TOROMËNI

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Sociale

Departamenti i Punës Sociale dhe Politikës Sociale

(PhD Cdheidate)

E-mail: toromani.asunta2@gmail.com

PËRMBLEDHJE¹

Ky studim synon të përqendrohet në përvojat e studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale (Universiteti i Tiranës, Shqipëri), lidhur me eksperiencat respektive në programet e shkëmbimit akademik (zhvillimi akademik dhe social). Shkëmbimet akademike po njihen gjithnjë e më shumë si jetike për përmirësimin e punësimit të studentëve dhe kompetencave ndërkulturore... studentët që marrin pjesë në këto programe shpesh arrijnë performancë më të mirë akademike dhe fitojnë aftësi të vlefshme që janë tërheqëse për punëdhënësit e ardhshëm. Duke përdorur intervistat gjysmë të strukturuar, kërkimi mblodhi të dhëna nga një kampion i qëllimshëm studentësh që kanë marrë pjesë në këto programe. Mbledhja e informacionit u realizua përmes shërbimeve të fakultetit, e kufizuar në 5 vitet e fundit, por jo në programe specifike apo cikle studimi. Aspektet sociale të shkëmbimeve akademike, pengesat gjuhësore dhe dallimet kulturore shpesh paraqesin sfida të mëdha për studentët, të

¹ Ky punim është prezantuar në konferencën ndërkombëtare e ndërdisiplinore “Mirëqenia në Kohë Sfiduese” [Well-being in Challenging Times], mbajtur në Universitetin AAB të Prishtinës, Kosovë, më 15-16 nëntor 2024; Proceedings, fq. 98. link: <https://www.sociology.al/sites/default/files/19th%20International%20Conference%20Proceedings%20AAB%20Pristine%202024.pdf>

cilat mund të ndikojnë në përvojën dhe angazhimin e tyre të përgjithshëm gjatë shkëmbimit. Kapërcimi i këtyre pengesave mund të çojë në rritje të vetëbesimit dhe një ndjenjë më të fortë përkatësie tek pjesëmarrësit, teksa ata përshtaten me mjediset e reja dhe ndërveprojnë me bashkëmoshatarë të ndryshëm. Mjediset mbështetëse akademike, të karakterizuara nga strategji efektive të komunikimit dhe angazhimit, përmirësojnë ndjeshëm përvojat dhe perceptimet e studentëve për shkëmbimet akademike. Përpjekjet bashkëpunuese të fakultetit dhe administratës, mund të krijojnë një atmosferë më gjithëpërfshirëse që inkurajon pjesëmarrjen dhe mbajtjen e studentëve në këto programe. Perceptimet e studentëve lidhur me shkëmbimet akademike, formohen nga një marrëdhënie komplekse mes performancës akademike, integritimit social dhe mbështetjes institucionale.

Fjalë kyçe: student, përvojë, barriera, programe shkëmbimi

Nevila FURXHIU është diplomuar si Punonjëse Sociale në vitin 1993, nga i njëjti Departament, ku bën pjesë si lektore me kohë të plotë prej vitit 2012. Aktualisht, mban titullin Profesor i Asociuar Doktor dhe lektorin lëndë në programet Bachelor dhe Master pranë Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale.

Asunta TOROMËNI është diplomuar nëdegën Administrim dhe Politika Sociale dhe aktualisht ndjek studimet doktorale pranë Departamentit të Punës dhe Politikës Sociale. Është asistente lektore me kohë të plotë pranë këtij departamenti dhe asiston në lëndë të programit Bachelor Punë Sociale dhe Administrim dhe Politika Sociale.

Referuar ndikimit të globalizimit, programet e shkëmbimit akademik janë mundësi kyçe për studentët, për të përmirësuar përvojat e tyre akademike dhe për të zhvilluar aftësi thelbësore që janë shumë të vlefshme në tregun e punës konkurrues. Këto programe jo vetëm që ofrojnë përfitime akademike, por gjithashtu promovojnë kompetencat ndërkulturore, duke lejuar studentët të angazhohen me perspektiva dhe kultura të ndryshme. Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës, shërben si një kontekst për të matur perceptimet e studentëve që kanë marrë pjesë në programet e shkëmbimit akademik.

Ndërsa institucionet e njohin rëndësinë e pajisjes së studentëve me aftësitë e nevojshme për karrierë të suksesshme, kuptimi i ndikimit të këtyre shkëmbimeve në zhvillimin akademik dhe social të studentëve bëhet thelbësor. Studimet tregojnë se pjesëmarrja në programet e shkëmbimit, është e lidhur me përmirësimin e performancës akademike dhe rritjen e mundësive për punësim (Clemente,

Tavares dhe Silva, 2020). Megjithatë, këto programe gjithashtu, paraqesin sfida, përfshirë barrierat gjuhësore dhe dallimet kulturore që mund të pengojnë angazhimin e studentëve dhe përvojën e tyre të përgjithshme.

Ky studim ka për qëllim të evidentojë raportimet e studentëve nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, në lidhje me përvojat e tyre në programet e shkëmbimit akademik, duke u përqendruar në dimensionet akademike dhe sociale. Nëpërmjet realizimit të intervistave gjysmë të strukturuar, të dhënat u mblodhën nga një target i qëllimshëm i studentëve që kanë marrë pjesë në shkëmbime gjatë pesë viteve të fundit në mobilitete në universitete jashtë vendit. Duke shqyrtuar referimet e performancës akademike, integritimit social dhe mbështetjes institucionale, ky studim kërkon të theksojë se si mjediset akademike mbështetëse mund të përmirësojnë pjesëmarrjen dhe përvojat e studentëve mbi programet e shkëmbimit. Gjetjet do të kontribuojnë në një kuptim më të thellë të faktorëve që ndikojnë në pjesëmarrjen

e studentëve në shkëmbimet akademike, duke ofruar njohuri për fakultetin dhe administratën, për të inkurajuar programe më gjithëpërfshirëse dhe efektive.

Vështrim nga literatura

Literatura përmes studimeve të ndryshme, që ilustron rezultate pozitive dhe negative, konfirmon se pjesëmarrja në programet e shkëmbimit të studentëve, ka një ndikim të nuancuar në performancën akademike. Për shembull, ndërsa disa kërkime tregojnë për një rënie të notave për studentët pjesëmarrës në këto programe, me një rënie mesatare prej 7% krahasuar me kolegët e tyre jo-lëvizës, ky efekt negativ është më pak i theksuar për studentët e përfshirë në shkëmbimet e lehtësuara nga Erasmus (Czarnitzki, Joosten dhe Toivanen, 2022). Nga ana tjetër, pjesëmarrja në programet e studimeve jashtë vendit, është shoqëruar edhe me përmirësime në mesataren e notave (GPA) në semestrat pasues, duke sugjeruar një ndikim afatgjatë pozitiv në performancën akademike (Lee, Leibowitz, Rezek, Millea dhe Saffo, 2021). Ky rezultat i dyfishtë, mund të shpjegohet përmes konceptit të vetë-efikasitetit akademik, i cili rritet përmes sfidave dhe përvojave të hasura gjatë shkëmbimeve ndërkombëtare (McKeown, Celaya dhe Ward, 2020). Është gjithashtu e rëndësishme të merret parasysh, se këto programe ofrojnë përfitime të konsiderueshme arsimore që shtrihen përtej matjeve të thjeshta të GPA, duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm akademik (McKeown, Celaya dhe Ward, 2020). Ndërkohë që performanca e menjëhershme akademike mund të ketë rënie, përvoja më e gjerë arsimore dhe aftësitë e përmirësuara akademike të fituara nga studimi jashtë vendit, mund të ofrojnë avantazhe të rëndësishme afatgjata. Këto ndërlidhje komplekse nënvizojnë rëndësinë e hartimit të programeve të shkëmbimit, që zbusin sfidat afatshkurtra akademike, duke

maksimizuar përfitimet afatgjata arsimore.

Ndërsa performanca akademike e studentëve që marrin pjesë në programet e shkëmbimit si ERASMUS, mund të shohë një rënie të përkohshme, mundësitë më të gjera të rritjes personale, të ofruara nga këto programe e tejkalojnë këtë pengesë. Një nga përfitimet kryesore, është rritja e aftësive gjuhësore, e cila është një avantazh i rëndësishëm në botën e sotme të globalizuar; 94% e pjesëmarrësve në ERASMUS raportuan njohuri të përmirësuara të gjuhës së huaj, një aset kritik për karrierën e tyre të ardhshme. Për më tepër, ekspozimi ndaj sistemeve të ndryshme të kujdesit shëndetësor dhe arsimor, i lejon studentët të krahasojnë dhe analizojnë qasje të ndryshme, të cilat jo vetëm zgjerojnë këndvështrimet e tyre, por gjithashtu nxitin përshtatshmërinë dhe të menduarit kritik (Żebryk, Przymuszała dhe Nowak, 2021). Kjo pjesëmarrje në mjedise të ndryshme kulturore dhe metoda novatore të mësimdhënies kultivon një kuptim dhe korrelacion më të thellë të njohurive, duke zhvendosur qasjet e të nxëniet të studentëve nga memorizimi përmendësh në një angazhim më kuptimplotë me materialin. Për më tepër, rritja personale e lehtësuar nga këto programe është e thellë, pasi studentët zhvillojnë vetëbesim dhe pjekuri më të madhe përmes udhëtimit dhe ndërveprimit me kulturat e reja. Këto përvoja transformuese kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin personal dhe profesional, duke i pajisur studentët me aftësitë dhe perspektivat e nevojshme për sukses në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur (Żebryk, Przymuszała dhe Nowak, 2021).

Një nga perceptimet më domethënëse që kanë studentët në lidhje me shkëmbimet kulturore gjatë programeve të tyre, është ndikimi i thellë në rritjen personale dhe ndërgjegjësimin kulturor. Nëpërmjet ekspozimit ndaj praktikave të ndryshme kulturore, të tilla si pjesëmarrja në

traditat lokale dhe vëzhgimi i ngjarjeve të rëndësishme të jetës si dasmat dhe festivalet, studentët raportojnë një kuptim më të thellë të kulturës pritëse dhe vlerave të saj (Sustarsic, 2018). Kjo, jo vetëm që zgjeron horizontet e tyre kulturore, por gjithashtu nxit një ndërgjegjësim të rritur global, duke u mundësuar atyre të vlerësojnë ndërlidhjen e kulturave të ndryshme dhe ndikimin e tyre global (Glass, 2021). Për më tepër, studentët shpesh shprehin se këto përvoja pasurojnë rrugëtimin e tyre arsimor, duke i lejuar ata të dalin jashtë zonave të tyre të rehatisë dhe të zhvillojnë një perspektivë më të gjerë për programet ndërkombëtare (Rapoport, 2020). Ky pasurim kulturor dhe akademik është vendimtar, pasi përputhet me qëllimet kryesore të programeve të shkëmbimit, të cilat synojnë të kultivojnë individë të mirëformuar, të aftë për të kontribuar në një botë të larmishme dhe të globalizuar. Prdheaj, njohja dhe përmirësimi i aspekteve kulturore të programeve të shkëmbimit, duhet të jetë një prioritet për institucionet arsimore, për të maksimizuar përfitimet për pjesëmarrësit.

Pjesëmarrja në programe shkëmbimi u ofron studentëve të mësuesisë nga Universiteti Can Tho një mori përfitimesh, ku një nga më të spikaturat, është përvetësimi i njohurive të reja dhe rritja e aftësive të tyre të mësimdhënies. Ky fluks i njohurive të reja dhe metodave novatore të mësimdhënies, i pajis ata me një kuptim më të gjerë të praktikave të ndryshme arsimore, të cilat më pas, mund t'i integrojnë në qasjet e tyre të mësimdhënies. Për më tepër, mbështetja e ofruar nga partnerët dhe mentorët e huaj, luan një rol vendimtar në pasurimin e këtyre përvojave. Mentorimi dhe udhëzimi nga edukatorët me përvojë në vendin pritës, i ndihmojnë mësuesit studentë të lundrojnë në kompleksitetin e një mjedisi të ri arsimor dhe të kapërcejnë barrierat e mundshme. Megjithatë, përvojat e këtyre studentëve nënvizojnë gjithashtu, domosdoshmërinë që institucionet arsimore të zhvillojnë strategji

të fuqishme dhe sisteme mbështetëse, për të optimizuar këto programe shkëmbimi. Mbështetja efektive institucionale mund të rrisë ndjeshëm shkallët e pjesëmarrjes dhe kënaqësinë e përgjithshme, duke siguruar që studentët të kenë përfitimet maksimale nga përvojat e tyre ndërkombëtare (Diem, Thinh dhe Mung, 2020). Miratimi i masave të tilla, mund të adresojë sfidat e zakonshme si barrierat gjuhësore, dallimet kulturore dhe çështjet e menaxhimit të kohës, duke krijuar kështu një mjedis më të favorshëm për të mësuarit dhe rritjen profesionale. Nxitja e një mjedisi që mbështet këto përpjekje ndërkombëtare, jo vetëm që ndihmon studentët individualisht, por gjithashtu, kontribuon në peizazhin më të gjerë arsimor, duke promovuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkulturor.

Perceptimi i dallimeve kulturore gjatë programeve të shkëmbimit, shpesh i shtyn studentët të zhvillojnë strategji përbaluese dhe të paralelizojnë me kulturën e tyre, e cila shërben si një pikë referimi e njohur në lundrimin në mjedise të reja. Duke qenë në një mjedis të bashkëmohatarëve vendas dhe ndërkombëtarë, studentët janë të motivuar të hulumtojnë dhe interpretojnë diversitetin kulturor që hasin, duke pasuruar përvojat e tyre personale dhe arsimore. Ky ekspozim është thelbësor për zhvillimin e tyre ndërkulturor, pasi jo vetëm që zgjeron të kuptuarit e tyre për kulturat globale, por gjithashtu nxit një rritje të konsiderueshme personale. Për më tepër, ndërveprimet me kultura të ndryshme shpesh sfidojnë gjykimet dhe stereotipet e paragjykuara të studentëve, duke i detyruar ata të rivlerësojnë qëndrimet dhe vlerat e tyre. Përvoja të tilla janë të paçmueshme, duke i shtyrë studentët të angazhohen në vetë-analizë në lidhje me identitetin e tyre kulturor dhe duke rritur vetëdijen e tyre. Efekti kumulativ i këtyre përvojave nënvizon fuqinë transformuese të programeve të shkëmbimit në formësimin e individëve të mirëpërputhur, të aftë kulturalisht.

Një nga sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen studentët ndërkombëtarë kur përshtaten me mjediset e reja arsimore jashtë vendit, është menaxhimi i dallimeve sociokulturale. Këto dallime përfshijnë një gamë të gjerë çështjesh, nga lundrimi i normave shoqërore të panjohura deri tek të kuptuarit e prirjeve të reja arsimore (Ivannikov, Kolesnikov dhe Sablina, 2021). Për shumë studentë, procesi i socializimit në një mjedis të larmishëm kulturor mund të jetë i ngatërruar, shpesh duke çuar në një ndjenjë çorientimi dhe tronditjeje kulturore (Volet dhe Jones, 2012). Shoqëria përreth luan një rol vendimtar në formësimin e personaliteteve dhe modeleve të sjelljes së tyre ndërsa ata përshtaten, shpesh duke u kërkuar atyre të adoptojnë shenja dhe sjellje të reja sociale që janë dukshëm të ndryshme nga kultura e tyre (Ivannikov, Kolesnikov dhe Sablina, 2021). Për më tepër, nevoja për të komunikuar në mënyrë efektive në një gjuhë joamtare, shton një shtresë shtesë kompleksiteti.

Zotërimi i gjuhës, jo vetëm që ndikon në performancën akademike, por gjithashtu ndikon në aftësinë e studentëve për t'u angazhuar me kolegët dhe pedagogët, duke ndikuar kështu në integrimin e tyre të përgjithshëm shoqëror (Volet dhe Jones, 2012). Këto sfida nënvizojnë rëndësinë e zhvillimit të aftësive të fuqishme të komunikimit për të kapërcyer hendekun midis modeleve të ndryshme sociokulturale, duke lehtësuar kështu, një proces më të butë përshtatjeje (Ivannikov, Kolesnikov dhe Sablina, 2021). Për të adresuar këto sfida të shumëanshme, është thelbësore që institucionet arsimore të ofrojnë sisteme të synuara mbështetëse që përfshijnë programe të asistencës gjuhësore, sesione orientimi kulturor dhe mentorim nga bashkëmohatarët. Ndërhyrje të tilla mund të ndihmojnë studentët ndërkombëtarë të lundrojnë në kompleksitetin e mjediseve të tyre të reja në mënyrë më efektive, duke rritur përfundimisht përvojat e tyre akademike dhe sociale jashtë vendit.

Barrierat kryesore me të cilat përballen studentët e punës sociale në programet e shkëmbimit

Një nga barrierat kryesore me të cilat përballen studentët e punës sociale në programet e shkëmbimit, është vështirësia financiare, e cila shpesh vepron si një pengesë e rëndësishme për pjesëmarrjen. Kostoja e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzimet e përditshme të jetesës është një barrë e konsiderueshme, veçanërisht për studentët me prejardhje me të ardhura të ulëta ose ata që mbështeten shumë në ndihmën financiare. Kjo tendosje financiare, mund të çojë në rritje të stresit dhe ankthit, duke e komplikuar më tej aftësinë e tyre për t'u përfshirë plotësisht në program (Lee, 2013). Një tjetër pengesë kritike, është pengesa gjuhësore, e cila mund të krijojë sfida komunikimi si në mjediset akademike, ashtu edhe në ndërveprimet e përditshme. Për jo-folësit amtarë, zotërimi i gjuhës lokale në një nivel të aftë që kërkohet për suksesin akademik dhe integrimin efektiv social, mund të jetë frikshëm (Lee, 2013) barrierë. Për më tepër, sfidat strukturore dhe logjistike, të tilla si kalendarët e ndryshëm akademikë, çështjet e transferimit të kredive dhe rregulloret e vizave, paraqesin pengesa të rëndësishme. Këto pengesa burokratike mund të vonojnë apo edhe të pengojnë studentët të marrin pjesë në programe shkëmbimi, duke kufizuar kështu, mundësitë e tyre arsimore dhe të zhvillimit profesional (Peiser, 2016). Adresimi i këtyre pengesave kërkon një qasje të shumëanshme, duke përfshirë rritjen e mbështetjes financiare, programet e trajnimit gjuhësor dhe proceset e thjeshta administrative, për të siguruar që më shumë studentë të mund të përfitojnë nga këto përvoja të vlefshme ndërkombëtare.

Për të zbutur dhe kapërcyer në mënyrë efektive barrierat në ndarjen e të dhënave dhe zbatimin e projekteve brenda fushave të shërbimeve arsimore dhe sociale, disa qasje strategjike janë demonstruar si të suksesshme. Një masë e rëndësishme ishte

krijimi i një partneriteti bashkëpunues midis organizatave të ndryshme, si Departamenti i Shërbimeve Sociale në Kaliforni, Qendra për Kërkimin e Shërbimeve Sociale dhe Partneriteti i Kalifornisë për Arritjen e Suksesit të Studentëve. Ky bashkëpunim lehtësoi komunikimin më të butë dhe objektivat e përafuar, duke adresuar dhe reduktuar kompleksitetin e përfshirë në proceset e shkëmbimit të të dhënave. Për më tepër, pajtueshmëria e projektit me rregulloret e FERPA-s vendosi një precedent për ndarjen e sigurt dhe ligjore të të dhënave ndërmjet mirëqenies së fëmijëve dhe sistemeve arsimore, duke siguruar që shqetësimet e privatësisë të menaxhoheshin në mënyrë adekuate (Frerer dhe Sosenko, 2013). Qasja praktike e plotësimit të kërkesave të memorandumëve të mirëkuptimit (MOU) dhe akteve të Bordit të Rishikimit Institucional (IRB) racionalizoi më tej procesin, duke mundësuar shkëmbim më efikas të të dhënave dhe bashkëpunim midis subjekteve të ndryshme. Këto përpjekje të bashkërenduara theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit shumë-organizativ dhe respektimin e kornizave ligjore, për të kapërcyer barrierat në integrimin e të dhënave dhe zbatimin e projektit. Ecja përpara, partneritetet e vazhdueshme dhe respektimi i protokolleve të vendosura janë thelbësore për të ruajtur dhe rritur më tej efektivitetin e nismave të tilla, duke siguruar që përfitimet e sistemeve të integruara të të dhënave janë realizuar plotësisht.

Mundësitë që ofrojnë programet e shkëmbimit për studentët e punës sociale

Programet e shkëmbimit ofrojnë mundësi të shumta për studentët e punës sociale, duke rritur ndjeshëm trajktoret e tyre akademike dhe profesionale. Së pari, këto programe ofrojnë një perspektivë globale mbi praktikat e punës sociale, duke i lejuar studentët të kuptojnë çështje të ndryshme sociale dhe kontekste kulturore.

Ky ekspozim është vendimtar për zhvillimin e një profesionisti të mirë të punës sociale, i cili mund të përshtatet me mjedise dhe komunitete të ndryshme. Për shembull, studentët në programet e të mësuarit të aplikuar që lidhen me punën sociale mund të fitojnë përvojë praktike dhe njohuri që përndryshe, nuk janë të disponueshme në vendet e tyre të origjinës, duke zgjeruar kështu grupet e tyre të aftësive dhe punësueshmërinë në tregun global të punës (Arnold, 2020). Për më tepër, pjesëmarrja në programet e shkëmbimit mund të nxisë një integrim më të thellë në korniza të ndryshme shoqërore, duke ndihmuar studentët në kalimin e tyre në komunitete të reja. Kjo është veçanërisht e dukshme në studimet që eksplorojnë mundësitë që studentët ndërkombëtarë të punës sociale të praktikojnë në mjedise të ndryshme tutoriale, gjë që i ndihmon ata të lundrojnë dhe integrohen në strukturën sociale të vendit pritës (Ahn, 2021). Duke ofruar mundësi unike për ndërveprim dhe mësim, të tilla si nëpërmjet intervistave me studentë me prejardhje të ndryshme, programet e shkëmbimit mund të ndihmojnë në çmitizimin e peizazhit akademik dhe profesional për grupet e nënëpërfaqësuar (Gair, Thomson dhe Savage, 2020). Si përfundim, përfitimet e shumanshme të programeve të shkëmbimit, jo vetëm që rrisin aftësitë individuale të studentëve, por gjithashtu, kontribuojnë në një fuqi punëtore sociale më gjithëpërfshirëse dhe më kompetente globalisht.

Ndikimi i programeve të shkëmbimit në performancën akademike të studentëve të shkencave sociale

Për të vlerësuar me saktësi ndikimin e programeve të shkëmbimit në performancën akademike të studentëve të shkencave sociale, është thelbësore të kontrollohen paragjykimet e përzgjedhjes dhe variablat demografikë që mund të ndikojnë në rezultatet. Duke përputhur pjesëmarrësit në programet e

shkëmbimit me vëzhgimet e kontrollit bazuar në probabilitetet e parashikuara të pjesëmarrjes dhe karakteristikat përkatëse demografike, studiuesit mund të sigurojnë një krahasim të drejtë. Kjo qasje metodologjike, është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh përbërjen demografike të pjesëmarrësve në programin e shkëmbimit. Për shembull, programe të tilla si, IVE (International Voluntary Exchange) dhe For_Lang (Gjuhë e Huaj) prirën të tërheqin përmasa më të mëdha studentësh me ngjyrë dhe studente femra, ndërkohë që janë ende relativisht të ngjashëm me grupin e kontrollit në aspekte të tjera (Lee, Leibowitz, Rezek, Millea dhe Saffo, 2021). Faktorë të tillë demografikë, duhet të merren parasysh për të shmangur rezultatet e shtrembëruara dhe për t'i atribuar me saktësi çdo ndryshim në performancën akademike, vetë programit të shkëmbimit. Për më tepër, provat empirike sugjerojnë që pjesëmarrësit e studimeve jashtë vendit, në përgjithësi kanë nota mesatare më të larta mesatare sesa kolegët e tyre jo-pjesëmarrës, një prirje që ka të ngjarë të ndikohet nga notat mesatare më të larta të shkollës së mesme dhe rezultatet SAT. Synimi i studimit për të ndërtuar vlerësime kauzale të ndikimit të pjesëmarrjes së kurrikulës globale në notën mesatare të studentëve, nënvizon rëndësinë e heqjes së paragjykimëve të përzgjedhjes, që lidhen me karakteristikat e vëzhgueshme. Duke trajtuar këta faktorë, hulumtimi mund të japë përfundime më të forta, se si programet e shkëmbimit ndikojnë në performancën akademike të studentëve të shkencave sociale dhe informojnë politikat e ardhshme arsimore dhe planet e programeve.

Përfitimet sociale dhe kulturore që përjetojnë studentët e shkencave sociale në programet e shkëmbimit

Përfitimet sociale dhe kulturore që përjetojnë studentët e shkencave sociale në programet e shkëmbimit, shtrihen përtej arritjeve akademike, duke ndikuar ndjeshëm

në zhvillimin e tyre personal. Programet e shkëmbimit si Going Global, lehtësojnë një rritje gjithëpërfshirëse në njohuritë, qëndrimet dhe sjelljet e studentëve, duke nxitur një kuptim dhe vlerësim më të thellë të kulturave të ndryshme (Van Eerdewijk, Westeneng dhe De Hoop, 2010). Programe të tilla inkurajojnë studentët të dalin nga zonat e tyre të rehatisë, duke çuar në rritjen e vetëbesimit dhe përmirësimin e aftësive të komunikimit ndërkulturor. Këto përvoja jo vetëm që rrisin tolerancën e tyre ndaj perspektivave të ndryshme, por gjithashtu, i përgatitin ata për qytetarinë globale duke përfshirë vlerat e përfshirjes dhe ndjeshmërisë. Për më tepër, efekti i këtyre përfitimeve mund të vërehet tek shokët e klasës së studentëve të shkëmbimit, të cilët, duke ndërvepruar me bashkëmoshatarët e tyre, fitojnë njohuri të zgjeruara dhe adoptojnë qëndrime më pozitive ndaj diversitetit kulturor, megjithëse pa ndryshime të rëndësishme në sjellje dhe tolerancë. Prdheaj, zbatimi i programeve të shkëmbimit, duhet të theksohet dhe zgjerohet brenda kurrikulave të shkencave sociale, për të maksimizuar këto përfitime sociale dhe kulturore, duke promovuar një trup studentor më të lidhur globalisht dhe më kompetent nga ana kulturore.

Ndikimi i programeve të shkëmbimit në perspektivat e karrierës së studentëve të shkencave sociale

Ndikimi i programeve të shkëmbimit në perspektivat e karrierës së studentëve të shkencave sociale është i shumëanshëm, duke përfshirë dimensione arsimore, kulturore dhe profesionale. Pjesëmarrja në programe të tilla, u siguron studentëve avantazhe arsimore që rrisin identitetin e tyre profesional dhe synimet për zgjedhjen e karrierës, duke çuar në trajektore më të përcaktuara dhe të qëllimshme të karrierës (Chen, Lee, Kabre dhe Hsieh, 2020). Për

më tepër, thellimi kulturor dhe rrjetet sociale të zgjeruara, të nxitura përmes këtyre programeve, kontribuojnë ndjeshëm në punësimin e studentëve dhe perspektivat e karrierës. Duke u angazhuar në përvojat ndërkombëtare, studentët zhvillojnë një kuptim më të pasur kulturor dhe përshtatshmëri, të cilat janë thelbësore në tregun e sotëm të globalizuar të punës. Përvoja të tilla ndihmojnë gjithashtu studentët të ndërtojnë një identitet të fortë profesional, i cili është një faktor kyç në gatishmërinë e tyre për punësim dhe përshtatshmëri në karrierë (Nghia, Giang dhe Quyen, 2020). Megjithatë, pavarësisht rezultateve pozitive, mbetet një hendek midis aftësive të fituara përmes këtyre programeve dhe rezultateve aktuale të punësimit, duke treguar nevojën për një harmonizim më të mirë midis përvojave arsimore dhe kërkesave të tregut të punës. Trajtimi i kësaj shkëputjeje përmes ndërhyrjeve të synuara dhe mekanizmave mbështetës, do të jetë thelbësor për të shfrytëzuar plotësisht përfitimet e programeve të shkëmbimit, për rritjen e perspektivës së karrierës në shkencat sociale.

Metodologjia

Dizajni i kërkimit

Ky studim përdor një qasje cilësore kërkimi, duke përdorur intervistë gjysmë të strukturuar, të përshtatur bazuar në literaturë dhe pilotuar më parë, me fokusin në mbledhjen e të dhënave cilësore mbi përvojat e studentëve rreth përvojave të shkëmbimeve akademike.

Pyetjet kërkimore janë:

- Cilat janë barrierat kryesore të shprehura nga studentët mbi përvojat e shkëmbimeve akademike?
- Cilët janë elementët që pengojnë procesin?
- Cilat janë përvojat lidhur me lehtësimin e procesit nga mjedisi akademik/administrativ në fakultet?

Nëpërmjet tyre synohet të njihen elementë akademikë, socialë dhe institucionalë që bashkërendohen në proces, duke reflektuar barrierat dhe përmirësimet potenciale/ reale, si pjesë e kuptimshmërisë së praktikës së programeve të shkëmbimit në perspektivat e karrierës së studentëve të shkencave sociale. Pyetje të tjera, me ndikim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe aksesueshmërinë e programeve, lehtësinë e arritshmërisë së tyre dhe rolin pozitiv të eksperiencave të tilla në forcimin e kapaciteteve zhvilluese profesionale të tyre.

Dizajni cilësor ishte i përshtatshëm për këtë hulumtim për dy arsye: (1) për të kuptuar se çfarë ndodh në të vërtetë në programet e mobiliteteve, përdorimin e praktikave përfituese, pasi nuk mund të gjenim të dhëna, nga kërkimet e bëra në Shqipëri për këtë çështje dhe (2) kampioni ishte i kufizuar dhe i vogël për të dhënë rezultate të përgjithshme, kështu që konteksti sasior, nuk do të ishte i vlefshëm. Për të testuar integritetin dhe procesin e dizajnit të kërkimit, u krye një proces intervistimi pilot me tre pjesëmarrës. Gjetjet nga pjesëmarrësit e fazës pilot nuk ishin pjesë e gjetjeve dhe diskutimeve të paraqitura nga autorët. Puna në terren u krye në periudhën midis prillit dhe marsit 2024, duke përfshirë hartimin e kërkimit, intervistimin, transkriptimet dhe analizën e të dhënave.

Pjesëmarrës në studim ishin studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale, që kanë marrë pjesë në shkëmbime akademike në 5 vitet e fundit. Kampioni është i qëllimshëm. Qasja cilësore i referohet kampionit të ulët, 13 studentë, të cilët, karakterizohen se së paku, kanë realizuar një program shkëmbimi, në Bachelor ose Master, në njërin nga programet e departamenteve të fakultetit. Në total u kontaktuan dhe u informuan për qëllimin dhe synimet e kërkimit 19 studentë dhe në përfundim të këtij procesi, vetëm 13 persona pranuan vullnetarisht të intervistoheshin nga studiuesit, të ndarë në tre intervista pilot dhe 10 intervista të përfunduara.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Komponenti cilësor i studimit u realizua në dy pjesë, një rishikim i literaturës dhe seanca intervistash ndërmjet një studiuesi dhe një pjesëmarrësi përmes intervistave gjysmë të strukturuar.

Strategjia e rishikimit sistematik për këtë studim përfshiu artikulin e pyetjeve dhe termave të kërkimit si pikë referimi për përzgjedhjen e të dhënave, kërkimi i literaturës dhe i artikujve, mbi bazën e përzgjedhjes me terma kyç dhe nxjerrja e të dhënave si rezultate të kërkimit. Instrumenti tenton të përfshij informacionin demografik, aspekte të performancës akademike, sociale dhe mbështetjes institucionale. Intervistat morrën të dhëna mbi përvojat komplekse të studentëve. Analiza tematike e të dhënave cilësore, tentoi të kuptojë nunacat e përvojave dhe sugjerime për përmirësime. Pjesëmarrësit shprehën aprovimin për përgjigjedhënie dhe pjesëmarrje në intervistim, duke u siguruar për konfidencialitetin dhe njohur me qëllimin e studimit dhe përdorimin e tij. Studiuesit kryen një klimë marrëveshjeje gjatë gjithë kohës dhe procesit të studimit.

Rezultate*Profili i të intervistuarve*

Pjesëmarrësit në studim janë 13 studentë, ku prej tyre, 6 studentë të moshës 23 vjeç, 3 studentë të moshës 22 vjeç, 3 studentë të moshës 21 vjeç dhe 1 student 24 vjeç.

Studentët pjesëmarrës janë 10 femra dhe 3 meshkuj. Referuar Erasmus+ Annual Report 2019, studentet vajza kanë pjesëmarrje më të lartë në programe shkëmbimi sesa studentët djem; rreth 60% e pjesëmarrësve në aktivitete të mobiliteteve Erasmus +, në raportin e 2019 ishin vajza/ gra.

Kufizuar në periudhën kohore respektive, studentë nga programet Bachelor, qëkanë kryer programe shkëmbimi, ndahen përkatësisht: në degët Shkenca Politike - 4 studentë dhe në Psikologji - 9 studentë).

Sipas Perkins dhe Neumayer (2014), për studentët në shkenca sociale, por specifiku në psikologji, kishte më tepër gjasa të merrnin pjesë në programe shkëmbimi, për shkak të nevojës së njohjes dhe kuptimit të kulturave diverse dhe sjelljeve njerëzore.

Në programet Master, studentët që kanë marrë pjesë në programe mobiliteti janë respektivisht, 3 studentë, nga një për çdo departament (Shkenca Politike, Psikologji, Departamentit të Punës dhe Politikave Sociale).

Gjetjet*Pengesat financiare lidhur me mobilitetet*

Një nga elementët më të rëndësishëm të identifikuar nga studentët është aspekti financiar që lidhet me lëvizjen, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndarjen e granteve/ bursave në disa pjesë, që krijon ose shton shqetësimin e jetesës në një mjedis tjetër, siç del nga pohimet e të intervistuarve:

“Një nga rastet ishte ndarja e bursës... Ishte shumë e sikletshme. Nuk i kërkoja dot as prindërve” (i intervistuari 3).

“Kostot e jetesës dhe shpenzimet janë thjesht shumë të larta. Ndonjëherë bursat nuk mjaftojnë” (i intervistuari 5).

“Është e vështirë, po mbase nëse nuk bën shumë dalje (argëtim, aktivitete sociale, etj.)... s’e di” (i intervistuari 10).

Pengesat gjuhësore

Barrierat gjuhësore përbëjnë një tjetër pengesë të rëndësishme. Studentët ndjejnë se për të pasur një performancë të mirë në një mjedis tjetër arsimor, ata duhet të kenë një njohuri të shkëlqyer të gjuhës së huaj. Kjo krijon papërshtatshmëri dhe mungesë të vullnetit për të aplikuar, duke perceptuar edhe se niveli i gjuhës së huaj duhet të jetë (në disa raste duke parajkykuar) në kategorinë C (vështirësi të larta). Të intervistuarit pohojnë:

“Gjuha për shembull. Është shumë e vështirë për mua të mendoj që dikush mund edhe të më gjykojë ose vlerësojë se nuk shprehem mjaftueshëm...”(i intervistuari 2).

“Për mua gjuha ishte arsyeja pse aplikova kaq vonë”(i intervistuari 12).

Pengesat lidhur me kreditet akademike dhe diplomimin

Studentët pjesëmarrës tregojnë se faktorët si shtyrja e datës së diplomimit, kredite të patransferueshme, staf jo në dispozicion, kanë qenë pengesa prezente. Dhe nëpërmjet studimeve, gjejmë se sipas Vdhee Berg, Paige dhe Lou (2012) koha e diplomimit ndikon në pjesëmarrjen në programe shkëmbimi. Ndëkohë, një faktor kritik është pikërisht transferueshmëria e krediteve. Studentët pjesëmarrës reflektojnë se kanë njohuri specifike mbi programet e shkëmbimit, që është një ndër pjesët e rëndësishme të procesit. Shprehin vështirësi në procesin e aplikimit, por gjithsesi i njohin si sfida të vlefshme personale. Shumë artikulojnë se përvoja e tyre e lëvizjes mund të mos kontribuojë në kërkesat për diplomimin e tyre, duke e bërë atë një mundësi të papërshtatshme:

“Dua të shkoj në një universitet tjetër për një semestër, por nuk jam e sigurt nëse kreditet do të transferohen”(i intervistuari 7).

“Jam e shqetësuar se do të mbetem pas... nëse marr një vit pushimi ose shkoj jashtë”(i intervistuari 3).

“Të diplomohesh në kohë është shumë e rëndësishme, dhe kam frikë se shkuarja jashtë do ta bëjë më të vështirë”(i intervistuari 3).

Pengesa dokumentacioni

Një nga arsyet kryesore për interesin e ulët është vështirësia në aplikim dhe procedurat që lidhen me programet e shkëmbimit. Studentët shpesh përballen me procese të ndërlikuara për të konvertuar kredite dhe lëndë, të cilat mund të krijojnë një ndjenjë frustruese dhe pasiguri. Kjo është

veçanërisht e theksuar për studentët e vitit të parë, të cilët ndihen të kufizuar dhe të pamundur për të aplikuar për shkëmbime për shkak të politikave akademike që nuk i lejojnë ata të përfshihen. Viti i dytë, i cili shpesh konsiderohet më i vështirë, e bën menaxhimin e ngarkesës akademike më impenjative, duke çuar në një ndjenjë të pasigurisë për studentët e rinj. Studentët shprehin pasigurinë dhe vështirësitë e navigimit të këtyre proceseve, që mund të vonojnë ose pengojnë mundësitë e tyre për të udhëtuar ose studiuar jashtë, si në intervistat.

“Procesi i dokumenteve ishte i komplikuar dhe mori kaq shumë kohë; isha e shqetësuar në një pikëse nuk do të merrja aprovimin në kohë për programin tim” (i intervistuari 9).

“Marrja e të gjitha dokumenteve në rregull mori shumë kohë; as nuk isha e sigurt se do të arrija të përfundoja para afatit” (i intervistuari 6).

“Duhej të merrja kaq shumë dokumente për një bursë... prita shumë për aprovimin.” (i intervistuari 12).

Mbështetje nga stafi administrativ

Becker dhe Kolb (2018) shpjegojnë rëndësinë e rolit të stafit të disponueshëm për suport gjatë procesit, duke bërë më të lehtë qasjen në këto programe. Mbështetja administrative mund të bëjë një ndryshim të madh në mënyrën se si studentët lëvizin për mundësi akademike nëpërmjet programeve të mobilitetit. Megjithatë, shumë prej tyre shprehin frustrim për mungesën e komunikimit të qartë, udhëzimeve ose ndihmës nga stafi i universitetit ose institucioneve. Kjo mund të shtojë stresin dhe pasigurinë në kalimin përmes proceseve të lëvizjes, si në vijim:

“Do të doja që stafi administrativ të ishte më i gatshëm për të ndihmuar kur kisha pyetje dhe paqartësi në aplikimin për një program shkëmbimi” (i intervistuari 8).

“Procesi më duket si një labirint, dhe nuk dija kujt t’i drejtohesha për ndihmë” (i intervistuari 3).

“Kur kisha nevojë për mbështetje për aplikimin, askush nuk dukej të dinte si mund të më përgjigjej...” (i intervistuari 11).

Pasiguria dhe mungesa e transparencës

Studentët përmendin mungesën e transparencës dhe pasigurinë që lidhet me mundësitë e lëvizjes, qoftë ato që kanë të bëjnë me shkëmbime akademike, mundësi praktike apo pune ndërkombëtarisht. Kjo pasiguri mund të çojë në frustrim dhe një ndjenjë pafuqie, siç pohojnë:

“Gjithsesi, ka paqartësi...” (i intervistuari 2).

“Pak e vështirë është në vetvete, pak shtohet edhe nga një lloj paditurie si shkon, pse tjetri...etj.,etj.” (i intervistuari 7).

“Duket e pasigurt. Është e vështirë të marrësh vendime kur procesi është kështu” (i intervistuari 10).

Mbështetja nga familja, miqtë, partnerët

Mbështetja është një ndër elementët që unanimisht konsiderohet e realizuar, nga familja, miqtë apo partnerët. Këto eksperiencë shpesh nxiten nga rrjetet e tilla dhe inkurajohen sepse shihen si mundësi për të ardhmen. Nga intervistat:

“Po, madje më kanë shtyrë ata...” (i intervistuari 11).

“E shohin si një mundësi shumë të mirë për çfarë mund të pasojë” (i intervistuari 5).

Sfidat që lidhen me kreditet akademike janë një shqetësim i thellë për avancimin e karrierës dhe diplomimin në kohë, të cilat studentët i perceptojnë si thelbësore për suksesin e tyre afatgjatë. Pengesat administrative - qoftë në formën e dokumenteve ose mungesës së mbështetjes - e përkeqësojnë më tej ndjenjën e frustrimit dhe konfuzionit.

Rezulton se studentët vlerësojnë

lëvizjen, si një përvojë transformuese që mund të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme arsimimin, mundësitë profesionale dhe rritjen personale. Megjithatë, mungesa e burimeve financiare të mjaftueshme, kompleksiteti i procedurave administrative dhe pasiguria që lidhet me njohjen akademike shpesh i bën këto mundësi të dukshme si të paarrtshme. Për më tepër, mbështetja e pamjaftueshme nga stafi administrativ shton këto frustrime, duke lënë studentët të ndihen të pambështetur dhe të papërgatitur për sfidat e lëvizjes.

Përvojat dhe mendimet e shprehura në lidhje me lëvizjet tregojnë një nevojë për përmirësime sistematike. Thjeshtimi i proceseve të dokumenteve, ofrimi i udhëzimeve më të qarta dhe sigurimi i ndihmës në kohë mund të lehtësojnë ngarkesën logjistike për studentët e përfshirë në mobilitete. Forcimi i sistemeve të mbështetjes, veçanërisht përmes komunikimit të qartë dhe këshillës proaktive nga stafi administrativ, do të ndihmonte studentët të eksplorojnë mundësitë e lëvizjes me më shumë besim. Po ashtu, lehtësimi i transferimit të krediteve, do siguronte që studentët të mos rrezikojnë vonesën e diplomimit të tyre.

Përfundime

Në kontekstin e shoqërive globale, por edhe atë akademik, njihet rëndësia e programeve të shkëmbimit ndër studentë, por fokusuar në studentët e shkencave sociale dhe nisur nga numri jo i lartë i studentëve pjesëmarrës, tentuam të kemi një vështrim të perceptimeve të tyre lidhur me këto përvoja, si dhe barrierat e pengesat respektive, që hasin realisht.

Studentët pjesëmarrës kanë përjetuar pengesa në kontekstin e krediteve dhe mundësisë ose pamundësisë për transferimin e tyre, kohës së diplomimit, duke iu referuar pikërisht pengesës që shpesh shndërrohet pjesëmarrja në programe të tilla, si dhe

pengesave në ndihmën e munguar ose jo të plotë nga stafet ndihmëse/ akademike/ administrative.

Referuar barrierave gjuhësore dhe kulturore, gjejmë se niveli i njohur/certifikuar i gjuhës së huaj, është i rëndësishëm, po aq sa edhe pengesë, duke patur parasysh dhe paragjykimin për nivelin e njohurisë. Elementi kulturor dhe përshtatshmëria raportohet si pengesë më tolerante. Barrierat

gjuhësore dhe kulturore shpesh janë sfiduese për studentët dhe ndikojnë përvojën përgjatë shkëmbimit.

Mjedisi mbështetës akademik është perceptuar jo në nivelin e duhur, dhe bazuar në literaturë komunikimi efektiv prej tyre, rrit përvojat e mira të shkëmbimeve. Studentët pjesëmarrës e shohin ndihmuesen përvojën në këto programe dhe janë të gatshëm ta ripërsërisin.

REFERENCAT

- Ahn, E. (2021). "Relational Barriers dhe Benefits of Peer Mentoring Programs: Focusing on International Social Work Students in Australia", *Australian Social Work*, vol. 19, pp. 61-75.
- Arnold, S. (2020). "Understanding Barriers dhe Supports to Improve the Experience of International Students Attending Master of Social Work Programs in the United States", *Thesis - Indiana University, Department of Educational Leadership dhe Policy Studies/School of Education*, 55(1):1-13.
- Becker, R., & Kolb, D. (2018). "The Role of Faculty in Study Abroad: A Review of the Literature", *The Interdisciplinary Journal of Study Abroad*, Volume 30, Issue 2, Pages 1-13.
- Chen, T., Lee, K., Kabre, P., & Hsieh, C. (2020). "Impacts of Educational Agritourism on Students' Future Career Intentions: Evidence from Agricultural Exchange Programs", *Sustainability*, Volume 12, Issue 16, Article 6418.
- Clemente, M., Tavares, O., & Silva, M. (2020). "The Impact of International Student Mobility on Employability: Evidence from Portuguese Graduates." *Studies in Higher Education*, Volume 45, Issue 5, Pages 973-989.
- Czarnitzki, D., Joosten, W., & Toivanen, O. (2022). "International Student Exchange dhe Academic Performance: Evidence from the Erasmus Program", *Journal of International Business Studies*, Volume 53, Issue 5, Pages 1003-1019.
- Diem, H., Thinh, M., & Mung, T. (2020). "Factors Influencing the Decision-Making Process of Vietnamese Students Regarding International Study Abroad Programs", *Journal of Studies in International Education*, Volume 24, Issue 1, Pages 3-22.
- Gair, S., Thomson, J., & Savage, D. (2020). "What's Stopping Them? Exploring Barriers Hindering Indigenous Australians from Completing a Social Work Degree at a Regional Queensland University", *Australian Social Work*, Volume 73, Issue 1, Pages 72-85.
- Glass, C. (2021). "Educational Experiences Associated with International Students' Learning, Development, dhe Positive Perceptions of Campus Climate", *Journal of International Students*, Volume 11, Issue 2, Pages 263-284.
- Institute of International Education (IIE). (2017). "Open Doors Report on International Educational Exchange 2017", *Institute of International Education*, <https://report.opendoorsdata.org/>
- Ivannikov, N., Kolesnikov, D., & Sablina, M. (2021). "Sociocultural Problems of Adaptation of International Students in a Non-native Language Educational Environment dhe Techniques to Overcome Them (at Universities of Russia, Finland, Sweden dhe China)", *Education dhe Information Technologies*, Volume 26, Issue 6, Pages 7297-7317.
- Lee, K. (2013). "Training dhe Educating International Students in Professional Psychology: What Graduate Programs Should

- Know*”, *Training dhe Education in Professional Psychology*, Volume 7, Issue 4, Pages 247–253.
- Lee, J., Leibowitz, J., Rezek, J., Millea, M., & Saffò, G. (2021). “*The Impact of International Virtual Exchange on Student Success*”, *International Journal of Intercultural Relations*, Volume 81, Pages 49–58.
- McKeown, J., Celaya, M., & Ward, H. (2020). “*Academic Development: A Comparative Study of Strategies for Enhancing Student Success*”, *Journal of Higher Education Policy dhe Management*, Volume 42, Issue 3, Pages 288–302.
- Nghia, T., Giang, H., & Quyen, V. (2020). “*At-home International Education in Vietnamese Universities: Impact on Graduates’ Employability dhe Career Prospects*”, *Higher Education*, Volume 79, Pages 209–224.
- Peiser, G. (2016). “*Overcoming Barriers: Engaging Younger Students in an Online Intercultural Exchange*”, *Intercultural Education*, Volume 27, Issue 5, Pages 433–449.
- Perkins, R., & Neumayer, E. (2014). “*Geographies of Educational Mobilities: Exploring the Uneven Flows of International Students. Theorizing the International Student Experience*” (pp. 145–169), New York: Routledge.
- Rapoport, A. (2020). “*The Impact of International Educational Exchange dhe Training Programs on Teachers’ Curricular dhe Pedagogical Practices: Participant Perspectives*”, *International Journal of Educational Development*, Volume 76, Pages 102–111.
- Sadiki, M. (2022). “*International Student Mobility dhe Academic Performance: A Study of Moroccan Students*”, *International Journal of Educational Management*, Volume 36, Issue 5, Pages 987–1001.
- Sustarsic, M. (2018). “*The Impact of Intercultural Exchange on Secondary School Exchange Students dhe Their Host Families*”, *Journal of International Students*, Volume 8, Issue 2, Pages 710–728.
- Van Eerdewijk, A., Westeneng, J., & De Hoop, T. (2010). “*Raising Societal Support for Development Cooperation: The Role of Students’ Exchange Programs*”, *Nonprofit dhe Voluntary Sector Quarterly*, Volume 39, Issue 3, Pages 469–490.
- Vdhee Berg, M., Paige, R. M., & Lou, K. H. (2012). “*Student Learning Abroad: What Our Students Are Learning, What They’re Not, dhe What We Can Do About It*”, Published in *Journal of Studies in International Education*.
- Volet, S., & Jones, C. (2012). “*Cultural Transitions in Higher Education: Individual Adaptation, Transformation dhe Engagement*”, *Journal of Studies in International Education*, Pages 241–284.
- Żebryk, P., Przymuszała, P., & Nowak, J. (2021). “*The Impact of ERASMUS Exchanges on the Professional dhe Personal Development of Medical Students*”, *BMC Medical Education*, 18(24):13312.

ABSTRACT

This study aims to focus on the experiences of students at the Faculty of Social Sciences (University of Tirana, Albania) regarding their respective experiences in academic exchange programs (academic and social development). Academic exchanges are increasingly recognized as vital for enhancing students’ employability and intercultural competencies. Students participating in these programs often achieve better academic performance and acquire valuable skills that are attractive to future employers. Using semi-structured interviews, the research collected data from a purposive sample of students who have participated in these programs. The information was gathered through the faculty’s services, limited to the last five years, but not restricted to specific programs or study cycles. The social aspects of academic exchanges, language barriers, and cultural differences often present significant challenges for students, which can affect their overall experience and engagement during the

exchange. Overcoming these barriers can lead to increased self-confidence and a stronger sense of belonging among participants as they adapt to new environments and interact with diverse peers. Supportive academic environments, characterized by effective communication and engagement strategies, significantly enhance students' experiences and perceptions of academic exchanges. Collaborative efforts by faculty and administration can create a more inclusive atmosphere that encourages student participation and retention in these programs. Students' perceptions of academic exchanges are shaped by a complex interplay between academic performance, social integration, and institutional support.

Keywords: *Student, experience, barriers, exchange programs*

A STUDY OF THE EMOTIONAL EXPERIENCES OF PRESCHOOL CHILDREN

Tsvetelina HADZHIEVA

South West University “Neofit Rilski”, Bulgaria

Department of Psychology

E-mail: Cveti_hadjieve@swu.bg

Blagovesta DAFKOVA

South West University “Neofit Rilski”, Bulgaria

Department of Psychology

E-mail: bl.dafkova@swu.bg

ABSTRACT¹

The concept of emotional intelligence is relatively new, first introduced around 1990 by researchers Peter Salovey and John Mayer. With the rapid changes in modern society, especially the increasing dependence on technology across all age groups—particularly children and adolescents—the development of emotional intelligence has become even more significant. In childhood, the emotional sphere plays a dominant role in children’s mental development, as they primarily perceive and interpret the world through their senses and feelings. This period is, in fact, the most sensitive stage for emotional development. The present study aims to investigate preschool children’s ability to recognize, name, and express their attitudes toward others’ emotional experiences as depicted in various scenarios. Sixty children from three kindergartens in Blagoevgrad, Bulgaria, participated in the study. Permission was obtained from the parents and official representatives of the childcare facilities. The research methodology involved using three images depicting different situations, each designed to reflect varying degrees of emotional charge and align with experiences familiar to children. Each child was assessed individually, and their

¹ Presented in the International and Interdisciplinary Conference “Well-being in Challenging Times”, that has been held at the AAB University College of Pristine Kosovo, on November 15-16, 2024; Proceedings, pp 99, link: <https://www.sociology.al/sites/default/files/19th%20International%20Conference%20Proceedings%20AAB%20Pristine%202024.pdf>

responses were recorded in a protocol. The study results clearly indicate that a significant number of children are able to accurately identify and label different emotional states in others and express their attitudes toward these emotions.

Key words: *Emotional intelligence, child, age, emotions.*

Prof. Assos. Dr. **Tsvetelina HADZHIEVA** is a lecturer in Psychology at SWU “Neofit Rilski” Blagoevgrad. She has a bachelor’s degree in Psychology, a master’s degree in Legal Psychology and a doctorate in “Age and Pedagogical Psychology”. She has completed a number of trainings. Her scientific interests are in the field of child and adolescent development, eating disorders and sports psychology. She has a private practice where she works with children, adolescents and parents. She has also published two monographs and a number of articles related to her scientific interests.

Blagovesta DAFKOVA, Ph.D., is the Erasmus coordinator of the Psychology Department from 2023. He has a BA in speech therapy and a MA in legal psychology. Her doctoral degree is in the field of Pedagogical and Age Psychology from the South-West University “Neofit Rilski”. Her research and interests are related to neurodevelopmental and degenerative disorders in childhood, neuropsychology and language disorders. She has participated in numerous practical trainings. Certified Montessori specialist, as well as an accredited trainer from “The International Education Atsademii Pvt” in Australian methodology/theory and practice. She has completed theoretical and practical training in bio and neurofeedback therapy. Member of the Bulgarian Association of Children and Families of the Bulgarian Academy of Sciences and Arts. She has been working with children with problems and their families for 10 years

Emotions play a vital role in human behavior, serving as essential mechanisms for an individual’s interaction with and adaptation to their environment. At their core, emotions are internal reactions and experiences that shape thoughts, perceptions, and actions.

From the earliest stages of life, emotions and feelings accompany us, sparking curiosity about their causes, functions, and development along the evolutionary path. Emotional processes have always fascinated humanity, both at a personal and scientific level, driving the pursuit of a concrete, scientifically supported understanding of emotions. This includes exploring their diversity, dynamics, and significance for behavior, a topic that continues to be a focus of scientific inquiry (Hadjieva, 2017, 227-235).

Emotions are relatively short-lived processes and states tied to specific positive or negative experiences, accompanying any form of action or impulse (Golman, 2011). Emotional expressions impact the psychosomatic state of the individual, reflecting back on the person and readily perceived by others, as they are often accompanied by

organic changes and physiological responses (Levenson, Ekman & Friesen, 1990).

Emotions are a fundamental component of emotional intelligence. The role of both positive and negative emotions in a person’s life is central to understanding emotional intelligence. While childhood is a critical period for its development, emotional intelligence can continue to grow throughout one’s life, requiring significant self-awareness (Gardner & Hatch, 1989).

In 1995, the term *emotional intelligence* was introduced by Peter Salovey of Harvard University and John Mayer of the University of New Hampshire to describe the emotional competencies essential for success. Later, Daniel Goleman conducted an extensive study on this phenomenon, uncovering surprising insights into emotional intelligence (Golman, 2011).

Emotional intelligence is recognized as one of the key skills of the 21st century, embodying a set of qualities and abilities essential for effective personal integration and functioning in psycho-emotional interactions.

Emotional intelligence encompasses

not only self-awareness of one's own emotions but also the ability to recognize and respond to the emotions of others. It implies a heightened sensitivity toward both oneself and others, meaning that self-perception is balanced by awareness of others, taking into account their reactions and the resulting emotional impact on oneself. Emotional intelligence acts as a "reader" of emotional states for both oneself and others, providing rational interpretations of emotional responses.

Emotional intelligence is also practical in orientation; it involves applying emotional knowledge to manage personal behavior and relationships with others to achieve personal goals (Barriso, 2021).

Childhood is an intense period for developing certain qualities and skills, where sensory perception, emotional responsiveness to external stimuli, mental sensitivity, and sensory acuity gradually increases. Children's heightened sensitivity is evident in their strong perception of reality, rapid progress in understanding different aspects of their environment, and emotional satisfaction derived from active engagement (Hadzhieva, 2023: 47).

The emotional perception and subsequent response of a child are typically intense due to the dynamic structure of their entire sensory system. Children can pick up on subtle emotional cues and understand even the slightest facial expressions. This sensitivity is why childhood is the most receptive period (Kamenski, 1982).

Therefore, it is essential first to teach children to recognize and manage their emotions. Children need to understand that experiencing a range of emotions is natural while also learning to distinguish between feeling an emotion and expressing it, which may or may not be appropriate.

When a child is taught to pay attention to their own emotional state, they naturally become more attentive to the emotional states of others. This awareness helps children

learn effective conflict resolution and fosters cooperative relationships. The ability to manage emotions is critical in building and maintaining quality relationships.

Emotional intelligence is a practical skill set that enables individuals to manage their behavior and relationships with others to achieve personal goals (Barriso, 2021).

Emotional intelligence is fundamentally about understanding and managing our emotions to work in our favor, rather than against us. It involves the ability to:

- Perceive emotions,
- Understand emotions,
- Use emotions, and
- Manage emotions.

Being aware of and applying these skills enables us to channel and process our emotions in ways that benefit us. When emotions are not effectively managed, they can disrupt both mind and body, while emotions that are transformed into skills enhance productivity, satisfaction, and positive interpersonal relationships. They contribute to responsibility-taking and reinforce self-control, among many other benefits (Danciu, 2010).

However, the concept of emotional intelligence is broad and relative. This conclusion was reached by the American scientist Howard Gardner in the last century after conducting an extensive study of human potential. Gardner's theory of multiple intelligences was first proposed in his 1983 book *Frames of Mind*, where he expanded the definition of intelligence and outlined several distinct intellectual competencies. Before categorizing types of intelligence, Gardner identified three components:

- Skills that enable people to cope with daily challenges;
- Ability to create products or services with social value;
- The capacity to set and solve new problems, leading to knowledge accumulation;

Gardner's findings indicate that intelligence is not a fixed numerical value but is difficult to measure and can develop across all life stages (Gardner & Hatch, 1989).

Both physical and psycho-emotional development vary significantly in each child. Therefore, many authors argue that this individuality should be considered in guiding and supporting children to develop their strengths (Gardner & Hatch, 1989; Mayer, Salovey, Caruso & Sternberg, 2000; Salovey & Mayer, 2004).

Moreover, according to Gardner (1989), each person is born with a built-in model of multiple intelligences, with some being more prominent than others. However, this does not mean the others cannot be developed. Gardner asserts that emotional intelligence can grow and evolve throughout one's life (Gardner & Hatch, 1989).

Methodology of study

The current study explores preschool children's ability to recognize, name, and express their attitudes toward others' emotional experiences. A total of 60

children (35 girls and 25 boys) from three kindergartens in Blagoevgrad, Bulgaria, participated in the study. Parental consent and authorization from childcare facility representatives were obtained prior to conducting the research.

We selected three illustrated stories depicting clearly contrasting emotional experiences: joy, fear, and sadness. The study posed questions designed to assess the following:

- The narrative of the illustration ("What is shown in the picture?"),
- The emotional state of the child in the image ("How does this child feel?"),
- The specific ways in which the child's emotional state is expressed, and
- Potential causes of the child's emotional state.

Each child was interviewed individually, and their responses were documented in a protocol.

Results

A total of 60 preschool children - 35 girls and 25 boys - took part in the

Figure 1: *The distribution of responses recorded from the children*




Table 1: *The distribution of responses recorded from the children, by gender*

Emotions	Boys	Girls
Sadness	19.0	30.0
Scared	20.0	33.0
Joy	25.0	35.0

present study. The study was conducted on site, having been agreed in advance with the kindergarten management and with the permission of the parents of the subjects. The study itself was presented and conducted in the form of a game with the children. A strict protocol was kept for each of the children. During the research period, all children were calm and showed interest in the „new game“, thus contributing to the objective conduct of the research.

The research results clearly demonstrate that a significant number of children are capable of accurately recognizing and naming different emotional states in others.

This means that children receive a sufficiently adequate and good prerequisite to develop their emotional sphere. Of course, a number of factors contribute to this - biological, psychological and social. This is also one of the numerous studies in this regard, which undoubtedly confirm the evolutionary importance of emotions for the psychosocial development of the personality. The graph below illustrates the distribution of responses recorded from the children, and the table the distribution of responses recorded from the children, by gender.

The findings from this research clearly indicate that preschool-aged children can recognize basic emotional states—joy, fear, and sadness—with relative ease. Most children successfully identified both the context of the story pictures and the specific emotional expressions depicted, describing how these emotions were displayed.

Each of the children studied clearly named the emotion they recognized, even giving an example of how they felt that way in a similar situation. That is why it is necessary to record the course of the study in a detailed individual protocol, in order to take into account not only that the children name the emotions, but also understand the essence of their manifestation.

Conclusion

Emotional intelligence is grounded in deep self-awareness and understanding of others. As a psychological construct, it enables individuals to recognize and interpret both their own emotions and those of others, allowing for a proactive approach to various situations and a clear, objective reflection on one's behavior. Each person is born with a degree of emotional intelligence that can be cultivated and developed under supportive conditions and awareness. Childhood represents the most sensitive and optimal period for fostering this development, making it an ideal stage for integrating emotional intelligence into the educational process. To nurture its growth, children need a supportive environment where they experience understanding, encouragement, and motivation.

Emotional intelligence can also be viewed as a forward-looking skill, where social competencies can be learned, reinforced, and enhanced for improved social integration and adaptability in interpersonal relationships.

REFERENCE

- Barriso, J. (2021). *A Practical Guide to Emotional Intelligence*, Sofia: Hermes.
- Danciu, E. L. (2010). "Methods of developing children's emotional intelligence", *Procedia-Social and Behavioral Sciences*, 5, 2227-2233.
- Gardner, H., & Hatch, T. (1989). "Educational implications of the theory of multiple intelligences", *Educational researcher*, 18(8), 4-10.
- Goleman, D. (2011). *Емоционална интелигентност*. [Emotional intelligence], Sofia: East-West.
- Hadzhieva, T. S. (2017). "Conscious and unconscious emotions in alexithymics and repressors", *Psychological Thought*, 10(1).
- Hadzhieva, Ts. (2023). *Study of the psychological characteristics of the child and the adolescent*, Blagoevgrad: "Neofit Rilski".
